

KISHA E JEZU KRISHTIT E SHENJTORËVE TË DITËVE TË MËVONSHME • TETOR 2012

Liahona

**Forcimi i Shtëpisë
dhe i Familjes,
f. 4, 16, 20, 22**

**Të Rinjtë në Moshë Madhore
Shprehen për Dëlirësinë, f. 42**

**Katër Shkrime të Shenjta
që na Ndihmuan, f. 54**

Largimi nga Fillorja, f. 58



*Krishti në Amerikë,
nga Jeffrey Hein*

*Kur Krishti i ringjallur
vizitoi neftët në Amerikë, “ai
i mori fëmijët e tyre të vegjël,
një nga një, dhe i bekoi dhe iu
lut Atit për ta.*

*Dhe pasi e bëri këtë gjë,
ai qau përsëri;*

*Dhe i foli turmës dhe u tha
atyre: Vini re të vegjlit tuaj”
(3 Nefi 17:21–23).*



Liahona, Tetor 2012

MESAZHET

- 4 Mesazhi i Presidencës së Parë: Një Çelës për një Familje të Lumtur**
Nga Presidenti Diter F. Uhtdorf

- 8 Mesazhi i Vizitave Mësimore: Nderimi i Besëlidhjeve Tona**

ARTIKUJT KRYESORË

- 22 Ndihma për Rininë që të Ketë Përvoja Shpirtërore**
Nga Melisa Meril
Pesë mënyra për të nxitur përvoja që çojnë në kthim në besim.

- 28 Libri i Almës: Mësime për të Sotmen**
Nga Plaku Pol B. Pajper
Tri mësime nga nefitët mund të na ndihmojnë që t'i përballim me sukses sfidat e kohës sonë.


NË KOPERTINË
Fotoilustrime nga Cody Bell.

- 34 Si të Mbijetosh në Territor Armik**
Nga Presidenti Bojd K. Paker
Zbuloni brenda vetes se si Fryma e Shenjtë mund të jetë një ndikim drejtues dhe mbrojtës.

SEKSIONET

- 9 Për Forcën e Rinisë: Veshja dhe Pamja e Jashtme**
10 Bllok Shënimesh për Konferencën e Tetorit: Pastrimi i Kalendarit Tonë për Konferencën
Nga Sheril Bur
11 Shërbimi në Kishë: Përgjigjet e Shkollës të së Dielës
Nga Ema Adams
12 Çfarë Besojmë Ne: Të Jetuarit me Maturin na Përgatit për të Ardhmen

- 14 Gjëra të Vogla dhe të Thjeshta**
16 Shtëpitë Tona, Familjet Tona: Dhënia Mësim për Dëlirësinë dhe Virtytin
Nga Methju O. Riçardson
20 Klasikët e Ungjillit: Mësimdhënia e Drejtësisë në Shtëpi
Nga Plaku Delbert L. Stepli
38 Zëra të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme
74 Lajme të Kishës
79 Ide për Mbrëmje Familjare në Shtëpi
80 Kur Prapë të Takohemi: Gjëra të Mira Vazhdojnë të Vijnë
Nga Keitlin A. Rash



42

42 Dëlirësia në një Botë të Papërkorë

Tetë të rinj në moshë madhore diskutojnë se si të mbeten të dëlirë në një botë që nuk e vlerëson dëlirësinë.



Shihni nëse mund të gjeni Liahonën e fshehur në këtë botim. E dhënë: A përdori një Liahonë Noeu?

46 Pyetje e Përgjigje

Cfarë do të thotë të nderosh priftërinë e Perëndisë?

48 Jini i Urtë dhe Jini një Mik

Nga Plaku Robert D. Hejls

Miq të mirë e bëjnë të lehtë që t'i jetoni urdhërimet.

51 Veshja për një Vallëzim

Nga Kristëll Martin

U tundova të vishja një fustan që nuk m'i mbulonte shpatullat, por pastaj kujtova bekimin patriarkal.

52 Për Forcën e Rinisë: Veshja dhe Pamja e Jashtme – “Lëreni Shpirtin e Shenjtë t’Ju Udhëzojë”

Nga Meri N. Kuk

54 Të Forcuar nga Fjala

Katër adoleshentë tregojnë për momente kur një shkrim i shenjtë u erdhi në mendje dhe i ndihmoi.

57 Afishe: E Drejtë dhe e Ngushtë Është Udhë

51



58 Largimi nga Fillorja

Këtu janë disa përvoja të cilat mund t'i prisni te Të Rinjtë ose te Të Rejat.

60 E dashur Amiga,

Nga Maribela

Një letër drejtuar një mikeje të shqetësuar se largohet nga Fillorja.

61 Duke i Uruar Mirëseardhjen një Stinë të Re të Jetës

Nga Marisa Uidison

Noeu, Dilani, Patriku dhe Beni po bëhen gati që të marrin priftërinë.

62 Muzikë: Eja, Zot Jezus

63 Dëshmitar i Veçantë: Përse Është e Rëndësishme që ta Ndjek me Besnikëri Jezu Krishtin, Pavarësisht se Ku Ndodhem?

Nga Plaku Dallin H. Ouks

64 Sjellim Filloren në Shtëpi: Bekimet e Priftërisë Janë në Dispozicion të të Gjithëve

66 Dyfish Bekime

Nga Riçard M. Romni

Takohuni me Sofinë dhe Elo-dinë, binjaket 10-vjeçare nga Madagaskari.

68 A nuk Mund të Pagëzohem edhe Unë?

Nga Hilari Uotkins Lemon

Pauloja gjashtë vjeçar është i emocionuar që të bëhet anëtar i Kishës.

70 Për Fëmijët e Vegjël

81 Figura të Shkrimeve të Shenjta nga Libri i Mormonit

TETOR 2012 VËLLIMI 14 NR. 3
LIAHONA 10490 101

Revista ndërkombëtare zyrtare e Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme

Presidenca e Parë: Tomas S. Monson, Henri B. Ajring, Diter F. Uhtdorf

Kuorumi i Dymbëdhjetë Apostujve: Bojd K. Paker, L. Tom Perri, Rasëll M. Nelson, Dallin H. Oaks, M. Rasëll Ballard, Riçard G. Skot, Robert D. Hejls, Xhefri R. Holland, Dejvid A. Bednar, Kuentin L. Kuk, D. Tod Kristoferson, Nil L. Andersen

Botues: Craig A. Cardon

Këshilltarë: Shayne M. Bowen, Bradley D. Foster, Christoffel Golden Jr., Anthony D. Perkins

Drejtor Administrimi: David T. Warner

Drejtor i Mbështetjes së Familjes dhe Anëtarit: Vincent A. Vaughn

Drejtor i Revistave të Kishës: Allan R. Loyborg

Administrues i Punëve: Garff Cannon

Redaktor Administrimi: R. Val Johnson

Ndihmesredaktor Administrimi: LaRene Porter Gaunt

Ndihmës i Botimeve: Melissa Zenteno

Grupi i Shkrimit dhe i Redaktimit: Susan Barrett, Ryan Carr, David Dickson, David A. Edwards, Matthew D. Flitton, Mindy Raye Friedman, Hikari Loftus, Lia McClanahan, Michael R. Morris, Richard M. Romney, Paul VanDenBerghe, Julia Woodbury

Drejtor Administrimi i Artit: J. Scott Knudsen

Drejtor Arti: Tadd R. Peterson

Grupi i Dizajnimit: Jeanette Andrews, Fay P. Andrus, C. Kimball Bott, Thomas Child, Kerry Lynn C. Herrin, Colleen Hinkley, Eric P. Johnson, Scott M. Mooy, Brad Teare

Bashkërendues i Pronës Intelektuale:

Collette Nebeker Aune

Administrimi i Prodhimit: Jane Ann Peters

Grupi i Prodhimit: Connie Bowthorpe Bridge, Howard G. Brown, Julie Burdett, Bryan W. Gygi, Kathleen Howard, Denise Kirby, Ginny J. Nilson, Gayle Tate Rafferty

Përgatitja për Shtyp: Jeff L. Martin

Drejtor i Prodhimit: Craig K. Sedgwick

Drejtor i Shpërndarjes: Evan Larsen

Mbikëqyrës i Përkthimit Shqip: Atilla Böröcz

Për pajtimet dhe për çmimet jashtë Shteteve të Bashkuara dhe Kanadasë, ju lutemi të lidheni me qendrën tuaj vendore të shpërndarjes të Kishës ose me udhëheqësin e lagjes apo degës.

Paraqitni dorëshkrimet dhe pyetjet në internet në liahona.lds.org; **nëpërmjet postës elektronike** liahona@ldschurch.org; **ose nëpërmjet postës në** **Liahona**, Rm. 2420, 50 E. North Temple St., Salt Lake City, UT 84150-0024, USA.

Liahona (një term nga Libri i Mormonit, që do të thotë "busull" apo "drejtues") botohet në anglisht, armenisht, bislamisht, bullgarisht, çekisht, danisht, estonisht, fihisht, finlandisht, frëngjisht, greqisht, gjermanisht, holandisht, hungarisht, indonezisht, islandisht, italisht, japonisht, kambodhisht, kinezisht, kiribatish, koreanisht, kroatish, letonisht, lituanisht, malagasisht, marshallisht, mongolisht, norvegjisht, polonisht, portugalisht, rumanisht, rusisht, samoaisht, sebuanisht, slovenisht, spanjisht, suedisht, shqip, tagalogisht, tahitisht, taisht, tongaisht, ukrainisht, urduisht dhe vietnamsht. (Periodiciteti ndryshon sipas gjuhës.)

© 2012 nga Intellectual Reserve, Inc. I rezervohen të gjitha të drejtat. Shtypur në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.


Lënda e shkruar dhe ajo figurative e *Liahonës* mund të kopjohet për ta përdorur me raste në kishë ose në shtëpi, jo për tregti. Lënda figurative nuk mund të kopjohet nëse ajo shoqërohet me kufizime të shënimi i meritave për punën artistike. Çështjet e së drejtës së autorit duhet të adresohen te: Intellectual Property Office, 50 E. North Temple St., Salt Lake City, UT 84150, USA; adresa elektronike: cor-intellectualproperty@ldschurch.org.

For Readers in the United States and Canada:

October 2012 Vol. 14 No. 3. LIAHONA (USPS 311-480) Albanian (ISSN 1521-4753), is published four times a year (April, May, October and November) by The Church of Jesus Christ of Latter-day Saints, 50 E. North Temple St., Salt Lake City, UT 84150. USA subscription price is \$3.00 per year; Canada, \$3.60 plus applicable taxes. Periodicals Postage Paid at Salt Lake City, Utah. Sixty days' notice required for change of address. Include address label from a recent issue; old and new address *must* be included. Send USA and Canadian subscriptions to Salt Lake Distribution Center at address below. Subscription help line: 1-800-537-5971. Credit card orders (Visa, MasterCard, American Express) may be taken by phone. (Canada Poste Information: Publication Agreement #40017431)

POSTMASTER: Send address changes to Salt Lake Distribution Center, Church Magazines, PO Box 26368, Salt Lake City, UT 84126-0368.

Më Shumë Internet Liahona.Lds.org



TEMAT NË KËTË BOTIM

Numrat përfaqësojnë faqen e parë të artikullit.

Besëlidhjet, 8
Besimi, 39, 80
Bindja, 40, 57
Dashamirësia, 28
Dëlirësia, 16, 42
Dituria, 48
Falja, 4
Familja, 4, 16, 20, 22, 38, 66
Fatkeqësia, 28
Historia e Kishës, 14
Jezu Krishti, 62, 63

Konferenca e përgjithshme, 10
Kthimi në besim, 39
Libri i Mormonit, 28, 81
Lutja, 38
Mbështetja te vetja, 12
Mësimdhënia, 16, 20
Miqte, 48
Pagëzimi, 68
Përgatitja, 12
Priftëria, 46, 64
Prindërimi, 16, 20, 22,

Profetët, 28
Puna, 12
Studimi i shkrimeve të shenjta, 11, 54
Shabati, 40
Shembulli, 40
Shërbimi, 20, 39
Tempujt, 8, 52
Të Rejat, 58, 60
Të Rinjtë, 58, 61
Udhëheqja, 20
Veshja, 9, 51, 52

PËR TË RRRITURIT

Pasi të lexoni mbi faljen në Mesazhin e Presidencës së Parë (faqe 4), ju mund të dëshironi të lexoni gjithashtu bisedën e fundit të Presidentit Xhejms E. Faust në konferencë të përgjithshme, "Fuqia Shëruese e Faljes" (prill 2007) në [Konferenca e Përgjithshme, prill 2007] conference.lds.org.

PËR RININË

Në faqen 52, Meri N. Kuk shpjegon mënyrën se si nderimi që ndiejmë për tempujt mund të udhëheqë mënyrën se si vishemi. Te adresa youth.lds.org, ju mund të gjeni më shumë mbi "Veshjen dhe Pamjen e Jashtme" dhe cilindo prej standardeve të tjera nga broshura *Për Forcën e Rinisë*.

PËR FËMIJËT

Ju mund të lexoni për binjaket Elodi dhe Sofi nga Madagaskari te "Dyfish Bekime" (faqe 66) dhe të shihni disa fotografi zbavitëse të tyre te liahona.lds.org.

NË GJUHËN TUAJ

Liahona dhe materiale të tjera të Kishës janë të disponueshme në shumë gjuhë në languages.lds.org.





**Nga Presidenti
Diter F. Uhtdorf,**

Këshilltar i Dytë në
Presidencën e Parë

NJË ÇELËS PËR NJË Familje të Lumtur

Autori i madh rus, Leon Tolstoi, e filloi romanin e tij *Ana Karenina* me këto fjalë: “Familjet e lumtura janë të gjitha njëloj; secila familje e trishtuar është e trishtuar në mënyrën e vet”¹. Ndonëse nuk e kam sigurinë e Tolstoit se familjet e lumtura janë të gjitha njëloj, kam zbuluar një gjë që e kanë të përbashkët shumica e tyre: ato kanë një mënyrë për t’i falur e harruar papërsosmëritë e të tjerëve dhe për të kërkuar të mirën.

Njerëzit në familjet e trishtuara, nga ana tjetër, shpesh gjejnë gabim, mbajnë mëri dhe nuk duket t’i harrojnë fyerjet e shkuara.

“Po, por . . .” fillojnë ata që janë të trishtuar. “Po, por ti nuk e di se sa keq më ka lënduar ajo”, thotë njëri. “Po, por ti nuk e di sa i tmerrshëm është ai”, thotë një tjetër.

Ndoshta të dy kanë të drejtë, ndoshta asnjëri.

Ka shumë shkallë të fyerjes. Ka shumë shkallë të lëndimit. Por ajo që unë kam vënë re, është se shpesh ne e justifikojmë inatin tonë dhe e kënaqim ndërgjegjen tonë duke i treguar vetes histori për shkaqet e të tjerëve që i dënojnë veprimet e tyre si të pafalshme dhe egoiste ndërkohë që, në të njëjtën kohë, shohim vetë shkaqet tona si të kulluara dhe të pafalshme.

Qeni i Princit

Ekziston një rrëfenjë e lashtë uellsiane nga shekulli i 13-të për një princ që u kthye në shtëpi dhe e gjeti qenin

e tij duke i pikuar gjak në fytyrë. Burri u turr brenda dhe, për tmerrin e tij, pa se i biri i tij foshnjë ishte zhdukur dhe djepi ishte përmbysur. Në zemërim e sipër, princi nxori shpatën dhe e vrau qenin. Menjëherë pas kësaj, ai dëgjoi të qarën e të birit të tij – foshnja ishte gjallë! Pranë foshnjës dergjej një ujk i ngordhur. Në të vërtetë, qeni e kishte mbrojtur foshnjën e princit nga një ujk vrasës.

Edhe pse kjo rrëfenjë është dramatike, ajo tregon një argument. Ajo tregon mundësinë se historia që i tregojmë vetes mbi arsyet pse të tjerët sillen në një mënyrë të caktuar, nuk përputhet gjithmonë me faktet – nganjëherë ne as që duam t’i njohim faktet. Ne më mirë do të ndihemi të vetëjustifikuar në zemërimin tonë duke u kapur pas hidhërimit dhe fyerjes sonë. Nganjëherë këto mëri mund të zgjasin për muaj ose vite. Nganjëherë mund të zgjasin për të gjithë jetën.

Një Familje e Ndarë

Një baba nuk mund ta falte birin e tij që ishte larguar nga rruga që ai i kishte mësuar. Djali kishte miq të cilët babai nuk ia pëlqente, dhe ai bëri shumë gjëra në kundërshtim me atë që babai i tij mendonte se ai duhet të bënte. Kjo krijoi një të çarë mes babait e birit dhe, sapo mundi, djali u largua nga shtëpia dhe nuk u kthye më kurrë. Ata folën shumë rrallë.

A u ndie i justifikuar babai? Ndoshta.

A u ndie i justifikuar biri? Ndoshta.

MËSIMDHËNIA NGA KY MESAZH

“Ndërsa përgatisni secilin mësim, pyeteni veten se si parimi ngjan me diçka që pjesëtarët e familjes e kanë përjetuar në vetë jetën e tyre” (*Teaching, No Greater Call [Mësimdhënia, S’Ka Thirrje më të Madhe]* [1999], f. 171). Merrni parasysh që t’i ftoni pjesëtarët e familjes që të tregojnë përvoja pozitive që kanë pasur ose kanë vërejtur lidhur me faljen. Diskutojini këto përvoja, duke theksuar bekimet e faljes. Përfundoni duke dhënë dëshmi për rëndësinë e faljes së njëri-tjetrit.

Gjithçka që unë di është se kjo familje ishte e ndarë dhe e trishtuar sepse as babai dhe as biri nuk mund ta falnin njëri-tjetrin. Ata nuk mund t’i kapërcenin kujtimet e hidhura që kishin për njëri-tjetrin. Ata i mbushën zemrat me inat në vend të dashurisë dhe faljes. Secili i grabiti vetvetes mundësinë për ta ndikuar për mirë jetën e tjetrit. Ndarja midis tyre dukej aq e thellë dhe aq e gjerë sa që secili u bë një i burgosur shpirtëror në ishullin e vet emocional.

Fatmirësisht, Ati ynë i dashur, i mençur dhe i Amshtar në Qiell i ka siguruar mjetet për të kapërcyer këtë hendek krenarie. Shlyerja e mrekullueshme dhe e pafundme është akti suprem i faljes dhe i pajtimit. Madhësia e saj është përtej kuptueshmërisë sime, por unë dëshmoj me të gjithë zemrën dhe shpirtin tim për vërtetësinë e saj dhe fuqinë absolute. Shpëtimtari e ofroi Vetën si shpërblës për mëkatet tona. Nëpërmjet Tij ne marrim falje.

Asnjë Familje nuk Është e Përkryer

Asnjë prej nesh nuk është pa mëkat. Secili prej nesh bën gabime, përfshirë ju dhe mua. Të gjithë ne na kanë plagosur. Të gjithë ne kemi plagosur të tjerë.

Pikërisht nëpërmjet sakrificës së Shpëtimtarit ne mund të marrim ekzaltim dhe jetë të përtjetshme. Kur i pranojmë mënyrat e Tij dhe e kapërcejmë krenarinë tonë duke i zbutur zemrat, mund të sjellim pajtim dhe falje në familjet tona dhe jetën tonë personale. Perëndia do të na ndihmojë të jemi më falës, të jemi më të gatshëm që të përshkojmë edhe miljen e dytë, të jemi të parët që të kërkojmë falje edhe nëse diçka nuk qe gabimi ynë, t’i lëmë mënjatë meritë e vjetra e të mos i ushqejmë më ato. Falë i qoftë Perëndisë, që dha Birin e Tij të Vetëmlindur, dhe Birit, që dha jetën e Tij për ne.

Ne mund ta ndiejmë çdo ditë dashurinë e Perëndisë për ne. A nuk duhet të jemi

në gjendje që t’u japim pak më shumë nga vetja bashkënjërëzve tanë, siç jepet mësim në himnin tonë të dashur “Because I Have Been Given Much” [“Sepse Shumë Më Është Dhënë”]²? Zoti ka hapur derën që ne të falemi. A nuk do të ishte thjeshtë e drejtë që t’i lëmë mënjatë egotizmin e krenarinë tonë dhe të fillojmë t’ua hapim atë derë të bekuar të faljes atyre me të cilët kemi probleme – veçanërisht të gjithë pjesëtarëve të vetë familjeve tona?

Në fund, lumturia nuk buron nga përsosja por nga zbatimi i parimeve hyjnore, qoftë edhe në hapa të vegjël. Presidenca e Parë dhe Kuorumi i Dymbëdhjetë Apostujve kanë deklaruar: “Lumturia në jetën familjare është e mundur të arrihet më mirë kur bazohet në mësimet e Zotit Jezu Krisht. Martesat dhe familjet e suksesshme ngrihen dhe ruhen me parimet e besimit, lutjes, pendimit, *faljes*, respektit, dashurisë, dhembshurisë, punës dhe aktiviteteve të shëndosha argëtuese.”³

Falja gjendet mu në mes të këtyre të vërtetave të thjeshta, mbështetur në planin e lumturisë së Atit tonë Qiellor. Për shkak se falja lidh parime, ajo lidh njerëz. Ajo është një çelës, ajo hap dyert e mbyllura, ajo është fillimi i një shtegu të ndershëm dhe është një nga shpresat tona më të mira për një familje të lumtur.

Perëndia na ndihmoftë që të jemi pak më shumë falës në familjet tona, më shumë falës ndaj njëri-tjetrit dhe ndoshta më shumë falës, madje me veten tonë. Unë lutem që ne të mund të përjetojmë falje, si një mënyrë e mrekullueshme sipas së cilës janë të ngjashme shumica e familjeve të lumtura. ■

SHËNIME

1. Leo Tolstoy, *Anna Karenina*, përkth. Constance Garnett (2008), f. 2.
2. “Because I Have Been Given Much”, *Hymns*, nr. 219.
3. “Familja: Një Proklamata drejtuar Botës”, *Liahona*, nëntor 2010, f. 129; theksimi i shtuar.

Lutja dhe Paqja

Nga Lorena W.

Një mbrëmje bëra debat me mamin dhe u ndieva shumë keq. Kështu që vendosa që të lutësja. Edhe pse isha me humor të keq dhe nuk doja të isha "shpirtërore", e dija se të luturit do të më ndihmonte të ndihesha më mirë dhe më pak debatuese. Pasi mami u largua nga dhoma, fillova lutjen. "Atë i dashur Qiellor, po të drejtohem Ty sonte sepse . . ." Jo. I hapa sytë dhe i drejtova krahët; kjo dukej e pavolitshme. U përpoqa sërish. "Atë Qiellor, unë kam nevojë . . ." Edhe kjo tingëlloi e huaj. Ndieva Satanin që më nxiste të hiqja dorë nga lutja ime për t'i kërkuar ndihmë Atit Qiellor.

Befas pata një nxitje që të thoja faleminderit! E bëra këtë dhe mendimet filluan të derdhen në mendje për të gjitha gjërat e shumta për të cilat mund ta falënderoja Atin tim në Qiell. Kur mbarova së falënderuari Atë, diskutova problemin aktual.

Pas kësaj, ndieva një paqe të mrekullueshme brenda meje, ndjenjën e ngrohtë shpirtërore që e dija se Ati ynë Qiellor dhe prindërit e mi më duan dhe se unë jam një fëmijë i Perëndisë. Isha në gjendje t'i kërkoja ndjesë nënës sime dhe të pranoja ndjesën e saj.

Falja Sjell Lumturi

Presidenti Uhtdorf na mëson se duhet t'i falim pjesëtarët e familjes sonë. Shihni se si ndikuan në familjen e tyre zgjedhjet e Xhozefit dhe të Anës.



Xhozefi dhe motra e tij e vogël, Ana, po luajnë së bashku. Ana ia rrëmben lodrën Xhozefit. Çfarë duhet të bëjë Xhozefi?

Xhozefi inatoset me Anën.

Ana qan. Nëna e Xhozefit e dënon atë për shkak të grindjes me të motrën. Xhozefit i vjen keq që bëri një zgjedhje të gabuar.

Xhozefi e fal Anën dhe gjen një tjetër lodër me të cilën të luaj.

Ata luajnë të gëzuar së bashku. Nëna e tyre është e kënaqur që Xhozefi ishte i dashur me motrën e tij dhe ruajti paqen në familje. Xhozefi ndihet i lumtur që zgjodhi të falë.



Më vonë, Xhozefi dhe Ana duhet të ndihmojnë nënën që të përgatisë darkën. Xhozefi nuk ndihmon. Çfarë duhet të bëjë Ana?

Ana i ankohet së ëmës. Ana grindet që i duhet ta kryejë vetëm punën. Në darkë, të gjithë janë të trishtuar për shkak të grindjes.

Ana e fal Xhozefin dhe ndihmon për darkën. Nëna e tyre është mirënjohëse për ndihmën e Anës. Familja kënaqet që janë së bashku për darkën. Ana ndihet mirë që zgjodhi të falë.

Në ç'mënyrë zgjedhjet *tuaja* për të falur ndikojnë në lumturinë e familjes suaj?

Studiojeni këtë material plot lutje dhe, si të jetë e përshtatshme, diskutojeni atë me motrat që vizitoni. Përdorini pyetjet për t'ju ndihmuar të forconi motrat tua dhe për ta bërë Shoqatën e Ndihmës një pjesë aktive të vetë jetës suaj.

Nderimi i Besëlidhjeve Tona

Vizita mësimore është një shprehje e dishepullimit tonë dhe një mënyrë për të nderuar besëlidhjet tona kur i shërbejmë dhe e forcojmë njëra-tjetrën. Një besëlidhje është një premtim i shenjtë dhe i qëndrueshëm midis Perëndisë dhe fëmijëve të Tij. “Kur kuptojmë se jemi fëmijë të besëlidhjes, ne e dimë cilët jemi dhe çfarë pret Perëndia nga ne”, tha Plaku Rasëll M. Nelson i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve. “Ne e kemi bërë ligjin e Tij një pjesë tonën. Ai është Perëndia ynë dhe ne jemi populli i Tij.”¹

Si mësuese vizitore, ne mund t'i forcojmë ato që vizitojmë në përpjekjet e tyre për të mbajtur besëlidhjet e tyre të shenjta. Duke e bërë këtë, ne i ndihmojmë ato të përgatiten për bekimet e jetës së përfundimtare. “Çdo motër në këtë Kishë, që ka bërë besëlidhje me Zotin, ka një urdhërim hyjnor që të ndihmojë për të shpëtuar shpirtin, që të udhëheqë gratë e botës, që të forcojë shtëpitë e Sionit dhe që të ndërtojë mbretërinë e Perëndisë”², tha Plaku M. Rasëll Ballard, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve.

Ndërsa bëjmë dhe mbajmë besëlidhje të shenjta, ne bëhemi mjete në duart e Perëndisë. Ne do të jemi në gjendje që të shprehim besimet tona dhe të forcojmë besimin e njëra-tjetrës te Ati Qiejlor dhe Jezu Krishti.



Nga Shkrimet e Shenjta

1 Nefi 14:14; Mosia 5:5–7; 18:8–13;
Doktrina e Besëlidhje 42:78; 84:106

SHËNIME

1. Rasëll M. Nelson, “Besëlidhjet”, *Liahona*, nëntor 2011, f. 88.
2. M. Russell Ballard, “Women of Righteousness”, *Liahona*, dhjetor 2002, f. 39.
3. *Daughters in My Kingdom: The History and Work of Relief Society* (2011), f. 133.

Çfarë Mund të Bëj Unë?

1. Si më forcojnë besëlidhjet e mia?
2. Si po i ndihmoj motrat për të cilat kujdesem, që të mbajnë besëlidhjet e tyre?

Besim, Familje,
Ndihmë



Nga Historia Jonë

Tempulli është “një vend për falënderim për gjithë shenjtoret” i zbuloi Zoti Profetit Jozef Smith në vitin 1833. Ai është “një vend për udhëzim për të gjithë ata që . . . thirren për veprën e shërbesës, në gjithë thirrjet dhe detyrat e tyre të ndryshme; që ata të mund të përsosën në të kuptuarin e shërbesës së tyre, në teori, në parim dhe në doktrinë, në të gjitha gjërat që çojnë në mbretërinë e Perëndisë mbi tokë” (DeB 97:13–14).

Motrat e Shoqatës së Ndihmës në Navu të Illinoisit, në fillim të viteve 1840, e ndihmuan njëra-tjetrën që të përgatiteshin për ordinancat e tempullit. Në ordinancat e priftërisë më të lartë që shenjtoret e ditëve të mëvonshme morën në Tempullin e Navusë, “fuqia e perëndishmërisë [u] manifest[ua]” (DeB 84:20). “Ndërsa shenjtoret mbajtën besëlidhjet e tyre, kjo fuqi u forcua dhe i mbështeti ata nëpër sprovat e tyre në ditët dhe vitet e mëtejshëm.”³

Në Kishë sot, gra e burra besnikë në mbarë botën, shërbejnë në tempull dhe vazhdojnë të gjejnë forcë në bekimet që mund të merren vetëm nëpërmjet besëlidhjeve të tempullit.

VESHJA DHE PAMJA E JASHTME

Në botën e sotme, shumë nuk e kuptojnë ose respektojnë natyrën e shenjtë të trupave tanë. Shenjtorët e ditëve të mëvonshme shfaqen ndryshe nga bota, duke u veshur në një mënyrë që tregon se ne e dimë se sa të çmuar janë trupat tanë (shih *Për Forcën e Rinisë* [broshura, 2011], f. 6–8). Në faqen 52 të këtij botimi, Meri N. Kuk, këshilltare e parë në presidencën e përgjithshme të Të Rejave, diskuton mbi këtë standard:

“Kur ndërtohet një tempull, tregohet kujdes i madh për të garantuar se është i mbrojtur dhe i stolisur bukur, brenda dhe jashtë. Çelësi në planifikimin e tempujve është të kuptuarit se një tempull *përfaqëson* Zotin – ai është shtëpia e Tij. Ne *i respektojmë* tempujt si ndërtesa të shenja ku mund të hyjnë vetëm ata që janë të denjë. Ne *i nderojmë* tempujt sepse ordinancat dhe besëlidhjet e shenja në të cilat marrim pjesë, bëjnë të mundur për ne që të kthehemi tek Ati ynë Qiellor.

Trupi juaj është më i çmuar sesa tempulli më i bukur mbi tokë. Ju jeni biri ose bija e dashur e Perëndisë! Po të njëjtat parime – paraqitja, respekti dhe nderimi – zbatohen edhe më shumë për mbrojtjen dhe kujdesin që ju i jepni trupit tuaj.”

Sugjerimet vijuese mund t’ju ndihmojnë t’u jepni mësim fëmijëve tuaj parime të sakta për veshjen dhe pamjen e jashtme. Gjithashtu kujtoni se shembulli juaj me veshje të thjeshtë do t’u mësojë fëmijëve tuaj se sa e rëndësishme është veshja e duhur.

Sugjerime për të Mësuar Rininë

- Lexoni me adoleshentët tuaj paragrafin mbi veshjen dhe pamjen e jashtme te broshura *Për Forcën e Rinisë*. Të bërit e kësaj do t’ju japë mundësi të diskutoni doktrinat, bekimet dhe mësimet e këtij standardi dhe t’u përgjigjemi çfarëdo pyetjeje që mund të ketë biri ose bija juaj.
- Merrni parasysh që të mbani një mbrëmje familjare mbi rëndësinë e veshjes dhe pamjes së jashtme. Ju duhet ta pyesni familjen tuaj: “Nëse Zoti do të ishte në Kishë me ju, si do të dëshironit të visheshit?” “Si do donit ta paraqisnit veten para Tij?” “Si ndiheni kur jeni veshur me thjeshtësi?” Ju gjithashtu mund të diskutoni se si të visheni në mënyrë të përshtatshme për raste të tjera, si në shkollë, punë apo aktivitete sociale.

Sugjerime për të Mësuar Fëmijët

- Veshja jonë përfaqëson atë që është e rëndësishme për ne. Për ta ilustruar këtë parim, merrni parasysh që të mbani një mbrëmje familjare në të cilën gjithsecili të vishet si misionar ose të veshë veshjen më të mirë të së dielës.
- Edhe në moshë të njomë, fëmijët mund të fillojnë të vishen me thjeshtësi. Shqyrtoni me fëmijët tuaj udhëzimet në faqen 7 të broshurës *Për Forcën e Rinisë* dhe gjeni veshje që përkrahin këto udhëzime. ■



SHKRIME TË SHENJTA MBI VESHJEN DHE PAMJEN E JASHTME

Zanafilla 1:27;

1 Korintasve 6:19;

Alma 1:27

Bllok Shënimesh për Konferencën e Tetorit

"Atë që unë, Zoti, kam thënë, e kam thënë, . . . qoftë nëpërmjet zërit tim apo nëpërmjet zërit të shërbëtorëve të mi është njësoj" (DeB 1:38).

Pastrimi i Kalendarit Tonë për Konferencën

Nga Sheril Bur

Duke qenë se koha jonë nuk qe e mbingarkuar me aktivitete shtesë, ne mundëm ta ndienim Shpirtin më shumë teksa dëgjoni konferencën e përgjithshme.

Vite më parë, kur të gjashtë fëmijët tanë qenë në moshë të re, ne vendosëm se dëshironim ta bënim konferencën e përgjithshme më kuptimplote për ne. Ne folëm rreth asaj se sa e rëndësishme është ta shohësh konferencën me mendje të kthjellët dhe trupa të çlodhur. Konferenca është një kohë e rëndësishme për të marrë udhëzim nga profetët tanë aktualë. Kështu që, ne vendosëm një synim që të mos planifikojmë asgjë shtesë për disa ditë përpara konferencës ose gjatë fundjavës së konferencës. Ne i nënvizuam ato ditë në kalendarin tonë dhe secili prej nesh u zotua për të mos planifikuar aktivitete shtesë në ato ditë.

Nëse vendosni që të ndërmerrni një qëndrim të ngjashëm, ai do të jetë unik për familjen dhe situatën tuaj, por familja jonë përcaktoi si "aktivitete shtesë" ndjekjen e aktiviteteve shkollore, ardhjen e fëmijëve të lagjes në shtëpi, bërjen e gjërave jashtë shtëpisë me miqtë, organizimin e festave ose darkave me miqtë ose të afërmit, bërjen e projekteve ose punëve në kopsht midis ose gjatë sesioneve të konferencës, ruajtjen e projekteve të shkollës deri në minutën e fundit dhe pranimin e detyrave shtesë në punë.

Kur afroji java përpara konferencës së përgjithshme, ndonjëherë ishte e vështirë t'u thoshe 'jo' këtyre aktiviteteve, por në pjesën më të madhe të kohës pjesëtarët tanë të familjes me gëzim bënë zgjedhjet e duhura për ta përmbushur synimin tonë. Ne zbuluam se fëmijët tanë më të vegjël dëshironin të ishin pjesë e konferencës së përgjithshme. Unë mendoj se kjo ndodhi sepse ne folëm herë pas here rreth rëndësisë së konferencës gjatë gjithë javës së mëparshme.

Jam e lumtur të njoftoj se mbajtja e axhendës sonë sa më thjeshtë ditët përpara dhe gjatë konferencës së përgjithshme ndryshoi plotësisht përvojën e familjes sonë. Zemrat dhe mendjet tona ishin të përgatitura për konferencën. Koha jonë nuk qe e mbingarkuar me aktivitete shtesë, kështu që ne mundëm ta ndienim Shpirtin teksa u ulëm dhe dëgjua fjalët këshilluese nga udhëheqësit tanë.

Ne e kemi vazhduar synimin tonë për konferencën [edhe] pas saj, pasi ajo e mbush shtëpinë tonë me paqe. Edhe pse disa prej fëmijëve tanë nuk jetojnë më në shtëpi, ne i nxisim ata që ende ta pastrojnë kalendarin e tyre disa ditë para dhe gjatë konferencës, siç bëjmë ne në shtëpi. Ne gjithashtu përpiqemi që të planifikojmë një kohë për të parë një sesionin të konferencës së bashku si një familje e plotë. Uroj që kur fëmijët tanë të martohen dhe të kenë fëmijët e tyre, do të vazhdojnë t'i japin rëndësi të madhe mbrojtjes së përvojës së tyre në lidhje me konferencën përmes pastrimit të kalendarëve të tyre. ■



BËJENI KONFERENCËN NJË PËRPARËSI

"Vendosni tani që ta bëni konferencën e përgjithshme një përparësi në jetën tuaj. Vendosni të dëgjoni me kujdes dhe të ndiqni mësimet që jepen."

Plaku Pol V. Xhonsón, i Të Shtatëdhjetëve, "Bekimet e Konferencës së Përgjithshme", *Liahona*, nëntor 2005, f. 52; Konferenca e Përgjithshme, tetor 2005, f. 73.

PËRGJIGJET E SHKOLLËS TË SË DIELËS

Nga Ema Adams

Unë kam një prirje të kërkoj përgjigje të mëdha për sfidat e mia – t'i kërkoj Zotit të më ndihmojë të gjej atë gjë të vetme që do të ndreqë gjithçka. Kam mësuar se një qëndrim i tillë mund t'i komplikojë gjërat më shumë.

Ndërsa po jepja mësim në klasën e Doktrinės së Ungjillit në lagjen time, isha e vendosur të bëja pyetje të thella që do të kërkonin zhytje në mendime dhe përgjigje të plota, të reja e të mprehta. Me fjalë të tjera, dëshiroja të shmangia përsëritjen e të njëjtave “përgjigje [të vjetra] të Shkollës të së Dieles” që dukej se anëtarët e lagjes jepnin çdo javë.

Ndërkohë që studiova mirë Dhiatën e Re gjatë përgatitjes, u ndikova fuqishëm nga përdorimi i fjalës *qëndroj*, e cila shfaqet herë pas here. Për shembull, Gjoni 15:10 thotë: “Po të zbatoni urdhërimet e mia, do të *qëndroni* në dashurinë time, sikurse unë i zbatova urdhërimet e Atit tim dhe *qëndroj* në dashurinë e tij” (theksimi i shtuar).

Në lutjen e Tij të madhe Ndërmjetësuese, Shpëtimtari lutet që dishepujt e Tij “të jenë një, ashtu si ti, o Atë, je në mua dhe unë në ty; edhe ata të jenë një në ne” dhe “Unë jam në ta dhe ti në mua, që të jenë të përsosur në unitet” (Gjoni 17:21, 23).

Ajo që kërkoja më tepër, ishte mënyra se si unë mund të isha një me Zotin, se si unë mund të *qëndroja* në dashurinë e Tij dhe në ç'mënyrë, si përfundim, mund të zhvilloja durim shtesë – durim për të cilin kisha nevojë aq dëshpërimisht që t'i ndryshoja përvojat e mia nga ato që më rraskapitnin në të atilla që të më frymëzonin dhe shenjtëronin.

Për ironi, teksa hetova si për kuptueshmërinë e fjalës *qëndroj* edhe për përgjigjet ndaj sfidave të vështira me të cilat përballesha çdo ditë, këto përfundimisht më drejtuan sërish te përgjigjet e sakta të Shkollës të së Dieles që isha përpjekur t'i shmangia. Unë i gjeta përgjigjet ndaj sfidave të mia duke lexuar shkrimet e shenjta, duke u lutur çdo ditë, duke u shërbyer familjes time dhe të tjerëve, duke vizituar tempullin dhe duke marrë pjesë në mbledhjet e mia të së dieles. Mësova se këto gjëra të thjeshta bëjnë ndryshimin midis durimit dhe të duruarit mirë e me përpjekje.

Përgjigjet e Shkollës të së Dieles me të vërtetë janë përgjigjet më të mira. ■



USHQIMI I BESIMIT TONË

“Shërbimi, studimi, lutja dhe adhurimi janë katër themele për përsosjen e asaj ‘që ende i mungo[n] besimit [tonë]’. (1 Thesalonikasve 3:10.) Nëse ndërpresim të ushqyerit e besimit tonë me ndonjërin prej këtyre katër mënyrave të veçanta, ne jemi të dobët. . . .

Në një botë të pandjeshme, Zoti mund ta depërtojë ndërgjegjen tonë duke përdorur ‘shpatën e Frymës, që është fjala e Perëndisë’. (Efesianëve 6:17; shih gjithashtu Jaromi 1:12.) Megjithatë, dëgjimi duhet të ‘bashk[ohet] me besimin’ (Hebrenjve 4:2) dhe me shërbimin e krishterë, siç kemi dëgjuar vazhdimisht.”

Elder Neal A. Maxwell (1926–2004) of the Quorum of the Twelve Apostles, “Lest Ye Be Wearyed and Faint in Your Minds”, *Ensign*, maj 1991, f. 88.



PËRDORIMI I MATERIALEVE TË MIRATUARA TË KISHËS

“Mësuesit dhe udhëheqësit i përdorin shkrimet e shenjta, mësimet e profetëve të ditëve të mëvonshme dhe materialet e miratuara të programit mësimor për të dhënë mësim e për të dëshmuar mbi doktrinat e ungjillit. Materialet e miratuara të programit mësimor për çdo klasë ose kuorum renditen në materialin më të fundit *Udhëzime mbi Programin Mësimor*. Sipas nevojës, mësuesit dhe udhëheqësit i plotësojnë materialet e programit mësimor me revista të Kishës, veçanërisht botimet e konferencave të përgjithshme të *Ensign*-eve dhe *Liahonave*.”

Handbook 2: Administering the Church [Manuali 2: Administrimi i Kishës] (2010), 5.5.4.

Të Jetuarit me Maturi

NA PËRGATIT PËR TË ARDHMEN

Shenjtorët e ditëve të mëvonshme besojnë në të qenit të përgatitur dhe të mbështetja të vetja. Ne besojmë në përgatitjen nga ana arsimore për punësim, në përgatitjen financiarisht për vështirësitë financiare dhe në përgatitjen materialisht për katastrofat natyrore apo sfida të tjera. Më e rëndësishmja, ne besojmë në përgatitjen shpirtërore për Ardhjen e Dytë të Jezu Krishtit dhe për të jetuar sërish me Atin tonë në Qiell. Kjo qasje kundrejt gatishmërisë quhet të jetuarit me maturi.

Të jetuarit me maturi pasqyron natyrën tonë të vërtetë e të përjetshme: ne duhet “të veprojmë për veten [tonë] dhe të mos detyrohemi të veprojmë” (2 Nefi 2:26). Zoti dëshiron që ne të jemi të përgjegjshëm dhe të pavarur (shih DeB 78:14). Ai dëshiron që ne të jetojmë me maturi për shkak të asaj që ne bëhemi gjatë [këtij] procesi: të përgjegjshëm, bujarë, të matur, të sjellshëm. Pasi sa më të mbështetur të jetë jemi, aq më mirë mund t’i ndihmojmë familjet tona dhe të tjerët. Si mund ta ushqejmë të uriturin nëse ne vetë jemi të uritur? Si mund të japim mësim njohuri nëse ne vetë na mungon njohuria? Si mund ta ndërtojmë

besimin e të tjerëve nëse ne vetë na mungon besimi?

Parimet e të jetuarit me maturi përfshijnë sa vijon:

- Përgatitjen. “Përgatituni ju për atë që do të vijë, pasi Zoti është pranë” (DeB 1:12).
- Zëllin për punë. “Mos jini dembel” (DeB 42:42).
- “Mësoni, madje me anë të studimit dhe gjithashtu me anë të besimit” (DeB 88:118).

Kur anëtarët e Kishës bëjnë gjithçka mundën që të sigurojnë për veten, por ende nuk mund t’i plotësojnë nevojat e tyre bazë, së pari ata u drejtohen familjeve të tyre për ndihmë. Nëse kjo është e pamjaftueshme, Kisha mund t’u vijë në ndihmë. Peshkopët dhe presidentët e degëve mund të përdorin burimet nga “shtëpia” e ruajtjes së Zotit për të ndihmuar anëtarët (shih DeB 82:18–19). Çfarëdo ndihme nga Kisha ka për synim që t’i ndihmojë anëtarët të ndihmojnë vetveten dhe të nxisë punën në jetën e tyre. ■

Për informacion të mëtejshëm, shihni të Zanafilla 41; DeB 38:30.



“Të gjithë ne jemi përgjegjës për t’u kujdesur për veten dhe familjet tona në të dyja mënyrat, si materiale ashtu dhe shpirtërore. Që të kujdesemi me maturi, ne duhet të zbatojmë parimet e jetesës me maturi: të jetojmë me gëzim brenda mundësive tona, të jemi të kënaqur me ato që kemi, duke shmangur borxhin e tepërt dhe duke kursyer me kujdes e duke u përgatitur për vështirësitë e ditëve me shi.”

Plaku Robert D. Hejls i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, “Të Bëhemi Kujdestarë të Matur, Materialisht dhe Shpirtërisht”, *Liahona*, maj 2009, f. 8.

Ne mund të punojmë që të bëhemi të mbështetur te vetja në fushat e mëposhtme:

Forcë shpirtërore:

Mirëbesoni te Zoti; bindjuni urdhërimeve; lutuni dhe studioni shkrimet e shenjta çdo ditë; shërbejuni të tjerëve.



Shëndet fizik: Bindjuni Fjalës së Urtësisë; stërvituni; flini gjumë mjaftueshëm; ushtroni pastërti dhe higjienë të mirë.



Arsim: Bëhuni të shkolluar; pajisuni me aftësi për punë; studioni "librat më të mirë" (DeB 88:118).



Punësim: Punoni për të siguruar për veten dhe për nevojat e familjes suaj.



Ruajtje në shtëpi: Ruani ujë të pastër e të pijshëm dhe gradualisht ndërtoni një rezervë me ushqimet që hani zakonisht, dhe një rezervë ushqimesh me afat më të gjatë, si drithëra dhe bathë.



Financa: Paguani të dhjetat dhe ofertat; shmangni borxhin e panevojshëm; gradualisht krijoni një rezervë financiare.

PËRGJIGJE PYETJEVE

Disa mund të pyesin veten nëse shenjtoret e ditëve të mëvonshme krijojnë rezerva ushqimore. Në të vërtetë, ne ruajmë ushqim dhe ujë për t'u përgatitur për kohët kur ushqimi dhe uji i pijshëm mund të jenë të pamjaftueshëm ose të paarritshëm apo kur financat e familjes shtrëngohen. Në rastet e ngutshme, ata të cilët kanë ruajtur ushqim do të ndihen më të sigurt dhe do të jenë në gjendje për të ndihmuar më mirë familjet dhe fqinjët e tyre gjatë krizave.

Gjëra të Vogla dhe të Thjeshta

"Nëpërmjet gjërave të vogla dhe të thjeshta gjëra të mëdha bëhen" (Alma 37:6).

KUJTOHEN JETË TË SHKËLQYERA

Njuëll K. Uitni (1795–1850)

Poshtë, fotografia majtas: Një portret i gdhendur i Njuëll K. Uitnit. Poshtë, fotografia djathtas: Kati i sipërm i dyqanit të Njuëll K. Uitnit në Kirtland të Ohajos, ku mbaheshin Shkollat e Profetëve dhe mbledhjet e Kishës. Në fund: Dyqani Uitni

Njuëll Kimball Uitni lindi në Vermont të SHBA-së, më 5 shkurt 1795. Ai ishte një biznesmen i talentuar dhe nisi një miqësi dhe një ortakëri biznesi me Sidni Xhibertin. Në fillimet e biznesit të tyre, ata udhëtonin shpesh. Në njërin prej këtyre udhëtimeve të punës, Njuëlli takoi Elizabeta En Smithin në Kirtland të Ohajos. Njuëlli dhe Eni dolën në takime për tre vjet dhe u martuan në vitin 1823.

Së bashku Njuëlli dhe Eni kërkuan të vërtetën dhe për një kohë, morën pjesë në lëvizjen Kampbelajt, që pretendonte se kishte rivendosur krishtërimin e lashtë. Një

natë Njuëlli dhe Eni u lutën "për të ditur nga Zoti se si mund ta merrnin dhuratën e Frymës së Shenjtë". Eni e përshkroi vegimin që morën në përgjigje të lutjes së tyre: "Shpirti qëndroi mbi ne dhe një re e mbuloi shtëpinë. . . . Pastaj ne dëgjua një zë nga reja duke thënë: 'Përgatituni për ta marrë fjalën e Zotit, sepse është duke ardhur.'"¹

Pak pas kësaj përgjigjeje të lutjes, në tetor të vitit 1830, misionarët shenjtorë të ditëve të mëvonshme erdhën në Kirtland. Në nëntor Njuëlli dhe Eni u pagëzuan. Vetëm pak muaj më vonë, Jozef dhe Ema Smithi erdhën të trokisnin në derën

e çiftit Uitni. Kur Jozefi e përshëndeti Njuëllin në emër, Njuëlli nuk mund te thoshte se e dinte emrin e Profetit, ndaj Jozefi u përgjigj: "Unë jam Jozefi, Profeti; ti je lutur që të më kesh këtu, tani çfarë dëshiron prej meje?"² Çifti Uitni më pas e strehoi çiftin Smith për disa javë dhe u gjeti atyre një shtëpi në shtator të vitit 1832.


Përveç sigurimit të një shtëpie për çiftin Smith, Njuëlli i dha Kishës përdorim të plotë të hapësirës në katin e sipërm të dyqanit të tij. Në dyqanin Uitni, udhëheqësit e Kishës mbanin mbledhjet dhe Shkollën e Profetëve.

Në dhjetor të vitit 1831, Njuëlli u thirr si peshkopi i dytë i Kishës dhe më pas shërbeu si administrator i veprimeve financiare të Kishës, duke e ndihmuar Kishën që të administronte fondet e saj dhe të dilte nga borxhi. Në vjeshtën e vitin 1838, çifti Uitni u shpërngul për në Far Uest, Misuri, ku Njuëlli u thirr sërish si peshkop dhe 10 vjet më vonë, ai dhe familja e tij kaluan rrafshinat për në Solt-Lejk-Siti, ku ai shërbeu si Peshkop Kryesues i Kishës.

Njuëlli vdiq më 24 shtator 1850, në Solt-Lejk-Siti nga një sëmundje në aparatin e frymëmarrjes.

SHËNIME

1. Elizabeth Ann Whitney, cituar në Edward W. Tullidge, *The Women of Mormonism* (1877) f. 41–42.
2. Joseph Smith, cituar në Elizabeth Ann Whitney, "A Leaf from an Autobiography", *Woman's Exponent*, 15 gusht 1878, f. 51.



Den Xhons (1810–1862)

Më shumë se një milion misionarë janë thirrur që prej organizimit të Kishës, por Den Xhonsi ishte më shumë se thjesht një në një milion. Për misionarin e Uellsit, Presidenti Gordon B. Hinkli (1910–2008) tha: “Në kuadër të numrit të të kthyerve në besim, Den Xhonsi duhet të përfshihet me siguri në rreth gjysmë duzinën e misionarëve më frytdhënës në historinë e Kishës”¹.

Përpara se të ishte misionar, Deni emigroi nga Uellsi në Shtetet e Bashkuara dhe punoi si kapiten i një anijeje me avull të quajtur *Maid of Iowa*, në *Lumin Misisipi* që solli shumë shenjtore të ditëve të mëvonshme në Nauvu në Illinois. Ai u bashkua me Kishën në vitin 1843 dhe u bë mik i ngushtë me Profetin Jozef Smith.

Misionet e Denit përmbushën profecinë e fundit të shënuar të Jozef Smithit. Natën përpara se Profeti Jozef Smith të vritej, ai dëgjoi të shtëna armësh jashtë dritares së burgut Karthixh, ndaj zgjodhi të flinte në dysheme. Pranë tij që Den Xhonsi. Profeti e pyeti Denin nëse kishte frikë nga vdekja. Ai u përgjigj: “Mendon se ka ardhur ai çast? I përfshirë në një kauzë të tillë nuk mendoj se vdekja do të ishte shumë e tmerrshme.” Atëherë

Profeti profetizoi: “Ti do ta shohësh sërish Uellsin dhe do të përmbushësh misionin që të është caktuar përpara se të vdesësh”².

Premtimi i Profetit u përmbush në vitin 1845 kur Deni dhe e shoqja, Xhejni, u thirrën për të shërbyer në Uells. Deni e përdori talentin e tij në të folur për ta dhënë mësim ungjillin me bindje të madhe. Ai e fliste rrjedhshëm gjuhën e Uellsit dhe gjuhën angleze dhe dëshmitarët shënuan se ai foli në mënyrë aq magjepsëse sa mund të mbante vëmendjen e auditorit të tij në secilën prej gjuhëve për orë të tëra.

Ndërkohë që ishte në Uells, Deni botoi gazeta periodike, broshura dhe libra të shenjtoreve të ditëve të mëvonshme në gjuhën e Uellsit. Nën drejtimin e Den Xhonsit, misionarët në Uells themeluan 29 degë dhe pagëzuan afro 1.000 njerëz për çdo vit të misionit të tij të parë. Ai u

thirr në një mision të dytë në Uells në vitin 1852 dhe pavarësisht shtimit të përndjekjeve ndaj Kishës, u pagëzuan afro 2.000 njerëz në katër vjet.

Pas kthimit të tij në Jutë, Deni ndihmoi për të sjellë shumë të kthyer në besim nga Uells në Jutë. Kur ai vdiq në moshën 51 vjeçare, ai kishte ndihmuar duke sjellë 5.000 njerëz në perëndim të Shteteve të Bashkuara.

SHËNIME

1. Gordon B. Hinckley, “The Thing of Most Worth”, *Tambuli*, mars 1994, f. 8; *Ensign*, shtator 1993, f. 7.
2. Joseph Smith, në *History of the Church*, 6:601.



Nga e majta: Portret i misionarit nga Uells Den Xhons. Një anije me avull, e ngjashme me atë që drejtoi Den Xhonsi si kapiten, që po afron drejt zbarkimit në Nauvu në Illinois. Den Xhonsi ndihmon emigrantët nga Uells.

Dhënia Mësim

PËR DËLIRËSINË DHE VIRTUTIN



Nga Methju O. Richardson,

Këshilltar i Dytë në Presidencën e Përgjithshme të Shkollës të së Dieles

Prindërit mund të përdorin këto gjash të strategji për t'i mësuar fëmijët e tyre rreth intimitetit seksual.

Kam qenë i privilegjuar të takohem me rininë dhe të rinj të moshave madhore nga çdo pozitë shoqërore dhe nga e gjithë bota. Në një rast, unë fola me një grup adoleshentësh veçanërisht mbresëlënës rreth virtutit, dëlirësisë dhe të jetuarit me moral. Pasi u thashë atyre se sa i mahnitur isha me komentet, mirëbesimin, pamjen e jashtme dhe sjelljen e tyre, unë i pyeta: “Si arritët të bëheshit kaq të rrjedhshëm në të folur, të sigurt në përgjigjet tuaja dhe kaq të qetë me një temë të ndjeshme si kjo?” Një e re tha pa hezitim: “Kam prindër që më mësojnë”. Të tjerët miratuan me kokë. Kjo përvojë e thjeshtë por ende e thellë thekson ndikimin që prindërit kanë në jetën e fëmijëve të tyre – veçanërisht në rolin e tyre për t’i mësuar rreth virtutit, dëlirësisë, intimitetit seksual dhe marrëdhënieve të përshtatshme.

Fatkeqësisht, shumë prindër mund të mos jenë duke iu dhënë mësim fëmijëve të tyre aq mirë sa munden në lidhje me çështjet seksuale. Për shembull, gjatë studimit të mbi 200 të rinjve beqarë aktivë, shenjtore të ditëve të mëvonshme, unë zbulova se vetëm 15 përqind i konsideronin prindërit e tyre si burimin kryesor të informacionit lidhur me çështjet seksuale. Këta anëtarë të rinj thanë se ata mësuajnë rreth kësaj teme të rëndësishme fillimisht nga miqtë ose bashkëmoshatarët, interneti, media, reklamat, librat mësimorë, familja e afërt ose

udhëheqësit e tyre të Kishës.

Sigurisht, nuk është një temë e lehtë për t’u dhënë mësim. Por unë besoj se prindërit janë mësuesit më të mirë për të përçuar të tilla parime të shenjta. Strategjitë vijuese do t’ju ndihmojnë të zhvilloni parime dhe praktika të thjeshta, efikase e të qëndrueshme që nxënësit e mësimdhënien efektivisht – veçanërisht gjatë dhënies mësim fëmijëve tuaj për mënyrën se si të jetojnë jetë të virtutshme e të dëlira.

Mësimdhënia dhe të nxënësit duhet të fillojnë herët. Prindërit që i mësojnë fëmijët e tyre në mënyrë efikase lidhur me temat seksuale, e kuptojnë se pjesa më e madhe e fëmijëve i ndeshin të tilla tema në moshë shumë më të hershme sesa ata vetë ose prindërit e tyre i presin apo i dëshirojnë. Shumë fëmijë ekspozohen ndaj përmbajtjes seksuale në internet madje që 11 vjeç dhe disa edhe më të rinj. Vendtakimet argëtuese, ngjarjet sportive, reklamat dhe madje mediat sociale po mbushen në masë të madhe me imazhe dhe aluzione seksuale.

Disa prindër me të drejtë pyesin: “Kur duhet të filloj të flas rreth çështjeve të lidhura me seksualitetin?” Varet nga moshë dhe pjekuria e fëmijës dhe situata e veçantë. Drejtimi shpirtëror do të vijë ndërsa prindërit vëzhgojnë me lutje dhe kujdes sjelljen e fëmijëve të tyre, dëgjojnë qëllimisht fëmijët e tyre dhe gjejnë kohë për të menduar e dalluar kur dhe çfarë të japin mësim. Për shembull, mbaj mend djalin tim duke më bërë pyetje rreth anatomisë kur ishte pothuaj pesë vjeç. Ndonëse ishte disi e sikletshme, që e dukshme se ishte koha e përshtatshme për të folur. Megjithatë, ndërsa mendova se si t’i përgjigjesha, u duk qartë se kjo *nuk* ishte koha e duhur për të



folur me djalin tim për çdo temë të lidhur me seksualitetin.

Mësimdhënia dhe të nxëniti duhet të ndodhin shpesh. Të nxëniti është një proces më tepër sesa një rast i vetëm. Kur bëhet fjalë rreth të mësuarit të fëmijëve për intimitetin seksual ose çështje të tjera të ngjashme, njerëzit shpesh i referohen asaj si “biseda”. Qoftë i qëllimshëm ose jo, ky term të lë të kuptosh se prindërit e japin mësim këtë temë në një bisedë të vetme. Kjo nuk është mënyra më efikase për një fëmijë që të mësojë. Shpëtimtari dha mësim se ne mësojmë “rresht pas rreshti, parim pas parimi” (2 Nefi 28:30). Ne do të kemi më shumë sukses në mësimdhënie ndërsa e rishohim temën me fëmijët tanë teksa rriten dhe piqen. Prindërit, të cilët e kuptojnë këtë parim, e përgatisin veten mendërisht, emocionalisht dhe shpirtërisht për t’u dhënë mësim fëmijëve të tyre rreth temave të lidhura me seksualitetin gjatë fëmijërisë dhe adoleshencës së fëmijëve të tyre.

Të nxëniti dhe mësimdhënia efikase

varen nga marrëdhënia midis mësuesit dhe nxënësit. Kur bëhet fjalë për t’u mësuar fëmijëve rreth temave të lidhura me seksualitetin, pjesa më e madhe e prindërve shqetësohen thuajse vetëm për atë *çka* duhet të thonë. Megjithatë kjo është e rëndësishme, mësimdhënia dhe të nxëniti efikas shkojnë përtej të folurit dhe të treguarit për përmbajtjen. Në fakt, *mënyra* se si prindërit qasen për t’i mësuar fëmijët e tyre mund të jetë më e rëndësishme sesa ajo që ata mund të thonë vërtet. Hulumtimi studimor përkrah përfundimin se prindërit, që i mbështesin fëmijët e tyre më shumë kur kanë të bëjnë me çështjet seksuale, janë ata që komunikojnë më hapur, që shprehin dashuri e shqetësim dhe zotohen aktivisht në jetën e fëmijëve të tyre.¹

Komentet nga studimi im jozyrtar për shenjtoret e rinj të ditëve të mëvonshme, në mënyrë të përsëritur u përqendruan në dëshirën që prindërit e tyre të ishin më të hapur apo më të gatshëm për të folur për tema lidhur me seksualitetin. Këta të rinj në moshë madhore

Prindërit, që i mbështesin fëmijët e tyre më shumë kur kanë të bëjnë me çështjet seksuale, janë ata që komunikojnë më hapur, që shprehin dashuri e shqetësim dhe zotohen aktivisht në jetën e fëmijëve të tyre.

shprehën se jo vetëm që dëshironin që prindërit e tyre të përfshiheshin në këtë proces, por gjithashtu dëshironin që prindërit të “bisedonin *me* ta më tepër sesa t’u flisnin *atyre*”. Ata digjeshin nga dëshira për biseda që ishin “të natyrshme”, “të zakonshme”, “të rehatshme” dhe shumë më pak “të sikletshme”. Kjo duhet t’i nxisë prindërit që të punojnë më shumë për të qenë të afruar, të disponueshëm, të natyrshëm dhe të qetë nga një temë, situatë apo madje koha. Nëse ka ndonjë çmim për t’u paguar për prindërit që t’i mësojnë fëmijët e tyre efektshëm rreth gjërave që kanë më shumë rëndësi, ai është që prindërit të veprojnë në mënyra që i ndihmojnë fëmijët të ndihen rehat dhe të sigurt gjatë bisedimit për të gjitha temat – veçanërisht për ato më personale.

Mësimdhënia dhe të nxëniet janë më efikase kur tema është e përshtatshme dhe e vërtetë. Në varësi të qasjes sonë, mësimdhënia rreth intimitetit seksual mund të ndihet e sikletshme, jorealiste, jopraktike apo edhe moralizuese. Çelësi i suksesit është të kuptohet se shumica e pyetjeve dhe shqetësimeve që fëmijët kanë, janë reagime ndaj situatave dhe vrojtimeve të jetës reale. Ndërkohë që u kushtojmë vëmendje, i dëgjojmë dhe i vëzhgojmë fëmijët tanë, do të dallojmë atë që ne duhet të japim mësim.

Për shembull, filmat, moda, idetë e përhapura, programet televizive, reklammat ose tekstet e muzikës ofrojnë mundësi të bollshme për të folur rreth standardeve morale. Mundësi të tjera do të vijnë ndërsa vëzhgojmë marrëdhëniet dhe bashkëveprimet e fëmijëve tanë me të tjerët, mënyrën se si ata dhe bashkëmoshatarët e tyre vishen, gjuhën që përdorin, se sa të varur ndihen ata nga seksi i kundërt, si dhe interpretimet e shumta për dëlirësinë dhe standardet morale në komunitet. Ka pafund mundësi të jetës reale për të biseduar *me* fëmijët rreth moralitetit dhe virtutit.

Ndoshta aspekti më i rëndësishëm i mësimdhënies për jetën reale realizohet ndërsa prindërit krijojnë një model për dëlirësinë, thjeshtësinë dhe virtutin në vetë jetën e tyre. Fëmijët do ta dëgjojnë dhe ndjekin më me gatishmëri këshillën e prindërve të tyre kur kjo këshillë bazohet te shembujt e mirë të prindërve të tyre.

E kundërta është gjithashtu e vërtetë. Sikurse tha Plaku Robert D. Hejls, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve:

*Ndërkohë që
u kushtojmë
vëmendje, i
dëgjojmë dhe
i vëzhgojmë
fëmijët tanë, do
të dallojmë atë
që ne duhet të
japim mësim.*

“Në shumë mënyra, veprimet tona kanë një ndikim më të fuqishëm te njerëzit e tjerë sesa ajo që themi. Presidenti Brigam Jang (1801–1877) dha mësim: ‘Ne duhet t’u japim [fëmijëve tanë] shembullin që ne urojmë që ata ta kopjojnë. A e kuptojmë këtë? Sa shpesh i shohim prindërit të kërkojnë bindje, sjellje të mirë, fjalë të dashura, shikime të këndshme, zë të ëmbël dhe sy të hapur nga një fëmijë ose fëmijët kur ata vetë janë plot zemërim dhe qortim! Kjo është shumë e papajtueshme dhe e paarsyeshme!’ Fëmijët tanë do t’i vënë re këto mospërputhje te ne dhe ndoshta gjejnë justifikim për të vepruarin në mënyra të ngjashme.”²

Nxënësit mësojnë më mirë kur i kuptojnë ato që mësuesit janë duke

dhënë mësim. Shumë të rinj dhe të rinj në moshë madhore shprehin zemërimin që prindërit e tyre dhe madje udhëheqësit e Kishës tentojnë të përdorin “fjalë me kode” dhe mesazhe me nënkuptim, që faktikisht sjellin më shumë pyetje sesa përgjigje dhe më shumë tension sesa ngushëllim. Kjo është veçanërisht e vërtetë kur bëhet fjalë për tema seksuale.

Ndërsa po shërbeja si peshkop i të rinjve në moshë madhore beqarë të lagjes, shpesh më pyetën se çfarë do të thoshte “peting” [“prekja e pjesëve intime të trupit të një personi tjetër”]. Anëtarëve besnikë të lagjes sime iu qe dhënë mësim se ata nuk duhet të përfshiheshin në peting, por asnjëherë nuk iu mësuara se çfarë do të thotë në të vërtetë peting. Ishte e vështirë për ta që të mbanin udhëzime që nuk i kishin kuptuar.

Presidenti Marion G. Romney (1897–1988), Këshilltar i Parë në Presidencën e Parë, shpjegoi se nuk është e mjaftueshme të japësh mësim në një mënyrë që të tjerët do ta kuptojnë, por ne gjithashtu duhet të japim mësim në një mënyrë që asnjëri nuk do ta keqkuptojë.³ Në vend të të folurit me kode ose edhe zhargon, ne do të kemi më shumë sukses nëse përdorim terma të saktë dhe të përshtatshëm. Kjo siguron kuptueshmëri dhe zhvillon respekt.

Merrni parasysh se si Plaku Riçard G. Skot, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, dha mësim në mënyrë efektive parimet dhe standardet morale. Ai tha: “Çfarëdolloj intimiteti seksual jashtë lidhjeve të martesës – dua të them çdo kontakt i qëllimshëm me pjesët e shenjta e



personale të trupit të personit tjetër, me ose pa rroba – është një mëkat dhe është i ndaluar nga Perëndia. Është gjithashtu shkelje të nxitësh qëllimisht këto emocione brenda vetë trupit tuaj.”⁴

Në mënyrë që të japim mësim efektshëm, ne duhet të sigurohemi se ata, të cilëve u japim mësim, e kuptojnë mesazhin. Pyetjet e thjeshta si: “A i përgjigjet kjo pyetje suaj?” ose “A e shpjegova atë shumë mirë?” apo “A keni pyetje të tjera?” janë shumë ndihmuese.

Nxënësit kthehen në besim kur mësuësit e lidhin mesazhin me parimet dhe standardet e përvetshme. Në vend të përqendrimit vetëm mbi “faktet [e lidhura me] riprodhimin njerëzor”, mësimdhënia e vërtetë e ungjillit ndodh kur ne i lidhim këto fakte me “faktet e jetës së përvetshme”. Për shembull, kur flasim për trupat tanë, ne mund të flasim për mënyrën se si një Atë i dashur Qiellor krijoi trupat tanë dhe se si ne duhet t’u qasemi krijesave të Tij me respekt dhe sipas pritshmërive të Tij.

Ndërsa bota zhytet në imoralitet, ka ende shpresë për brezat e ardhshëm. Kjo shpresë

përqendrohet te prindërit, që i përkushtojnë përpjekjet e tyre më të mira për të mësuar brezin e ri që të jenë të vërtetshëm dhe të dëlirë. Prindërit, të cilët u mësojnë fëmijëve të tyre të jetojnë jetë të vërtetshme e të dëlira, përpiqen të rrisin kuptueshmërinë dhe të përmirësojnë aftësitë e tyre të mësimdhënies. Duke bërë këtë gjë, ata arrijnë të dinë se “Zoti do t’i lartësojë [ata] ndërsa [ata] japin mësim në mënyrën që Ai i ka urdhëruar”. Në fund të fundit, kjo “është një punë e dashurisë – një mundësi për t’i ndihmuar të tjerët të ushtrojnë me drejtësi lirinë e tyre të zgjedhjes, të vijnë te Krishti dhe të marrin bekimet e jetës së përvetshme.”⁵ ■

SHËNIME

1. Shih Bonita F. Stanton and James Burns, “Sustaining and Broadening Intervention Effect: Social Norms, Core Values, and Parents”, në *Reducing Adolescent Risk: Toward an Integrated Approach*, red. Daniel Romer (2003), f. 193–200.
2. Robert D. Hales, “Our Parental Duty to God and to the Rising Generation”, *Liahona*, gusht 2010, f. 74.
3. Shih Jacob de Jager, “Let There Be No Misunderstanding”, *Ensign*, nëntor 1978, f. 67.
4. Richard G. Scott, “Serious Questions, Serious Answers”, *Liahona*, shtator 1997, f. 31.
5. *Teaching, No Greater Call* (1999), f. 4.

Ndoshta aspekti më i rëndësishëm i mësimdhënies për jetën reale realizohet ndërsa prindërit krijojnë një model për dëlirësinë, thjeshtësinë dhe vërtetësinë në vetë jetën e tyre.

Mësimdhënia

E DREJTËSISË

NË SHTEPI

Është një përgjegjësi dhe bekim që prindërit kanë për të dhënë mësim dhe për të edukuar fëmijët e tyre që të jetojnë me drejtësi.



Nga Plaku
Delbert L. Stepli
(1896–1978),

i Kuorumit të
Dymbëdhjetë
Apostujve

Delbert L. Stepli u lind më 11 dhjetor të 1896-ës, në Arizona të SHBA-së. Ai u veçua si anëtar i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve më 5 tetor 1950 dhe shërbeu në atë kuorum deri në vdekjen e tij më 19 gusht 1978. Ky fjalim i takimit shpirtëror u dha në Universitetin "Brigam Jang" më 1 shkurt 1977. Teksti i plotë i këtij fjalimi në gjuhën angleze mund të gjendet te adresa speeches.byu.edu.

Prindërit kanë një mundësi për të dhënë mësim dhe për të brumosur karakteret e fëmijëve të tyre të vegjël përpara se Satani të ketë fuqinë t'i tundojë ata dhe përpara se ata të arrijnë moshën tetë vjeç, duke u bërë më pas përgjegjës përpara Perëndisë. . . . Zoti u ka dhuruar prindërve këto vite të çmuara, vitet e para të jetës së fëmijës, kur fëmijët nuk janë përgjegjës për gjërat që thonë dhe bëjnë. Është një përgjegjësi dhe bekim që prindërit kanë për të dhënë mësim dhe për të edukuar fëmijët e tyre që të jetojnë me drejtësi.

Mënyra më efikase për të dhënë mësim drejtësinë dhe fenë në shtëpi është nëpërmjet shembullit. Shpresojmë që prindërit do ta kenë mbajtur vetë jetën e tyre të qetë e të

pastër dhe si pasojë të mund ta përdorin me dobi shembullin e jetës së tyre në mësimdhënien dhe edukimin e vetë fëmijëve të tyre. [Presidenti Dejvid O. Mek-Kei (1873–1970) dha mësim:] “Nëse do të jepni mësim besimin në Perëndi, tregoni vetë besim në Të; nëse do të jepni mësim lutjen, lutuni vetë; . . . nëse doni që ata të jenë të përmbajtur, atëherë vetë ju duhet të jeni të vetëkontrolluar; nëse do t'i kërkonit fëmijës suaj të jetojë një jetë të virtytshme, të vetëkontrolluar, me famë të mirë, atëherë vendosni një shembull të denjë në të gjitha këto gjëra për fëmijën tuaj”¹. Duke vepruar kështu do t'i bëni këto mësim më të rëndësishme për fëmijët tuaj; dhe ata, duke marrë këtë lloj drejtimi nga prindërit, mund të fuqizojnë vetveten kundër tundimeve të Satanit, qëllimi i të cilit është të shkatërrojë jetën e tyre kur ata vërtet të arrijnë moshën e përgjegjshmërisë. Prindërit kanë për detyrë të jenë çfarë ata do të donin që fëmijët e tyre të bëheshin në lidhje me mirësjelljen, sinqeritetin, përmbajtjen dhe kurajën për të vepruar drejt në të gjitha kohët. Shembulli është shumë më i fuqishëm sesa porosia morale.

Jeta e përditshme në shtëpi duhet të përpuhet me parimet dhe standardet tona të Kishës. Marrëveshjet tona të punës duhet të pajtohen me fenë tonë. Fëmijët janë të mprehtë për të zbuluar mungesën e sinqeritetit. Xhon Milton tha se hipokrizia është mëkati i vetëm që ecën pa u vënë re, përveçse nga vetë Perëndia. Megjithatë, fëmijët janë të ndjeshëm ndaj gjërave që janë të gabuara, dhe ata e kanë zët mungesën e sinqeritetit dhe shtirjet false. Ne e dimë se fëmijët ndikohen shumë më tepër nga predikimet që vëmë në jetë, sesa nga predikimet që themi. Prindërit duhet të jenë gjithmonë të ndershëm me fëmijët e tyre, duke i mbajtur



premtimet që u bëjnë atyre dhe duke thënë gjithmonë të vërtetën. Prind i qëndrueshëm është ai që fiton mirëbesimin e fëmijës së tij. Kur një fëmijë e kupton se ju e respektoni mirëbesimin e tij dhe ia ktheni në të njëjtën mënyrë, fëmija juaj nuk do ta shkelë mirëbesimin tuaj dhe as nuk do t'ju turpërojë. . . .

Prindërit nuk duhet të grinden kurrë në prani të fëmijëve të tyre. Ndonjëherë grindjet shkaktohen nga përpjekja për të korrigjuar ose disiplinuar një fëmijë. Njëri prind kritikon; tjetri kundërshton. Dhe, për sa i takon fëmijës, nuk bëhet ndikimi i unifikuar i shtëpisë. Prindërit duhet të jenë të bashkuar për të ditur se në cilin drejtim dëshirojnë ata që fëmija të shkojë; përndryshe, ai do bëjë zgjedhje të gabuara si pasojë e hutimit. Riçard L. Evans tha: "Mosmarrëveshja midis prindërve është e padrejtë e hutuese dhe dobëson themelet e familjes. Ata, te të cilët një fëmijë duhet të shohë për udhëheqje, duhet të jenë të bashkuar në drejtimin që japin."² Ne e dimë se fëmijët janë të ndjeshëm ndaj gjendjeve shpirtërore dhe ndjenjave të familjes; ata mund të ndiejnë tension dhe ndryshime që jo gjithmonë mund t'i kuptojnë ose shpjegojnë. . . .

Një fëmijë ka të drejtën të ndiejë se në shtëpinë e tij ai ka një vend strehimi, një vend mbrojtjeje nga rreziqet dhe të këqijat e botës

së jashtme. Për ta siguruar këtë nevojë janë të domosdoshme bashkimi dhe integriteti moral i familjes. Nuk ka asnjë vend tjetër përveçse shtëpisë, ku mund të gjenden lumturia e vërtetë dhe e përhershme në këtë jetë. Është e mundur për ta bërë shtëpinë një copëz qielli; me të vërtetë, unë e përfytyroj qiellin të jetë një vazhdim i jetës ideale në shtëpi këtu në tokë.³ . . .

Ungjilli që japim mësim është i vërtetë. Krishti jeton, Perëndia jeton dhe shtëpi të lavdishme janë përgatitur lart për të gjithë fëmijët e Tij besnikë e të përkushtuar. Planifikojeni tani llojin e shtëpisë dhe familjes që dëshironi, dhe mënyrën se si do t'i përmbushni nevojat e fëmijëve tuaj, për t'i mbajtur ata në shtegun e drejtë që do ta drejtojë familjen në jetën e përjetshme në një shtëpi çelestiale. Perëndia ju bekoftë të gjithëve ju, vëllezër e motra të mia. Mendoj që ju mund ta kuptoni se shumë nga ajo çka u tha, iu përket juve. Dhe organizimi e çuarja përpara e shtëpisë suaj në një mënyrë të shenjtë është shumë e rëndësishme për të rinjtë që vijnë për t'ju bekuar jetën. ■

Përdorimi i germës së madhe dhe pikësimi i standardizuar.

SHËNIME

1. David O. McKay, *Secrets of a Happy Life*, përmb. Llewelyn R. McKay (1967), f. 11.
2. Richard Evans' *Quote Book* (1975), f. 23.
3. Shih David O. McKay, *Gospel Ideals* (1953), f. 490.

Një fëmijë ka të drejtën të ndiejë se në shtëpinë e tij ai ka një vend strehimi, një vend mbrojtjeje nga rreziqet dhe të këqijat e botës së jashtme. Për ta siguruar këtë nevojë janë të domosdoshme bashkimi dhe integriteti moral i familjes.



NDIHMJA PËR RININË QË TË KETË PËRVOJA SHPIRTËRORE

Askush nuk mund t'i detyrojë të rinjtë të kenë përvoja shpirtërore, por ashtu si zbuluan këta prindër dhe udhëheqës, ka shumë mënyra për të ushqyer përvoja që çojnë drejt kthimit në besim.

Kur Vjaçeslav dhe Zoja Gulko nga Ukraina filluan të kërkonin për Kishën, vajza e tyre 13-vjeçare, Kira, nuk u ngazëllye. Ajo refuzoi që të merrte pjesë në mësimet e misionarëve dhe, kur mori vesh që misionarët po vinin në shtëpinë e tyre, ajo “në mënyrë demonstrative mbylli derën e dhomës së saj”, kujton e ëma.

Vëllai dhe Motra Gulko, të cilët vendosën të bashkoheshin me Kishën, menduan se nëse ata thjesht mund të siguronin një mundësi për Kiran që të ndiente Shpirtin, zemra e saj do të mund të prekej. Për shkak se dëshmia vetjake e Motrës Gulko filloi kur ajo mori pjesë në pagëzimin e një personi tjetër, ajo i kërkoi Kiras të vinte në pagëzimin e saj – thjesht për ta ndihmuar atë të ndërronte rrobat e lagura më vonë. Për habi të Motrës Gulko, Kira pranoi.

“Ajo ndodhi!” kujton Motra Gulko. “Ati Qiellor po punonte në një mënyrë shumë të

mrekullueshme.” Kira vërtet e ndieu Shpirtin dhe, një javë pas pagëzimit të prindërve të saj, ajo ra dakord që të takohej me misionarët. Ajo nisi të lexonte Librin e Mormonit. Pak javë më vonë, Motra Gulko vuri re një copë letre të varur mbi tavolinën e Kiras; mbi të qenë shkruar fjalët e 2 Nefit 2:25. Dy muaj e gjysmë pas pagëzimit të tyre, çifti Gulko mori pjesë në pagëzimin e së bijës. Tani, 20 vite më vonë, Kira është martuar. Ajo dhe bashkëshorti i saj, Dejvi, janë vulosur në tempull dhe po rrisin në ungjill dy djemtë e tyre. Ajo ka shërbyer besnikërisht në shumë thirrje dhe ka qëndruar aktive në Kishë.

Përmes asaj përvoje, Zoja thotë se ajo mori një mësim vendimtar që është po aq i zbatueshëm për prindërit që janë anëtarë të Kishës gjithë jetën, sikurse ishte për atë dhe bashkëshortin e saj si anëtarë të rinj: prindërit dhe udhëheqësit nuk mund t'i detyrojnë fëmijët e tyre në ungjill, por *mund* t'i ftojnë ata në vende dhe të krijojnë përvoja ku të rinjtë mund të kenë përvojat e tyre shpirtërore. Më pas, ato përvoja mund t'i çojnë drejt kthimit në besim.

Por, cila është mënyra më e mirë për t'i krijuar këto lloj përvojash? Prindërit dhe udhëheqësit nga e gjitha bota tregojnë atë që ka funksionuar për ta.

*Lidhini shembujt e kohës së sotme me fjalën
e Perëndisë dhe jetën e të rinjve.*



Jepuni të Rinjve Mundësi për të Shërbyer

Lagjja Granja-Viana në Kunjin e San-Paolos, Kotia në Brazil kishte një përqindje të lartë aktivizimi midis të rinjve të saj. Por udhëheqësit e tyre vunë re se disa prej tyre po përballeshin me sfida vetjake dhe kishin vështirësi për të përmbushur detyrat e tyre të priftërisë.

Pasi peshkopata dhe udhëheqësit e Të Rinjve u këshilluan së bashku, ata vendosën t'i përqendronin më shumë aktivitetet e tyre te shërbimi dhe jo aq shumë te argëtimi ose dëfrimi. Kjo përfshiu vizita tek anëtarët më pak aktivë të kuorumit, marrjen pjesë në kthimin në besim me misionarët kohëplotë dhe administrimin e sakramentit te anëtarët e lagjes të kufizuar nga sëmundja. Këto aktivitete iu ofruan të rinjve një mundësi për të vepruar sipas parimeve që ata po mësonin në seminar dhe të dielave (shih 2 Nefi 2:26).

Me kalimin e kohës, “këto aktivitete shpirtërore patën një ndikim të madh për mirë”,

raportoi një udhëheqës i priftërisë.

“Ne u mahnitëm kur në një të diel të veçantë agjërimi, të gjithë të rinjtë tanë ndanë dëshmitë e tyre”, tha ai. “Ndërsa e bënë këtë, shumë prej tyre kujtuan me lot frymën e mirë që ata kishin ndier në ato raste. Një i ri tregoi përvojën e administrimit të sakramentit te një anëtar më i moshuar i lagjes sonë, i cili ishte dergjur në shtrat për tre vite. Bashkëshortja e tij, një motër besnike, e pranoi të riun tonë me gëzim dhe shpresë. Pas ordinancës, ajo ndau me ta lumturinë që ndiente në jetën e saj për shkak të ungjillit, pavarësisht problemeve dhe sfidave të mëdha që ajo po haste. Ata e ndien Shpirtin dhe e kuptuan ndryshimin që ungjilli bën në jetën e njerëzve. Kjo përvojë ishte aq e fuqishme sa që ata do ta kujtojnë për vitet që do të vijnë – ndoshta për gjithë jetën e tyre.”

Ai vë në dukje se nuk e ka parë kurrë atë lloj përgjigjeje nga asnjë “lojë futbolli ose Aktivitet të Përbashkët argëtues”. Përkundrazi, thotë ai, përvoja i mësoi atij rëndësinë e nxitjes së atyre lloj përvojash në të cilat rinia mund të ndiejë Shpirtin.

“Aktivitetet sociale janë të rëndësishme”, vazhdon ai. “Por përvojat shpirtërore janë vendimtare për të ndihmuar të rinjtë të ndërtojnë dëshmitë e tyre vetjake.”

Çdo të diel në Lagjen Rene, Kunjin Anzher në Francë, Motra Delfin Letort, si presidente e Të Rejave, i jepte një kartolinë çdo të reje pjesëmarrëse dhe i kërkonte të zgjidhte një bashkëmoshatare që nuk ishte në Kishë dhe t'i shkruante asaj. Të rejat shkruanin rreth mësimi të asaj jave – atë që kishin mësuar ose atë që i kishte frymëzuar – si dhe një shënim miqësor e personal. Më pas, Motra Letort ose një nga këshilltaret e saj i dërgonin kartolinat me postë tek vajzat që nuk ishin në Kishë.

Aktiviteti ishte i thjeshtë por i efektshëm, thotë ajo, jo vetëm si një mënyrë për ato që

*Jepni mësim duke përdorur fjalë të
profetëve të gjallë si dhe atyre të lashtë.*

nuk po merrnin pjesë, që ta dinin se po i kujtonin, por gjithashtu edhe për ato që po i shkruanin shënimet që ta kujtonin më shpesh njëra-tjetrën.

“Nëpërmjet gjërave të vogla dhe të thjeshta gjëra të mëdha bëhen”, tha ajo (shih Alma 37:6). “Ne e kemi parë atë të manifestohet. Të rejat janë inkurajuar dhe kjo përvojë ka kontribuar në rritjen e dëshmive të tyre.”


Lidheni Rininë me Fjalën e Perëndisë

Alma dha mësim se predikimi i fjalës së Perëndisë ka një ndikim të fuqishëm (shih Alma 31:5). Dejvid Elmer, udhëheqës i Të Rinjve në Teksas, SHBA, e dinte këtë dhe dëshironte që t’u siguronte të rinjve që ai udhëhiqte, një udhëtim bojskauti aventuresk me një përvojë kuptimplote, që do t’i ndihmonte ata të përgatiteshin për të ardhmen.

Vëllai Elmer me lutje mendoi se çfarë mund të ndante dhe u ndie i drejtuar te një bisedë nga Plaku Nil L. Andersen, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve. Gjatë udhëtimit, Vëllai Elmer dha mësim nga ai mesazh, përfshirë historinë që Plaku Andersen tregoi për Sidni Going, një yll regbie në Zelandën e Re, i cili la mënjanë karrierën në sport për të shërbyer një mision. “Misioni juaj do të jetë një mundësi e shenjtë për të sjellë të tjerët te Krishti dhe për të ndihmuar në përgatitjen për Ardhjen e Dytë të Shpëtimitarit”, tha Plaku Andersen.¹

Përvoja ishte e fuqishme, thotë Vëllai Elmer, sepse ai dha mësim nga fjalët e një profeti të gjallë. Në fund të takimit shpirtëror, të gjithë të rinjtë dhe udhëheqësit nënshkruan emrat e tyre mbi topat e regbisë si një zotim për të shërbyer në misione dhe si një kujtues i prekshëm i asaj që kishin mësuar dhe ndier. Atë natë, shumë nga baballarët dhe udhëheqësit qëndruan pa gjumë duke folur me të rinjtë për mënyrën se si misionet ndikuan në jetën e tyre.

“I yni është Perëndi i veçantë; Ai e njeh rininë e Tij”, thotë Vëllai Elmer. “Ai është i vetëdijshëm për jetën dhe sfidat e tyre dhe për atë që po ndodh me këta fëmijë. Ju kurrë nuk e dini se si po punon Ai në jetën e tyre. Ndaj, ne si udhëheqës përgatisim dhe sigurojmë atmosferën për ta që të ndiejnë Shpirtin. Ju mund ta bëni këtë përmes shkrimeve të shenjta dhe përmes fjalëve të profetëve, por është Zoti, jo ne, që po punon në zemrat e tyre.”



Jini Konsekuentë

Vëllai Elmer thotë se ai dëshiron që të rinjtë të kujtojnë diçka tjetër rreth udhëtimit: studimi i tyre për ungjillin ishte konsekuent.

“Unë ndieva se pjesë e përgjegjësisë sime ishte t’u ofroja atyre përvoja që të ndienin Shpirtin dhe, nëse dëshiroja që ajo të ndodhte, unë duhet të bëja pjesën time që ta planifikoja”, thotë ai. “Plaku Dejvid A. Bednar ka dhënë mësim rreth krijimit të modeleve shpirtërore në jetën tonë, modele si studimi i shkrimeve të shenjta, lutja dhe mbrëmja familjare.² Dhe ndërsa u larguam atë javë, ne i ruajtëm modelet tona shpirtërore. Ne u lutëm si një grup. Ne caktuam të rinj që të drejtonin një takim shpirtëror prej 10 minutash në mëngjes, dhe udhëheqësit e baballarët e tyre përgatitën takimet shpirtërore për mbrëmjen.

Çështja ishte se, edhe pse ne ishim larg shtëpive dhe aktivitetet tona ishin të ndryshme nga ç’janë zakonisht, modelet tona shpirtërore nuk u ndërpreën. Të rinjtë mund të kujtojnë ose jo mësimet të veçanta, por unë shpresoj se ata do ta kujtojnë modelin që ne ruajtëm për të pasur takime shpirtërore, lutje dhe studim të shkrimeve të shenjta.”

Mira Bokobo Garsia nga Filipinet gjithashtu e di vlerën

*Gjeni momente të zakonshme mësimdhënieje
në aktivitetet e përditshme.*



e konsekuencës dhe ajo e di se të mësuarit e saj fillon në shtëpi. Motra Garsia dhe bashkëshorti i saj, Eduin, kanë tre djem dhe gjashtë vajza nga mosha 8 deri në 22 vjeç, secili i përfshirë në aktivitete të ndryshme e të dobishme. Ndërsa kjo mund të nënkuptojë shumë njerëz të përfshirë në aktivitete të ndryshme, familja punon shumë për të ngrënë darkë vazhdimisht së bashku.

“Gatimi dhe përgatitja e ushqimit me lumturi e të ngrënit së bashku është një nga mënyrat më të mira se si ne i mbledhim fëmijët tanë”, thotë Motra Garsia. Ajo vëren se vakti është një kohë për t’u çlodhur, për t’u lidhur me njëri-tjetrin dhe për të njohur bekimet e Zotit.

Përdorni Mundësitë Ekzistuese për të Dhënë Mësim dhe për të Nxënë

Xhoslin Filden nga Nova-Skocia, Kanada, thotë se mësimet më vendimtare që ajo mësoi nga rritja e gjashtë fëmijëve, që tani janë të moshave 20 deri në 30 vjeç, kanë të bëjnë

jo vetëm me mësimdhënien e drejtpërdrejtë por edhe me “krijimin e një mjedisi ku fëmijët mund të mësojnë të vërtetat për veten e tyre”.

“Mos u nxitoni që t’i bëni të gjitha zgjedhjet e tyre apo t’u përgjigjeni të gjitha pyetjeve të tyre”, thotë ajo. Përkundrazi, ajo rekomandon t’i drejtoni fëmijët te “shkrimet e shenjta ose këshilla nga profeti ynë për drejtim dhe përgjigje”. Ajo shton: “Dhe jini të gatshëm të diskutoni konkluzionet e tyre”. Veç kësaj, kur fëmijët e saj e pyesin, ndonjëherë përgjigjet duke i bërë një pyetje vetes: “Ç’mendon se duhet të bësh?”

“Kini mirëbesim se ata do të bëjnë zgjedhje të drejta”, thotë ajo. “Kur ne i ndihmojmë fëmijët tanë të mësojnë të njohin Shpirtin në jetën e tyre gjatë shumë momenteve të mësimdhënies që kemi çdo ditë me ta, dhe kur ata e dinë se si mund ta dallojnë Shpirtin, për ta do të jetë një katalizator për të kërkuar më shumë përvoja shpirtërore, duke forcuar si rrjedhim dëshmitë e tyre për realitetin e Atit tonë Qiejllor dhe të Birit të Tij, Jezu Krishtit. Kjo shkakton një efekt vale: sa më shumë e ndiejnë dritën dhe ngushëllimin që sjell Shpirti, aq më shumë do ta dëshirojnë atë dhe do përpiqen fort të bëjnë gjërat që do ta bëjnë Shpirtin më të bollshëm në jetën e tyre.”

Ajo menjëherë nxjerr në pah se parimet që kanë qenë të dobishme në jetën e saj familjare, janë ato që udhëheqësit e Kishës kanë dhënë mësim në mënyrë të përsëritur. Për shembull, ajo thotë se ndërsa disa mësimet mund të ndodhin gjatë diskutimeve formale si ato që ndodhin në mbrëmjen familjare, studimin familjar të shkrimeve të shenjta dhe lutjen familjare, prindërit mund të udhëhiqen nga Shpirti për të gjetur momente të mësimdhënies.³

“Dalja xhiro, ngarja e makinës për në aktivitete, bërja kosh [luajtja basketboll], mbajtja e vakteve me familjen, të punuarit së bashku,

Si Qëndrova i Fortë në Ungjill

Nga Tua Roxhers

Unë u pagëzova kur isha 12 vjeç, dhe për shumë vite isha i vetmi anëtar i Kishës në familjen time. Kjo nuk ishte gjithnjë e lehtë, por fatmirësisht u bekova me udhëheqës të mirë që më ndihmuan në udhëtimin tim e të mësuarit të doktrina të Ungjillit dhe të përdorimit të atyre doktrina të forcuar dhe përmirësuar jetën time. Për shkak të vendimit tim për të qëndruar i vërtetë ndaj asaj që besova, unë kam parë bekime të mëdha të vijmë në jetën time dhe, më vonë, gjithashtu në jetën e pjesëtarëve të familjes.

Në vijim janë disa gjëra që më ndihmuan të qëndroja i fortë:

- Qëndroni afër Atit Qiellor përmes aktiviteteve si lutja dhe studimi i shkrimeve të shenja. Ai është i vetëdijshëm për situatat që hasim. Të qëndruarit pranë Tij më ndihmoi të kujtoj se cili jam.
- Ndiqni këshillën e udhëheqësve të Kishës. Kam parë në vetë jetën time të vërtetën e këshillës nga profetët dhe apostujt.
- Dijeni se të jetuarit e ungjillit krijon një jetë më të mirë tani dhe në përjetësi. Kjo më ka ndihmuar të mbaj standardet dhe

besimin tim. Udhëheqësit më nxitën të vizitoj tempullin, i cili më ndihmoi të përfytyroj jetën e përjetshme.

- Rrethohuni me miq të mirë që ndajnë standardet tuaja. Unë u bekova me miq të mirë që e bënë më të lehtë marrjen e vendimeve të mira dhe ruajtjen e besimit tim.
- Qëndroni afër familjes suaj. E doja familjen time dhe dëshiroja të ndërtoja marrëdhënie të forta me ta.
- Jetojeni jetën. Ndiqni standardet dhe merrni pjesë në programet e Kishës. Ato do t'ju ndihmojnë të shfaqni besim dhe të merrni vendime të mira. Vendimet e mira shpesh e bëjnë jetën më të lehtë dhe gjithmonë e bëjnë jetën më të lumtur.

të kënduarit dhe shërbimi ndaj të tjerëve janë thjesht disa aktivitete ku mësimdhënia e ungjillit ka ndodhur në familjen tonë”, thotë ajo. “Të folurit rreth temave të ungjillit shpesh ndodh natyrshëm kur ne angazhohemi me aktivitete të tjera.”

Punoni së Bashku drejt një Qëllimi të Përbashkët

Pak pas diplomimit nga Universiteti “Brigam Jang” – Havai, KaJan Danise Mok u kthye në shtëpi në Hong-Kong dhe pranoi thirrjen si presidente e Të Rejave. Ndërsa po përshtatej me të qenit në shtëpi, për të filluar një karrierë dhe për të vazhduar studimet pasuniversitare, ajo u lut me zell për frymëzim për t'i ndihmuar të rejtat me të cilat punonte, të zhvillonin dëshmi për t'i përgatitur ato për të ardhmen.

Një të diel, teksa po jepte mësim për perspektivën e përjetshme, Motra Mok ndieu nxitjen për të lexuar Librin e Mormonit me një të re të veçantë, që ndodhi të ishte e vetmja anëtare në Kishë atë ditë.

“Këshilltarja ime dhe unë iu përgjigëm shpejt [nxitjes], duke vendosur qëllime për ta përfunduar Librin e Mormonit si një grup me të renë”, thotë Motra Mok. “Ajo e pranoi sfidën pa hezitim meqënëse ne do ta përmbushnim qëllimin së bashku.”

Që nga ajo kohë, Motra Mok, këshilltarja e saj dhe kjo e re krijuan një “sistem për miqtë” në Facebook dhe nëpërmjet dërgimit të mesazheve kujtojnë njëra-tjetrën që të lexojnë dhe ndajnë me njëra-tjetrën atë që po mësojnë.

Motra Mok thotë se ajo pa shenja të një ndryshimi të mahnitshëm në jetën e kësaj të reje për shkak të studimit të saj të shkrimeve të shenja. Dhe ndërsa Motra Mok i lexoi shkrimet e shenja në udhëtimin e saj të përditshëm me tren, ajo gjithashtu mori bekime për veten e saj. “Unë gjithashtu e ndieva Shpirtin dhe mora përgjigje për lutjet e mia ndërsa vazhdova të ecja përpara në jetë”, thotë ajo.

“Nga përvoja ime, disa të rinj shqetësohen dhe ndihen të pasigurt rreth asaj nëse ata mund të marrin një dëshmi dhe të kenë përvoja shpirtërore sikurse kanë të tjerët”, vazhdon ajo. “Duke punuar së bashku, ne i sigurojmë ata, me veprimin tonë, se kjo funksionon dhe se ne jemi atje për t'i mbështetur ata në çdo hap të udhës.” ■

SHËNIME

1. Nil L. Andersen, “Të Përgatisësh Botën për Ardhjen e Dytë”, *Liahona*, maj 2011, f. 51.
2. Shih Dejvid A. Bednar, “Më të Zellshëm dhe më të Përfshirë në Shtëpi”, *Liahona*, nëntor 2009, f. 17–20.
3. Shih, për shembull, Robert D. Hejls, “Detyra Jonë ndaj Perëndisë: Misioni i Prindërve dhe Udhëheqësve ndaj Brezit të Ri”, *Liahona*, maj 2010, f. 95–98; Dejvid A. Bednar, “Më të Zellshëm dhe më të Përfshirë në Shtëpi”, *Liahona*, nëntor 2009, f. 17–20.



Nga Plaku Pol B. Pajper,

i Të Shtatëdhjetëve

LIBRI I ALMËS: MËSIMET PËR TË SOTMIEN

Nefitët i duruan besnikërisht sprovat e kohës së tyre dhe janë dëshmitarë se Zoti do të sigurojë bekimet dhe mbrojtjen që na duhen, për të përballuar me sukses sfidat e kohës sonë.

Në përfundim të mbretërimit të tij, Mbreti Mosia propozoi që monarkia të zëvendësohej me një sistem gjykatësish të zgjedhur nga populli. Sistemi i propozuar do të bazohej mbi ligjet e dhëna nga Perëndia që do të administroheshin nga gjykatës të cilët do të zgjidheshin nga populli.

Parimi i lirisë së zgjedhjes që themeli i sistemit të propozuar – në vend të një mbreti, përgjegjësia dhe përgjegjshmëria për të vepëruar në përputhje me ligjin do të pranohej nga individë. Për shkak se “nuk është e zakonshme që zëri i popullit të dëshirojë diçka që është kundër asaj që është e drejtë” (Mosia 29:26), ky sistem do të siguronte mbrojtje më të mëdha të të drejtave të individëve dhe drejtësisë së përbashkët të shoqërisë.

Në përgjigje të propozimit të Mosias njerëzit “po pritnin me padurim që çdo njeri të kishte të njëjtat të drejta në tërë vendin; po,

dhe çdo njeri shprehu gatishmëri të përgjigjei për mëkatet e tij” (Mosia 29:38).

Libri i Almës përmban historinë e popullit gjatë periudhës 40-vjeçare pasi u përvetësua nga njerëzit sistemi i propozuar. Kapitujt e fundit të analit të Almës, kapitujt 43 deri në 62, tregojnë për një periudhë me sfida dhe prova të mëdha. Gjatë kësaj periudhe të shkurtër 19-vjeçare, populli hasi sfida të brendshme politike, kërcënime të jashtme dhe pothuajse një konflikt të armatosur e të pandërprerë.

Sistemi qeverisës u kërcënua dy herë së brendshmi nga njerëz që kërkonin të vendoseshin mbretër vetë dhe t’u privonin njerëzve të drejtën për t’i zgjedhur udhëheqësit e tyre dhe për të adhuruar lirisht. Në të njëjtën kohë, njerëzve iu desh ta mbronin veten prej sulmeve të jashtme të shumëfishta nga lamanitët që qenë të vendosur për ta shkatërruar qeverinë nefite dhe t’i nënshtronin nefitët në robëri.



Gjatë të gjitha sfida të tyre, ne fitët e drejtë mundën të merrnin forcë nga fakti se ata po vepronin me arsyet e duhura. Qëllimi i tyre i vetëm ishte “që të mbronin veten dhe familjet e tyre dhe tokat e tyre, atdheun e tyre dhe të drejtat e tyre dhe fenë e tyre”.

Përçarja ekonomike e këtyre sfidave të shumëfishta, edhe pse nuk përmenden veçanërisht, që me gjasë një sfidë e madhe për popullin. Mormoni, në përpilimin e analit të shenjtë, ndieu nxitjen për të siguruar një rrëfim të hollësishëm të kësaj periudhe. Në fakt, po të kishte siguruar hollësi të ngjashme për pjesën tjetër të historisë 1000-vjeçare të nefitëve, Libri i Mormonit do të përmbante më shumë se 2500 faqe!

Presidenti Ezra Taft Benson (1899–1994) dha mësim:

“Libri i Mormonit . . . u shkrua për kohën tonë. Nefitët nuk e patën kurrë librin; as lamanitët e kohëve të lashta. Ai u bë për ne. . . . Nën frymëzimin e Perëndisë, që i sheh të gjitha gjërat që nga fillimi, [Mormoni] përmbledhi anale shekujsh, duke zgjedhur historitë, fjalimet dhe ngjarjet që do të ishin më të dobishme për ne. . . .

Ne duhet ta pyesim veten vazhdimisht: ‘Përse e frymëzoi Zoti Mormonin (ose Moronin apo Almën) që ta përfshinte këtë në analin e tij? Çfarë mësimi mund të mësoj nga kjo që të më ndihmojë të jetoj në këtë kohë dhe periudhë?’”¹

Sot, shenjtoret e ditëve të mëvonshme anembanë botës e gjejnë veten duke u përballur me shumë prej të njëjtave sfida me të cilat u përballën nefitët gjatë kësaj periudhe të historisë së tyre, përfshirë përpjekjet për t’u privuar anëtarëve të drejtën për të adhuruar dhe për të folur haptas mbi probleme të rëndësishme të shoqërive në të cilat jetojnë. Disa shenjtore të ditëve të mëvonshme kanë ndër kërcënimin e sulmit të jashtëm dhe të konfliktit me forca të zotuarara për shkatërrimin e vendeve dhe lirive të tyre.

Fatmirësisht, nefitët qenë në gjendje t’i kapërcenin sfidat e tyre nëpërmjet përpjekjes, sakrificës dhe ndihmës më të madhe nga Zoti. Disa mësimë mbi mënyrën se si ata iu përgjigjën me sukses sfidave të tyre mund të na japin drejtim dhe guxim për t’u përballur me sfidat tona sot.

1. Kini dëshirat dhe arsyet e duhura.

Gjatë të gjitha sfidave të tyre, nefitët e drejtë mundën të merrnin forcë nga fakti se ata po vepronin me arsyet e duhura. Qëllimi i tyre i vetëm ishte “që të mbronin veten dhe familjet e tyre dhe tokat e tyre, atdheun e tyre dhe të drejtat e tyre dhe fenë e tyre” (Alma 43:47). Dëshira e tyre ishte që të ruanin lirinë e tyre të zgjedhjes – të drejtën për të vepruar në drejtësi dhe për t’u përgjigjur vetë për sjelljen e tyre – në vend që të kishin një mbret që t’u diktonte si

të silleshin. Arsyeja e tyre ishte që të ruanin barazinë para ligjit, veçanërisht lirinë e tyre për të adhuruar Perëndinë dhe për të ruajtur kishën e tyre (shih Alma 43:9, 45).

Në shoqëri ka dhe do të ketë gjithmonë forca që kërkojnë të manipulojnë opinionin publik për të marrë pushtet për përfitim vetjak. Ka një tundim për t’i përvetësuar arsyet e tyre dhe për ta kthyer konfliktin në një luftë për pushtet. Mënyra e Zotit është që të veprohet gjithnjë bazuar vetëm mbi dëshira dhe arsye të kulluara, ashtu siç bënë nefitët. Të vepruarit kështu i mundësoi ata që të merrnin fuqitë e qiellit për të kapërcyer sfidat e tyre “në fuqinë e Zotit” (Alma 46:20; shih edhe Alma 60:16; 61:18).

Në mënyrë të ngjashme, në reagimet tona ndaj sfidave me të cilat përballemi sot, ne duhet t’i kontrollojmë vazhdimisht zemrat tona për t’u siguruar se dëshirat dhe arsyet tona janë të kulluara dhe të bazuara mbi parimet e ungjillit të Jezu Krishtit. Nëse veprojmë (ose i manipulojmë të tjerët që të veprojnë) nisur nga egoizmi, për përfitim vetjak, ose për të poshtëruar të tjerët, ne nuk do të kemi ndihmën e nevojshme qiellore për t’u rezistuar sfidave tona.

2. Jini të sjellshëm dhe bujarë me njerëzit më pak fatlumë.

Kur armiqtë e tyre të mëparshëm, populli i anti-nefi-lehit, u kërcënuan me shkatërrim, nefitët ranë dakord që t’u jepnin atyre një vend për të jetuar dhe për të ndërtuar një jetë të re dhe u siguruan mbrojtje atyre (shih Alma 27:21–22; 43:11–12). Për shkak se anti-nefi-lehitët kishin bërë një betim që të mos i përdornin kurrë më armët e luftës, në vend të kësaj ata siguruan “një pjesë të madhe të pasurisë së tyre për të mbajtur” (Alma 43:13) ushtritë nefite gjatë kësaj kohe vendimtare. Megjithatë, nuk ka dokumente që nefitët i trajtuan këta imigrantë me ndonjë mënyrë tjetër përveçse me respekt dhe dashuri, edhe pse ata duhet të kenë qenë një shënjestër e lehtë politike për ata që dëshironin të nxitnin mosmarrëveshje.

Trajtimi i mirë që nefitët i bënë popullit të Amonit, ndërsa erdhën për t’u thirrur, iu kthye në mënyrë reciproke dhe përfundimisht kontribuoi në krijimin e njëres prej brigadave më frymëzuese ushtarake në historinë e dokumentuar – 2000 luftëtarët e rinj. Në mënyrë ironike, shërbimi i këtyre të rinjve mund të ketë qenë çelësi për ta mbrojtur shoqërinë nefite nga një shkatërrim i hershëm.



Një gatishmëri për të qenë të mirë dhe bujarë me nevojtarin që një faktor i rëndësishëm në mbrojtjen e kombit nefit dhe u dha nefitëve të drejtën për bekimet e qiellit gjatë kohës së vështirësive të mëdha. Trajtimi i mirë që nefitët i bënë popullit të Amomit, iu kthye në mënyrë reciproke dhe përfundimisht kontribuoi në krijimin e 2000 luftëtarëve të rinj.

Në kohë mosmarrëveshjes të brendshme, sulmi të jashtëm dhe sfidash ekonomike, ka një prirje për t'u bërë keqdashës ndaj atyre që “nuk janë si ne”. Ndodh lehtë të bëhesh kritikues ndaj tyre dhe të japësh gjykime. Dikush mund të vërë në dyshim besnikërinë e tyre ndaj shoqërisë dhe vlerën e tyre në të dhe ndikimin e tyre në mirëqenien tonë ekonomike. Këto përgjigje negative nuk përputhen me detyrën nga Shpëtimtari për t'i dashur të afërmit tanë si veten; dhe ato krijojnë ndasi, grindje dhe veçim. Po të mos ishte mirëpritur populli i Amonit në shoqërinë nefite, ndofta do të kishte krijuar mëri në vend të mirënjohjes në brezin që po rritej. Në vend që të krijonte 2000 luftëtarë besnikë, brezi i ri mund të ishte larguar dhe të ishte ribashkuar me lamanitët.

Një gatishmëri për të qenë të mirë dhe bujarë me nevojtarin që një faktor i rëndësishëm në mbrojtjen e kombit nefit dhe u dha nefitëve të drejtën për bekimet e qiellit gjatë kohës së vështirësive të mëdha. Njerëzit e Perëndisë kanë nevojë për të tilla bekime sot.

3. Dëgjojini dhe ndiqini udhëheqësit e frymëzuar.

Zoti i njihte sfidat me të cilat do të përballeshin nefitët dhe Ai nxori udhëheqës të frymëzuar që t'i ndihmonte ata t'i kapërcenin ato sfida. Kapiten Moroni që një luftëtar, por u frymëzua që të përgatiste parzmore, mburoja krahësh, përkrenare dhe veshje të trasha për të mbrojtur popullin e tij (shih Alma 43:19). Si rezultat, nefitët ia dolën shumë më mirë në betejë sesa lamanitët (shih Alma 43:37–38). Më vonë, Moroni i drejtoi njerëzit që të gërmonin dhe të ngrinin bregore dheu përreth qyteteve të tyre dhe të vinin në majë të atyre bregoreve prej dheu lëndë druri dhe ndërtim piketash (shih Alma 50:1–3). Këto përgatitje të frymëzuara ndihmuan në mbrojtjen e nefitëve nga shkatërrimi.

Ndërsa Moroni po përgatitej për luftë, Helamani dhe vëllezërit e tij po predikonin fjalën e Perëndisë dhe po e nxisnin popullin drejt drejtësisë në mënyrë që Shpirti i Zotit të mund t'i udhëzonte dhe t'i mbronte ata. Nefitët u shpëtuan sepse dëgjuan drejtimin tokësor dhe shpirtëror të udhëheqësve të frymëzuar. Vetëm kur ngriheshin mosmarrëveshje të brendshme dhe populli nuk pranonte t'i mbante vesh paralajmërimet e frymëzuara, vinin si rezultat pengesa dhe vuajtje.

Ne jemi të bekuar që jetojmë në një ditë kur Zoti ka thirrur profetë, shikues dhe zbulues të gjallë për të na paralajmëruar dhe udhëzuar që të përgatitemi për sfidat e të sotmes. Në vitin 1998, Presidenti Gordon B. Hinkli (1910–2008) u dha udhëzim e paralajmërim të frymëzuar anëtarëve të Kishës:

“Ka ardhur koha që të vëmë rregull në shtëpitë tona.

Kaq shumë prej njerëzve tanë po jetojnë në kufirin e fundit të të ardhurave të tyre. Në fakt disa po jetojnë me hua. . . .

Ekonomia është një gjë e brishtë. . . . Ka një paralajmërim për mot të stuhishëm në të ardhmen të cilit do ishte mirë t'ia vinim veshin.”²

Së fundi, fola me një burrë që i dëgjoi fjalët e Presidentit Hinkli dhe nxitjet e Shpirtit. Ai dhe gruaja e tij vendosën që t'i shlyenin investimet e tyre, të paguanin për shtëpinë dhe të dilnin nga borxhi.

Sot ai burrë mbështetet te vetja. Rënia ekonomike që pasoi, pati ndikim minimal në familjen e tij. Në fakt, mbështetja e tij te vetja bëri të mundur për të dhe gruan e tij që të shërbenin në një mision.

Presidenti Tomas S. Monson është thirrur për kohën tonë. Jeta dhe mësimet e tij janë mesazhi që Perëndia ka dërguar për të na mbrojtur e për të na bekuar ne sot. Në një kohë kur shumë shqetësohen për atë që nuk kanë, Presidenti Monson na mëson të jemi mirënjohës për bekimet e shumta që Zoti na ka dhënë. Dhe në një kohë kur shumë njerëz përqendrohen te problemet e tyre vetjake, Presidenti Monson na nxit që të shtrijmë dorën e të shpëtojmë, duke harruar vetveten në bekimin e të tjerëve. Mbajtja vesh e drejtimit të Presidentit Monson do t'u sigurojë familjeve tona mbrojtjen shpirtërore dhe bekimet që nevojiten në kohën tonë.

Unë jam mirënjohës që jetoj në një kohë kur ungjilli është rivendosur. Jam mirënjohës që Zoti e përgatiti Librin e Mormonit për kohën tonë. Nefitët i duruan besnikërisht sprovat e kohës së tyre dhe janë dëshmitarë se Zoti do të sigurojë bekimet dhe mbrojtjen që na duhen për të përballuar me sukses sfidat e kohës sonë. ■

SHËNIME

1. Ezra Taft Benson, “The Book of Mormon—Keystone of Our Religion”, *Ensign*, nëntor 1986, f. 6.
2. Gordon B. Hinckley, “To the Boys and to the Men”, *Ensign*, nëntor 1998, f. 53.



Nefitët u shpëtuan sepse dëgjuan drejtimin tokësor dhe shpirtëror të udhëheqësve të frymëzuar si Moroni. Vetëm kur ngriheshin mosmarrëveshje të brendshme dhe populli nuk pranonte t'i mbante vesh paralajmërimet e frymëzuara, vinin si rezultat pengesa dhe vuajtje.



SI TË

MBIJETOSH

NË TERRITOR
ARMIK



**Nga Presidenti
Bojd K. Paker,**

President i Kuorumit të
Dymbëdhjetë Apostujve

Ne festojmë 100-vjetorin e seminarit në Kishë. Unë kapem pas fillit të kujtimeve që kthehet te ditët e hershme kur burimet mbështetëse për këtë program ishin shumë të pakta.

Që nga ato fillime të përlulura, ne tani kemi 375.008 studentë në klasat e seminarit në 143 vende, me mbi 38.000 mësues vullnetarë dhe me kohë të plotë në mbarë botën. Ne japim shumë për rininë tonë. Ne e dimë vlerën dhe potencialin tuaj.

Dituria do t'ju Ndihmojë të Luftoni Armikun

Unë flas si një njeri që e ka parë të shkuarën dhe do t'ju përgatisë për të ardhmen.

Ju po rriteni në territor armik. Kur të piqeni shpirtërisht, ju do të kuptoni se si kundërshtari ka depërtuar pa u ndier në botën rreth jush. Ai është nëpër shtëpi, në argëtim, te mjetet e komunikimit, në gjuhë – te gjithëcka rreth jush. Në shumicën e rasteve, prania e tij është e pazbuluar.

Unë dëshiroj t'ju tregoj atë që do të jetë më

e çmueshmja dhe më e dëshirueshmja. Shkrimet e shenjta thonë: “Dituria është gjëja më e rëndësishme; prandaj fito diturinë” dhe, unë do të shtoja, “[me gjithë diturinë që ke fituar, vihu në lëvizje!]” (Fjalët e Urta 4:7) Nuk kam kohë për të harxhuar, dhe as ju. Kështu që dëgjoni me vëmendje!

Çasti kur vendosa të isha mësues është shumë i kthjellët në mendjen time. Gjatë Luftës II Botërore, unë isha te fillimet e të 20-ave të mia dhe isha pilot në Forcën Ajrore. Qeshë vendosur në ishullin e vogël të Je-Shimës. Ky ishull i vogël, i vetmuar, i madh afërsisht sa një pullë poste, është pak larg cepit verior të Okinauas.

Një mbrëmje të vetmuar vere, u ula mbi një shkëmb që të shihja diellin tek perëndonte. Po meditoja për atë që do të bëja me jetën time pas luftës, nëse do të isha aq me fat sa të mbijetoja. Çfarë dëshiroja të bëhesha? Qe gjatë asaj nate që vendosa se dëshiroja të bëhesha mësues. Arsyetova se mësuesit gjithmonë mësojnë. Të mësosh është qëllimi bazë i jetës.

Për herë të parë, dhashë mësim në seminar në vitin 1949, në Brigam-Siti. Kisha qenë student në atë klasë seminari në kohën kur qeshë në shkollë të mesme.

Në fillim, në seminar jepeshin mësim tri kurse: Dhiata e Vjetër, Dhiata e Re dhe Historia e Kishës. Qe privilegji im të shtoja një klasë të seminarit herët-në-mëngjes mbi Librin e Mormonit. Unë qeshë kthyer nga lufta me një dëshmi për Librin e Mormonit dhe një kuptim të mënyrës se si vepron dhurata e Frymës së Shenjtë.

Dhurata e Frymës së Shenjtë do t’ju Mbrojë në Territor Armik

Ju është dhënë mësim gjatë gjithë jetës suaj rreth dhuratës së Frymës së Shenjtë, por deri këtu mund të shkojë mësimdhënia. Ju mundeni dhe, në të vërtetë, ju duhet ta vazhdoni të vetëm pjesën tjetër të shtegut, që të zbuloni brenda vetes se si Fryma e Shenjtë mund të jetë një ndikim drejtues dhe mbrojtës.

Procesi është i njëjtë për të rinjtë dhe të rejtat. Të zbulosh mënyrën se si vepron Fryma e Shenjtë përbën punën kërkimore të tërë jetës. Kur të keni arritur ta zbuloni atë vetë, ju do të mund të jetoni në territor armik dhe nuk do të mashtroheni apo shkatërroheni. Asnjë anëtar i kësaj Kishë – dhe kjo do të thotë asnjëri prej jush – nuk do të bëjë një gabim të rëndë pa u paralajmëruar më parë nga nxitjet e Frymës së Shenjtë.

Ndonjëherë kur keni bërë një gabim, mund të keni thënë më pas: “E dija që nuk duhej ta kisha bërë atë. E ndieja që nuk ishte e drejtë”, ose ndoshta: “E dija që *duhej* ta kisha bërë atë gjë. Thjesht nuk pata guximin të veproja!” Ato mbresa janë përpjekjet që bën Fryma e Shenjtë për t’ju drejtuar drejt së mirës ose për t’ju paralajmëruar që të largoheni nga e keqja.

Ka disa gjëra që nuk duhet t’i bëni që linjat e komunikimit të mbeten të hapura. Ju nuk mund të gënjeni ose të mashtroni apo të vidhni ose të veproni në mënyrë të pamoralshme dhe të prisni që këto rrugë do të mbesin të lira prej përçarjes. Mos shkoni në vende ku mjedisi pengon komunikimin shpirtëror.

Ju duhet të mësoni të synoni fuqinë dhe udhëzimin që është gati për ju dhe pastaj ta ndiqni atë shteg me çdo kusht.

Në listën tuaj të gjërave “për t’u bërë”, vendosni të parën fjalën *lutje*. Shumicën e kohës, lutjet tuaja do të jenë të heshtura. Ju mund ta bëni një lutje në mendje.

Ju mund të keni gjithmonë një linjë të drejtpërdrejtë komunikimi me Atin tuaj në Qiell. Mos e lejoni kundërshtarin t’ju bindë se në anën tjetër të asaj linje nuk po ju dëgjon askush. Lutjet tuaja gjithmonë dëgjohen. Nuk jeni kurrë vetëm!

Kujdesuni për trupin tuaj. Jini të pastër. “A nuk e dini ju se jeni tempulli i Perëndisë dhe se Fryma e Perëndisë banon në ju?” (1 Korintasve 3:16).

Lexoni me kujdes premtimet që gjenden te seksioni 89 i Doktrinës e Besëlidhjeve. Fjala e Urtësisë nuk premtion shëndet të përsosur, por që receptorët shpirtërorë përbrenda jush mund të forcohen.

Qëndroni larg tatuazheve dhe gjërave të ngjashme që e dëmtojnë trupin tuaj. Trupi juaj u krijua sipas shëmbëlltyrës së Perëndisë.

Këshilla Profetike Jep Mësim Atë që Është e Vërtetë

Tani dua të flas për një çështje tjetër sipas modelit të të folurit hapur.

Ne e dimë që gjinia u vendos në botën paratokësore.¹ “Dhe fryma e trupi janë shpirti i njeriut” (DeB 88:15). Kjo çështje e gjinisë është shqetësim i madh për Vëllezërit, siç janë të gjitha çështjet e vdekshmërisë.

Disa prej jush mund të jenë ndier ose mund t’ju jetë thënë se keni lindur me ndjenja shqetësuese dhe se nuk jeni fajtor nëse veproni sipas atyre tundimeve. Nga ana

doktrinore, ne e dimë se nëse ajo do të ishte e vërtetë, zgjedhja juaj e lirë do të ishte hequr; dhe kjo nuk mund të ndodhë. Ju gjithmonë e keni zgjedhjen që të ndiqni nxitjet e Frymës së Shenjtë dhe të jetoni një jetë të pastër moralisht dhe të dëlirë, një jetë të mbushur me virtyt.

Presidenti Gordon B. Hinkli shpalli, në një konferencë të përgjithshme, këtë në vijim: “Njerëzit pyesin për qëndrimin tonë rreth atyre që e quajnë veten . . . homoseksualë dhe lesbike. Përgjigjia ime është se ne i duam ata si bij dhe bija të Perëndisë. Ata mund të kenë disa dëshira që janë të fuqishme dhe që mund të jenë të vështira për t’u frenuar. Shumica e njerëzve kanë [tundime] të një lloji apo të një tjetri në periudha të ndryshme. Nëse nuk veprojnë sipas këtyre prirjeve, atëherë ata mund të shkojnë përpara siç bëjnë të gjithë anëtarët e tjerë të Kishës. Nëse shkelin ligjin e dëlirësisë dhe standardet morale të Kishës, atëherë ata i nënshtrohen disiplinës së Kishës, ashtu si dhe të tjerët.

Ne duam të ndihmojmë . . . t’i forcojmë ata, t’iu japim ndihmë për problemet e tyre dhe t’i ndihmojmë me vështirësitë e tyre. Por ne nuk mund të rrimë duarkryq nëse ata shkojnë pas veprimtarisë së pamoralshme, nëse përpiqen të mbështesin e të mbrojnë dhe të jetojnë në një situatë të ashtuquajtur martesë brenda të njëjtës gjini. Të lejoje diçka të tillë do të ishte të zvogëloje pikërisht themelin e rëndësishëm dhe të shenjtë të martesës së miratuar nga Perëndia dhe pikërisht qëllimin e saj: ndërtimin e familjeve.”²

Presidenti Hinkli foli për Kishën.

Përdoreni Lirinë Tuaj të Zgjedhjes për të Mbajtur ose për të Rifituar Tokë të Sigurt

Dhurata e parë që morën Adami dhe Eva qe liria e zgjedhjes: “Ti mund të zgjedhësh vetë, sepse të është dhënë ty” (Moisiu 3:17).

Ju keni po atë liri zgjedhjeje. Përdoreni atë me urtësi, për të mohuar të vepruarin sipas ndonjë shtyqe të papastër ose tundimi mëkatar që mund të vijë në mendjen tuaj. Thjesht mos filloni të veproni; dhe nëse keni filluar të veproni tashmë, dilni e kthehuni. “I mohoni vetes çdo ligësi” (Moroni 10:32).

Mos luani me fuqitë jetë-krijuese në trupin tuaj as vetëm, as me anëtarë të të dyja gjinive. Ky është standardi i Kishës dhe nuk do të ndryshojë. Ndërsa piqeni, ka një tundim që të provoni ose të zbuloni veprimtari të pamoralshme. Mos e bëni atë!

Fjala kyçe është *disiplina* – vetëdisiplinimi. Fjala *disiplinë* vjen nga fjala *dishepull* ose *pasues*. Ji dishepull-pasues i Shpëtimtarit dhe do të jesh i sigurt.

Një apo dy veta prej jush mund të jenë duke menduar: “Unë jam tashmë fajtor për këtë apo atë gabim të rëndë. Është tepër vonë për mua”. Kurrë nuk është tepër vonë.

Ju është mësuar në shtëpi dhe në seminar rreth Shlyerjes së Jezu Krishtit. Shlyerja është si një fshirëse. Ajo mund të fshijë fajin dhe ndikimin e çfarëdo gjëje që ju bën të ndiheni fajtor.

Faji është dhimbje shpirtërore. Mos vuani nga dhembja kronike. Hiqeni qafe atë. Jepini fund asaj. Pendohuni dhe nëse është e nevojshme pendohuni përsëri dhe përsëri, dhe përsëri, dhe përsëri derisa ju – jo armiku – ta keni në dorë veten.

Paqja e Qëndrueshme Vjen nga të Penduarit Shpesh

Jeta rezulton se është varg provash dhe gabimesh. Shtoni “pendohuni shpesh”, tek lista juaj e gjërave për t’u bërë. Kjo do t’ju sjellë paqe që zgjat dhe nuk mund të blihet kundrejt asnjë çmimi tokësor. Të kuptuarit e Shlyerjes mund të jetë e vërteta e vetme më e rëndësishme që mund të mësoni në rininë tuaj.

Nëse po shoqëroheni me të tjerë që ju dobësojnë standardet në vend që t’ju forcojnë, ndaloni dhe ndryshoni shoqëri. Ju mund të jeni vetëm dhe të ndiheni i vetmuar nganjëherë. Atëherë mund të bëhet pyetja e rëndësishme: “Kur je vetëm, a je në shoqëri të mirë?”

Mund të jetë i vështirë çlirimi nga një zakon që e keni lejuar t’ju lidhë. Por e keni fuqinë brenda jush. Mos u dëshpëroni. Profeti Jozef Smith dha mësim se “të gjitha qëniet që kanë trupa kanë fuqi mbi ato që nuk kanë”³. Ju mund t’i bëni ballë tundimit!

Nuk ka të ngjarë që do të keni ndonjëherë ndeshje personale me kundërshtarin; ai nuk e shfaq veten ashtu. Por edhe nëse ai do të vinte personalisht tek ju që t’ju provonte e t’ju tundonte, ju keni një epërsi. Ju mund të mbronin lirinë tuaj të zgjedhjes dhe atij do t’i duhet t’ju lerë të qetë.

Përfitoni nga Bekimet e Seminarit

Ju nuk jeni të zakonshëm. Ju jeni shumë të veçantë. Ju jeni të jashtëzakonshëm. Nga e di unë këtë? E di pasi ju lindët në një kohë dhe në një vend ku ungjilli i Jezu

Krishtit mundi të vijë në jetën tuaj përmes mësimdhënies dhe veprimtarive të shtëpisë suaj dhe të Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme. Ajo është, si ka thënë Vetë Zoti: “[E vetmja] kishë [e] vërtetë dhe [e] gjallë mbi faqen e tërë dheut” (DeB 1:30).

Ka gjëra të tjera që mund t’ia shtojmë listës, por ju e dini atë që duhet të bëni dhe që duhet të mos bëni në jetën tuaj. Ju e dalloni të drejtën dhe të gabuarën dhe nuk keni nevojë të urdhëroheni për gjithçka.

Mos i çoni dëm këto vite të udhëzimit në seminar. Përfitoni nga bekimi i madh që keni, për të mësuar doktrinat e Kishës dhe mësimet e profetëve. Mësoni atë që është më me vlerë. Kjo do t’ju bekojë ju dhe pasardhësit tuaj për shumë breza në vijim.

Nuk do të kalojnë shumë vite, kur ju do të jeni të martuar e do të keni fëmijë, martesë duhet të vulolet në tempull. Lutja jonë është që, në kohën e duhur, ju do ta shikoni veten të rregulluar mirë në një lagje apo degë familjesh.

Shkoni Përpara me Shpresë dhe Besim

Mos kini frikë nga e ardhmja. Shkoni përpara me besim dhe lutje. Kujtojeni atë dhuratë hyjnore të Frymës së Shenjtë. Mësoni të merrni mësim prej saj. Mësoni ta ndiqni. Mësoni të jetoni përmes saj. Mësoni që të luteni gjithmonë në emrin e Jezu Krishtit (shih 3 Nefi 18:19–20). Shpirti i Zotit do t’ju shoqërojë dhe ju do të bekoheni.

Ne kemi besim të thellë dhe të madh në ju.

Dhe unë ju jap dëshminë time – një dëshmi që më erdhi në rininë time. Dhe ju nuk jeni aspak më të ndryshëm nga të tjerët, si edhe unë. Ju keni po aq të drejtë për atë dëshmi e dëshmim sa kushdo tjetër. Ajo do t’ju vijë nëse do ta meritoni. Unë ftoj bekimet e Zotit mbi ju – bekimet e asaj dëshmie të jenë në jetën tuaj, për t’ju udhëhequr ndërsa krijoni një të ardhme të lumtur. ■

Nga një fjalim në transmetimin për njëqindvjetorin e seminarit të mbajtur më 22 janar 2012.

SHËNIME

1. Shihni “Familja: Një Proklamata drejtuar Botës”, *Liahona*, nëntor 2010, f. 129; shih edhe Moisiu 3:5; Abraham 3:22–23.
2. Gordon B. Hinckley, “What Are People Asking about Us?” *Ensign*, nëntor 1998, f. 71.
3. *Teachings of Presidents of the Church: Joseph Smith* (2007), f. 355.



Shihni Fjalimin e Plotë

Shikojeni ose dëgjojeni të gjithë fjalimin e Presidentit Paker në seminary.lds.org/history/centennial.



Mos i çoni dëm këto vite të udhëzimit në seminar. Përfitoni nga bekimi i madh që keni për të mësuar doktrinat e Kishës dhe mësimet e profetëve. Mësoni atë që është më me vlerë.



U LUTA PËR GUXIM

Prindërit e mi janë anëtarë të Kishës, por nuk janë shumë aktivë. Kjo ndonjëherë çon në konflikte sepse ata besojnë se koha për familjen duhet të jetë përpara çdo gjëje tjetër – përpara të shkuarit në kishë, lartësimit të thirrjeve të mia në Kishë dhe bërjes së aktiviteteve të tjera.

Duke qenë se jam udhëheqëse në Filllore dhe anëtare e korit të lagjes, mbledhjet e mia të Kishës ndonjëherë bien ndesh me detyrat familjare. Një ditë, kur po përgatitesha për të ndjekur transmetimin e konferencës së përgjithshme në shtëpinë tonë të mbledhjes në Antananarivo, prindërit më kujtuan se kishim mysafirë në shtëpi.

“Duhet të zgjedhësh midis familjes dhe Kishës”, më tha nëna. “Ose do të rrish këtu me ne dhe do të humbasësh konferencën, ose do të shkosh në konferencë dhe të përballesh me ndëshkimin.”

Vendosa të mos nisja një grindje me nënën time. Në vend të kësaj, gjeta një çast për t’i kërkuar Atit Qiellor që të më jepte guxim dhe forcë. I kërkoja Atij edhe që të më ndihmonte të dija se çfarë të bëja.

Duhej të rrija në shtëpi me familjen apo të shkoja në kishë dhe të dëgjoja zërin e profetit?

Sapo mbarova lutjen, unë munda të ndieja Frymën e Shenjtë. Mund ta ndieja Shpirtin duke më nxitur që t’i tregoja nënës sime se sa e rëndësishme qe për mua të shkoja e të dëgjoja profetin. Ndieva se duhej t’i thosha asaj se do të merrja këshillë të urtë jo vetëm për jetën time sot, por edhe për të ardhmen time.

Perëndia mund të bëjë mrekulli dhe Ai ua zbuti zemrën prindërve të

Sapo mbarova lutjen, unë munda të ndieja Frymën e Shenjtë duke më nxitur që t’i tregoja nënës sime se sa e rëndësishme qe për mua të shkoja e të dëgjoja profetin.

mi, kështu që ata më lanë të shkoja në konferencën e përgjithshme pa marrë ndëshkim. Kjo qe një përvojë e mrekullueshme në jetën time. Ajo më pohoi vërtetësinë e shkrimit ku thuhet: “Nëpërmjet fuqisë së Frymës së Shenjtë, [ne] mund të [dimë] të vërtetën e të gjitha gjërave” (Moroni 10:5).

E di se, nëse i bazojmë veprimet tona mbi parimet e ungjillit dhe e dëgjojmë Shpirtin, ne mund të jemi përherë të lumtur me zgjedhjet tona. Kjo përvojë e forcoi dëshminë time se Perëndia është pranë nesh dhe se Fryma e Shenjtë na ndihmon në jetën tonë. ■

Fai Tianarivelo, Madagaskar



ATY KU E KAM VENDIN

Përpara se të bashkohesha me Kishën, jeta ime qe plot trishtim. Pas divorcit të prindërve të mi kur isha shtatë vjeçe, babai im u fut në burg. Nëna ime ishte e alkoolizuar dhe humbi gjithçka që qe e rëndësishme për të. Mua më dërguan të jetoja me një familje birësuese.

Për shkak të këtyre gjërave, unë u rrita shumë më shpejt se shumë prej moshatarëve të mi. Unë pothuaj nuk kam ndier kurrë se mund të gjeja vendin tim dhe për pasojë isha vazhdimisht në një gjendje rebelimi. Kur isha ende shumë e re, fillova të pija duhan dhe të bëja gjëra të tjera që tani e kuptoj se janë në kundërshtim me Fjalën e Urtësisë. Isha e sigurt se isha paracaktuar që të dështoja në jetë.

Gjëja e vetme në të cilën gjeja lumturi, ishte të ndihmuarit e njerëzve – qoftë nëse e bëja duke pastruar në afërsi të tyre ose duke dëgjuar historitë e jetës së tyre. Unë dëshiroja dëshpërimisht që njerëzit ta dinin se mund të mbështeteshin tek unë. Një vit shkova me pushime dhe takova një grua të moshuar së cilës vendosa t'i shërbeja duke e dëgjuar. Ajo ishte e krishterë dhe nisi të më fliste rreth fesë.

Në të vërtetë, unë nuk kisha besuar kurrë te Perëndia. Ndonjëherë, kur pata menduar se Ai *ndoshta* ekzistonte, e fajësoja për gjërat shqetësuese që kisha përjetuar. Por ndërsa kjo grua përshkruante rëndësinë e besimit në Perëndi, zbulova se më ngjalli kureshtjen. Përpara se të largohesha, ajo më tha diçka që qe veçanërisht interesante: “Mormonët i zbatojnë urdhërimet e Perëndisë”.

Nuk kisha dëgjuar kurrë për

mormonët, kështu që shkova në shtëpi, hyra në internet dhe bëra kërkime. Mbërrita tek adresa Mormon.org dhe porosita një kopje falas të Librit të Mormonit. Misionarët ma sollën pak ditë më vonë.

Nuk isha e sigurt nëse mund të filloja të besoja në Perëndi, por misionarët më ndihmuan të zbuloj se jo vetëm që mund të besoja në Të, por edhe ta njihja. Ndërsa fillova të lutesha e të studioja Librin e Mormonit, e gjeta veten në një udhëtim të bukur drejt gjetjes së lumturisë. Lashë duhanin. Pushova së fajësuar Perëndinë dhe nisa ta falënderoj Atë për gjërat e mira në jetën time. Arrita të dija se Biri i Tij kishte vuajtur për mëkatet e mia dhe për të gjithë dhembjen që kisha ndier sa herë. Më 28 tetor 2007, unë u pagëzova në Kishën e Tij.

Nëse nuk do ta kisha përjetuar vetë

ndryshimin nga zhgënjimi në lumturi, nuk do të besoja se është i mundur. Sot më pëlqen shumë thirrja ime në Fillore dhe jam mirënjohëse që kam pasur mundësinë për të ndihmuar në organizimin e një projekti shërbimi në një konferencë për të rinjtë në moshë madhore beqarë në Poloni. Të qenit në gjendje t'i ndihmoj rregullisht të tjerët nëpërmjet shërbimit në Kishë e ka shtuar lumturinë që kam gjetur në ungjillin e Jezui Krishtit. Gjithçka që bëj tani, e bëj me dashuri të pastër për shkak të Jezui Krishtit. Unë besoj se jeta është e bukur dhe se edhe kur kemi sfida, nëse e ndjekim Shpëtimtarin, ne nuk do të humbasim.

Gruaja që takova kishte të drejtë: të pasurit besim në Perëndi *është* vendimtare. Ne nuk mund ta gjejmë vendin tonë në këtë botë nëse nuk e njohim Atë. Jam mirënjohëse që më në fund e di se e kam një vend të cilit e di se i përkas. ■

Dorota Muział, Poloni

Ajo më tha diçka që qe veçanërisht interesante: “Mormonët i zbatojnë urdhërimet e Perëndisë”.



NA TREGO RRETH KISHËS SATE

Në një udhëtim për të vizituar vëllanë tim, isha ulur nga fundi i avionit ku ulen punonjësit e shërbimit të fluturimeve. Dy rreshtat e ndenjësive në atë zonë shohin nga njëra-tjetra.

U prezantova me njerëzit që qenë ulur rreth meje, dhe pastaj përmenda se do të frekuentoja Universitetin “Brigam Jang”. Një burrë që qe ulur përballë meje, tha se e bija kishte një shoqe të ngushtë që sapo ishte nisur në një mision me kohë të plotë. Bija e tij dinte pak për Kishën, por ai nuk dinte pothuajse asgjë. Punonjësjë e shërbimit të fluturimit tha menjëherë se ajo nuk do të dëshironte t’i përkiste “asaj kishë” sepse ajo [kishë] u kundërvihet grave. Burri tha se ai kishte dëgjuar diçka të ngjashme – se gratë shenjtoze të ditëve të mëvonshme konsideroheshin më të ulëta se burrat, që ato nuk mund të mbanin priftërinë apo të kryesonin në mbledhje dhe se Kisha mbizotërohej nga meshkujt.

Pastaj duke u kthyer nga unë, më pyeti: “Si ndihen *ju* rreth kësaj?” Të shtatë njerëzit u kthyen nga unë dhe pritën.

Zemra filloi të më rrihte fort. Kur isha fëmijë i kisha mësuar përmendsh Nenet e Besimit pikërisht për një takim të tillë dhe kur isha adoleshente dhe e re kisha praktikuar dhënien e dëshmisë për vegimin e Jozef Smithit dhe për Librin e Mormonit. Por nuk kisha as idenë më të vogël se si t’i përgjigjesha pyetjes së burrit. U luta në heshtje që Ati Qiellor të më udhëzonte.

Pastaj thashë fjalët e para që më erdhën në mendje: “Ju thjesht nuk dini gjë për Shoqatën e Ndihmës”. Shprehja e fytyrave të tyre tregonte se nuk dinin gjë.

“Priftëria funksionon në ndërthurje me gratë, të cilat të gjitha janë anëtare të Shoqatës së Ndihmës”, u shpjegova. “Ne kemi një presidente grua të Shoqatës së Ndihmës që drejton aktivitetet e grave në Kishë në mbarë botën. Përgjegjësjë e grave është që të sjellin dhembshuri dhe dashuri hyjnore në jetën e anëtarëve dhe veçanërisht në jetën e familjeve të tyre.”

Njerëzit rreth meje dëgjuan me vëmendje.

“Ne jetojmë në një kohë të çuditshme kur disa gra dëshirojnë që gratë të veprojnë dhe të mendojnë e të jenë si burrat. Por ne besojmë se Perëndia i ndan detyrat. Ne presim që gratë të jenë udhëheqëse mes grave dhe bashkëudhëheqëse në shtëpitë e tyre. Burrat në këto sfera, mbështeten shumë te ne për këshillë. Është një ekuilibër i drejtë. I bën organizatat tona të Kishës dhe shtëpitë tona të suksesshme. Dhe ne vërtet besojmë se burri nuk është pa gruan, as gruaja nuk është pa burrin në Zotin (shih 1 Korintasve 11:11). Ne besojmë se nuk jemi të plotë pa njëri-tjetrin. Ne nuk besojmë se u krijuam për të konkurruar me njëri-tjetrin, por për ta plotësuar njëri-tjetrin.”

U ndieva e bekuar kur mbarova.

Thashë fjalët e para që më erdhën në mendje: “Ju thjesht nuk dini gjë për Shoqatën e Ndihmës”.



E dija se fjalët që kisha thënë, qenë nga Shpirti. Të gjithë dukeshin të kënaqur nga shpjegimi im. Më pas burri tha: “Na trego më shumë rreth kishës sate”.

Pastaj, për dy orët në vijim, unë pata mundësinë e gëzueshme që të flisja për Rivendosjen, t’u përgjigjesha pyetjeve dhe të jepja dëshmi për ungjillin që dua. ■

Shauna Mur, Virxhinia, SHBA

DUHET TË ZGJEDH PUNËN APO KISHËN?

Bashkëshortja ime dhe unë u martuam në vitin 1981 në Tempullin e Tokios në Japoni. Jeta jonë pas martesë nuk qe e lehtë në fillim. Isha mirënjohës që kisha një punë, por kishim probleme me mbulimin e shpenzimeve tona. Ne i kërkuam ndihmë Atit Qiellor dhe bëmë gjithçka që mundeshim, që të mbulonim nevojat dhe të paguanim të dhjetën. E dinim se po t’i mirëbesonim Zotit, Ai do të kujdesej për ne.

Një javë, si gruaja edhe miku im më sollën të njëjtën copë të vogël të prerë gazete. Ishte një njoftim për një mësuues anglishteje me kohë të plotë.

Ia dërgova kompanisë dokumentin e të dhënave të mia dhe m’u kërkua të shkoja për një

intervistë. Në fund të intervistës, intervistuesi tha: “Ju shkruani në dokumentin e të dhënave tuaja se jeni përfshirë në një punë vullnetare si misionar për Kishën e Jezui Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme. Kjo do të thotë që ju shkoni në kishë të dielave, apo jo? Nëse do t’ju duhej të zgjidhnit mes shkuarjes në kishë apo në punë të dielave, cilën do të zgjidhnit?”

Qe një pyetje e vështirë [për t’iu përgjigjur] sepse më duhej një punë më e mirë. Por pasi u mendova thellë, u përgjigja: “Unë do të shkoja në kishë”.

Me një buzëqeshje të vagullt, intervistuesi tha: “Oh, kuptoj”. Më pas ai më la të shkoja me premtimin se kompania do të merrte një vendim deri në mbrëmje dhe se unë duhej të telefonoja për të marrë vesh rezultatet. Ndërsa largohesha nga dhoma, mendova se kisha dështuar.

Më vonë atë mbrëmje, kur erdhi koha për të telefonuar, unë i rashë numrit të telefonit të kompanisë me frikë të madhe.

“Si janë rezultatet e intervistës?” pyeta sekretaren. “Dështova, apo jo?”

Mbeta i shtangur, por i lumtur nga përgjigja e saj.

“Do të na pëlqente t’ju kërkonim të punoni për ne”, tha ajo.

Rreth një muaj më vonë, mësova pse e fitova punën. Sekretarja më shpjegoi se intervistuesi jetonte në derën ngjitur me misionarë me kohë të plotë shenjtorë të ditëve të mëvonshme. Ai i kishte parë shpesh misionarët që i ngisnin me gjallëri biçikletat e tyre për në punë në mëngjes.

“Ai besoi se ju, duke qenë nga e njëjta kishë, do të punonit për ne po



Intervistuesi më pyeti: “Nëse do t’ju duhej të zgjidhnit mes shkuarjes në kishë apo në punë të dielave, cilën do të zgjidhnit?”

aq fort sa punonin misionarët për kishën e tyre”, tha ajo. “Lum si ju!”

Që nga ajo kohë, familja jonë ka pasur gjithmonë atë që na është nevojitur.

Kurdoherë që mendoj për këtë përvojë të veçantë, marr kurajë dhe ngushëllim. E di se Perëndia përdor shpesh njerëz të tjerë për të bekuar fëmijët e Tij. Unë nuk mund ta shpreh siç duhet sa mirënjohës ndihem për bashkëshorten time dhe mikun tim, për frymëzimin e tyre kur më sollën atë njoftim në gazetë, për ata misionarë që punonin fort, dhe shembullin e tyre të shkëlqyer dhe për Atin tonë Qiellor të mëshirshëm, të dashur e përkujdesës, që ka fuqi të mrekullueshme për t’i përkushtuar përvojat tona për të mirën tonë. ■

Keniu Ishi, Japoni

Dëlirësia

NË NJË BOTË TË PAPËRKORË

Personeli i revistave të Kishës u takua me një grup të rinjsh në moshë madhore nga vende të ndryshme të botës për të diskutuar mbi sfidat dhe bekimet e të qëndruarit të dëlirë në një botë që nuk e vlerëson – dhe madje e për-qesh – dëlirësinë. Diskutimi i tyre i hapur, i singertë dhe i përzemërt, na u duk lartësues e frymëzues dhe shpre-sojmë se edhe ju mund të zbuloni në fjalët e tyre diçka që t'ju ndihmojë ta vlerësoni shenjtërinë e martesës dhe intimitetit fizik.

Me kaç shumë njerëz që e justifi-kojnë sjelljen e pamoralshme, cilat të vërteta të ungjillit ju ndihmojnë të qëndroni seksualisht të pastër?

Martin Isaksen, Norvegji: Në shkrimet e shenjta thuhet se duhet të jesh i dëlirë. Kjo është një arsye më se e mjaftueshme për mua.

Lizi Xhenkins, Kaliforni, SHBA: Dëlirësia është një zotim. Ti e jeton atë. Është një mënyrë jetese.

Liza Uest, Angli: Të kuptuarit se cila jam, të kuptuarit se ka më shumë në jetë sesa e tanishmja dhe sesa një natë e vetme më ndihmon shumë. Plani i shpëtimit – megjithëse kur isha adoleshente nuk do të kisha mundur ta shpjegoja në mënyrë të hollësishme – është shumë i dobishëm. Koncepti i martesës së përjetshme është i mrekullueshëm! Kur njerëzit e kuptojnë këtë zotim, ata e kuptojnë se sa e jashtëzakonshme është që Perëndia na

ka vendosur në familje këtu në tokë dhe na ka dhënë urdhërime, kështu që jo vetëm do të jemi të sigurt, por që [edhe] do të jemi të lumtur. Ndërsa i jetoj këto parime dhe i ndaj ato me miqtë e mi, duke thënë “Nuk do të pi”, ose “Nuk do të shkoj në këtë festë”, ose “Nuk do ta bëj këtë”, ata më respektojnë. Në fakt, ata më dalin në krah në fund. Të kuptuarit se kam vlerë si fëmijë i Perëndisë dhe se Ati Qiellor e di se kush jam dhe vërtet kujdeset për mua është një forcë e madhe.

Ana (Ania) Vlashova, Rusi: Më ndihmon shumë kur mendoj rreth të qenit pjesë e një familjeje qiellore. Unë e dua dhe e respektoj Perëndinë dhe nuk dua që Ai të ndihet i turpëruar për zgjedhjet që bëj.

Kejli Uajtimor, Florida, SHBA: Pa dyshim, unë mendoj se të kuptuarit e shenjtërisë së familjeve më ka dhënë një vendosmëri të fortë për ta

jetuar ligjin e dëlirësisë. Një gjë tjetër është të kuptuarit se kur i shkelim urdhërimet, ka pasoja të këqija që unë nuk dëshiroj t'i përjetoj.

Falande (Fae) Tomas, Haiti: Unë kam menduar vërtet rreth asaj se si njerëzit thonë: “Përse të presësh kur mund të kesh gjithçka tani?” Por kam pyetur veten se sa do të zgjaste ajo lloj lumturie. Parapëlqej të jetoj ligjin e dëlirësisë dhe, si rezultat, të kem paqe.

Hipoliti (Hip) Koudio, Bregu i Fildishtë: Një nga gjërat që më ndihmon shumë, është proklamata për familjen: “Ne . . . deklarojmë se Perëndia ka urdhëruar që fuqitë e shenjta të krijimit të jetës duhet të përdoren vetëm midis burrit dhe gruas, ligjërisht të martuar si bashkëshort e bashkëshorte”¹.

Gjëja tjetër që më ndihmon, është mënyra se si Vëllezërit na e shpjegojnë dëlirësinë. Ata na paralajmërojnë për mënyrën se si fillon imoraliteti dhe na mësojnë se, kur abuzojmë me trupin, ne abuzojmë me shpirtin. Plaku Xhefri R. Holland dha mësim se Shpëtimtari pagoi një çmim për ne që një ditë të kemi një trup të ringjallur. Mënyra se si mund të jemi mirënjohës për çmimin që pagoi Ai, është t'i mbajmë trupat tanë të pastër.²

Shpëtimtari pagoi një çmim për ne që një ditë të kemi një trup të ringjallur. Mënyra se si mund të jemi mirënjohës për çmimin që pagoi Ai, është t'i mbajmë trupat tanë të pastër.

Liza: Më kujtohet një bisedë shumë e veçantë që bëra me dikë kur isha 15 vjeçe. Ne folëm rreth faktit që unë nuk besoj tek intimiteti përpara martesës dhe më kujtohet se ajo tha: “Po, por po sikur thjesht të ndodhë?” Po sikur një natë, ti thjesht . . . ?” Por unë e dija se kisha një zgjedhje. Asgjë nuk ndodh ashtu thjesht.

Është e mrekullueshme për mua që Ati Qiellor na ka dhënë lirinë e zgjedhjes dhe urdhërime për të na bërë të lirë dhe që Satani bën gjithçka që mundet, për të na lidhur ose kufizuar. Çastet për të cilat po fliste shoqja ime, kur diçka thjesht mund të ndodhte, ishin në festa ku njerëzit kanë pirë dhe janë ndarë në çifte. Kështu që unë nuk e vë veten në ato situata. Zgjedhja nuk duhet bërë në fund kur ti thua po ose jo. Zgjedhja bëhet që më parë, kur ti e pyet veten: “A të shkoj në festë?”

Shumë njerëz, nëse nuk i shqyrtojnë imtësisht gjërat që më përpara dhe nuk mendojnë për pasojat, do të bëjnë çfarëdo që të dëshirojnë në moment. Por nëse thua: “Unë dëshiroj këtë si rezultat përfundimtar; prandaj do të bëj këto zgjedhje”, atëherë do të shmangësh shumë telashe.

Ju përmendët lirinë e zgjedhjes dhe urdhërimet. Por a ju ndihmojnë besëlidhjet – besëlidhjet e pagëzimit apo besëlidhjet e tempullit – për t'i jetuar standardet tuaja?

Fae: Mendoj për jetën time para se të pagëzohesha dhe se sa kuptim më të madh ka jeta tani që kam bërë besëlidhje. Është mahnitëse se si mund të marrim falje për shkak të Shlyerjes. Kur kujtoj besëlidhjet e mia, mendoj

rreth mënyrës se si mund të pendo- hem, të përmirësohem dhe të vazhdoj të shkoj përpara.

Ania: Veçanërisht në tempull e kupton këndvështrimin e përjetshëm. Tempulli të ndihmon të mendosh për përjetësinë tënde dhe jo vetëm për të sotmen, kështu që bën zgjedhje më të mençura.

Lizi: Shumë shpesh ne besojmë se intimiteti është i keq, por nuk është. Ai thjesht duhet të miratohet nga autoriteti i duhur, në kohën e duhur dhe me personin e duhur. Kjo është përse kemi besëlidhje. Ti bën zotime. Ti thua: “Jam vërtet gati për këtë hap në jetën time”. Besëlidhjet më ndihmojnë sepse e di se po bëj gjëra në mënyrën që duhet. Dhe e di se, nëse bëj atë që dëshiron Ati Qiellor, do të jem më e lumtur.

Xhonatan Tomazini, Francë:

Nuk do të isha i sinqertë me veten dhe nuk do të isha i sinqertë me Perëndinë po t'i shkelja besëlidhjet e mia. Besëlidhjet martesore më ndihmojnë të kuptoj se dëshiroj të jem në gjendje t'i jap bashkëshortes sime dikë që ka vetëkontroll, që e ka përgatitur veten për të qenë një bashkëshort i mirë dhe që e ka mbajtur veten të pastër.

Ka shumë argumente në botë – shumë prej tyre duken bindëse dhe të ndërlukuara – rreth arsyes përse ligji i dëlirësisë është i dalë mode. Çfarë argumentesh keni dëgjuar dhe si u jeni përgjigjur atyre që i sfidojnë standardet tuaja?

Lizi: Në vitin tim të fundit në shkollë të mesme, më kujtohet një mësuese që na jepte disa “këshilla”. Ajo që martuar menjëherë pas shkollës së mesme dhe [martesa] kishte



STANDARDI DHE ÇELËSI

“Standardi mbetet i njëjtë: mospasje e

marrëdhënieve intime para martesës dhe besnikëri e plotë gjatë martesës. Pavarësisht se sa demode mund të dukemi, pavarësisht sa shumë u ulen vlerat standardeve, pavarësisht sa dorëzohen të tjerët, ne nuk do të dorëzohemi, ne nuk mund të dorëzohemi. . . .

Ju keni marrë dhuratën e Frymës së Shenjtë. Do të keni pëshpërimit miratimi ose paralajmërime kur do t’ju duhet të merrni vendime. Fryma e Shenjtë mund t’ju udhëheqë larg nga e liga dhe t’ju sjellë sërish [në udhën e drejtë] nëse jeni larguar dhe keni humbur rrugën. Mos harroni kurrë se ju jeni bij e bija të Perëndisë. Satani nuk mund t’ju burgosë përjetë. Ju gjithmonë e zotëroni çelësin e pendimit për të hapur derën e burgut.”

Presidenti Bojd K. Paker, President i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, “The Standard of Truth Has Been Erected”, *Liahona*, nëntor 2003, f. 26.

përfunduar keq, kështu që ajo pak a shumë na tha se “ka shumë peshq në det”. Ajo nënkuptoi se ka shumë gjëra për t’u provuar nga ne, shumë kandidatë për t’u provuar. Më kujtohet se u trondita që mësuesja ime mund ta thoshte atë. Që nga ajo kohë, kam menduar që, po, ka shumë njerëz, por unë nuk dëshiroj shumë njerëz!

Xhonatani: Dikush që njoh tha se kur ajo ka një lidhje, ajo dëshiron të shohë nëse përputhet seksualisht me atë njeri. Ajo më dha shembullin se kishte dalë në takime me një djalë që i pëlqente dhe pasi kishin kaluar në intimitet, ajo nuk ndieu se përputheshin dhe lidhja nuk funksionoi. Ajo e përdori atë përvojë për të vënë në dukje argumentin e saj dhe dukej mjaft bindës. Si përfundim, i shpjegova asaj se unë besoj se njerëzit mund të arrijnë ta njohin njëri-tjetrin shumë mirë në mënyra të tjera dhe nëse e bëjnë këtë dhe krijojnë mirëbesim ndërsa e jetojnë ligjin e dëlirësisë, do të ketë më shumë përputhje kur të martohen.

Ania: Argumenti më i zakonshëm që dëgjoj përherë është se, kur dy njerëz e dashurojnë njëri-tjetrin, s’ka asgjë të keqe, intimiteti është thjesht shprehje e dashurisë.

Martini: Diçka që më vjen në mendje kur dëgjoj justifikimin “Ne e duam njëri-tjetrin” është një citim nga Presidenti Spenser W. Kimball. Ai thotë se tepër shpesh epshi futet tinëz në derë kur njerëzit mendojnë se kanë rënë në dashuri.³ Kështu ndodh me shumë njerëz kur ata kalojnë në intimitet përpara martesës: është epysh megjithëse ata mendojnë se e duan njëri-tjetrin. Nëse ata vërtet do

ta donin njëri-tjetrin, ata do ta respektonin njëri-tjetrin më shumë, do ta mbështesnin njëri-tjetrin dhe do ta kuptonin se ka një kohë të caktuar për intimitetin. Dhe, për mua, intimiteti përpara martese tregon se ata nuk do ta mbështesnin njëri-tjetrin aq shumë sa mendojnë se do ta bëjnë. Sepse, nëse nuk janë në gjendje ta ndihmojnë njëri-tjetrin në të jetuarin e standardeve tani, atëherë si do ta mbështesnin njëri-tjetrin më vonë?

Kejli: Disa njerëz që nuk besojnë në Perëndi, ndiejnë se Bibla dhe ligji i dëlirësisë janë të dala mode. Kisha disa shokë në shkollë që qenë pak a shumë ateistë ose agnosticistë – dhe kisha një shoqe që nuk besonte me të vërtetë te mësimet e fesë së saj. Ajo jetonte thjesht sipas asaj që ajo dëshironte, asaj që ajo ndiente se ishte e drejtë për të. Intimiteti fizik, nga pikëpamja e saj, është vetë-përmbushës dhe çdo gjë që do ta kufizonte atë përmbushje, është e padëshirueshme.

Mendoj se shoqja ime u habit që unë besoja në Bibël dhe te urdhërimet e Perëndisë, por u përpoqa ta ndihmoja atë të kuptonte se unë nuk i shoh urdhërimet si kufizime; i jetoj ato sepse më bëjnë më të lumtur. Megjithëse nuk qemë dakord, ajo më respektoi dhe ne mbetëm mikesha të mira.

Liza: Të gjitha këto argumente gjejnë përgjigje në parimet themelore të ungjillit. Kur besoni se ka një Perëndi, kur besoni se ka një plan më të madh, kur besoni se ka përgjegjshmëri, kur besoni se është dikush që ju do dhe kujdeset për ju dhe kur besoni se keni vlerë të brendshme sepse jeni fëmijë i Perëndisë – atëherë

ka më shumë gjasa që ta konsideroni veten me vlerë dhe ta respektoni trupin tuaj. Kur njerëzit nuk i dinë apo nuk i besojnë këto parime, ata shohin nga njerëzit dhe vendet e tjera për të kuptuar se sa vlejné [vetë].

Çfarë ndikimesh apo shembujsh ju kanë ndihmuar të zotoheni që të jetoni ligjin e dëlirësisë?

Hipi: Unë kisha një shok dhome që qe i fejuar. Një ditë, po flisnim për martesën e tij të afërt dhe dikush pyeti: “Cilat janë zotimet që ju të dy mendoni se do t’ju ndihmojnë të qëndroni të fortë?” Përgjigja e tij qe: “Mosmbajtja e ligjit të dëlirësisë mund ta shkatërrojë lidhjen tonë. Kështu që ne vendosëm se nuk do të bënim asgjë për të cilën nuk do të ndiheshim rehat po ta bënim përpara peshkopit ose prindërve tanë.” Kjo ende ka një ndikim tek unë.

“Unë nuk i shoh urdhërimet si kufizime; i jetoj ato sepse më bëjnë më të lumtur.”

Xhonatani: Tani që jam i ri në moshë madhore, është më e lehtë t’i dëgjoj profetët dhe të meditoj për gjërat që thonë udhëheqësit e Kishës. Megjithatë, përpara kësaj, mendoj se shumë prej përgjegjësishë u mbetet prindërve dhe familjeve tona. Kisha mund të sigurojë informacion dhe shumë gjëra të mrekullueshme, por shembujt nga familja ime më ndihmuan vërtet që ta kuptoj se ungjilli është diçka e mirë dhe se më bën të lumtur.

Liza: Ndërsa po rritesha, anëtar i Kishës më i afërt me moshën time jetonte një orë e gjysmë larg, kështu që nuk kishte anëtarë të tjerë në shkollë. Por diçka të cilën e vlerësova vërtet ishte që, edhe pse isha vetëm unë, udhëheqësit e mi vinin gjithmonë në Aktivitetet e Përbashkëta; ata gjithmonë vinin në seminar; ata gjithmonë vinin të më jepnin mësim – çdo herë të vetme. Ata nuk thanë kurrë: “Mirë, ne kemi vetëm një student kështu që nuk do të bëjmë mësim sot”. Jam e sigurt se kam mësuar shumë, por ajo që kujtoj vërtet është që udhëheqësit e mi qenë të qëndrueshëm. Dhe për shkak të tyre, unë pata mundësi të ndieja Shpirtin.

Mendoj se kurrë nuk mund ta vlerësoj plotësisht dhuratën e Frymës së Shenjtë. Edhe pse kisha prindërit e mi, familjen time dhe udhëheqësit e mi, kur isha në shkollë, isha vetëm. Por Shpirti ishte me mua. Kështu që çdo gjë që e sjell Shpirtin në jetën e dikujt, do të jetë një ndikim i madh në të ndihmuarin e atij personi për të mbajtur ligjin e dëlirësisë.

Lizi: Një nga ndikimet e mia më të mëdha qe marrja e një dëshmie

për veten time. Nëse nuk rrënjosemi fort në ungjill, është shumë e lehtë që të marrim një shteg tjetër. Por nëse filloni duke u siguruar se keni një themel të fortë në ungjill, gjithçka tjetër do të vijë.

Hipi: Kur dëshiron të jesh i fortë fizikisht, stërvitesh dhe kur stërvitesh, merr rezultate. Nëse e zbatojmë këtë në një mënyrë shpirtërore, ne duhet të stërvitemi shpirtërisht. Ka shumë gjëra që duhet të bëjmë për një stërvitje shpirtërore, të tilla si leximi i shkri-meve të shenjta dhe bërja e gjithçkaje që mundemi për të pasur Shpirtin. Ne gjithashtu duhet të vendosim synime të drejta dhe të punojmë drejt atyre synimeve. Por që t’i arrijmë ato synime, ne nuk mund t’ia dalim vetëm. Na duhet të kemi Zotin me vete. Nga Ai ne marrim forcën dhe Shpirtin për t’i kapërcyer sfidat tona. Më pas ne mund të ndjekim lutjen e Presidentit Tomas S. Monson:

“Mos i lejoni pasionet t’ju shkatërrojnë ëndrrat. Bëjini ballë tundimit.

Kujtoni fjalët nga Libri i Mormonit: ‘Ligësia kurrë nuk ka qenë lumturi’”⁴. ■

SHËNIME

1. “Familja: Një Proklamata drejtuar Botës”, *Liahona*, nëntor 2010, f. 129.
2. Shih Jeffrey R. Holland, “Of Souls, Symbols, and Sacraments”, në *Devotional and Fireside Speeches të vitit 1987–1988 në Universitetin “Brigam Jang”* (1988), f. 77–79.
3. “Në kohën e mëkatit, dashuria e pastër del nga një derë ndërkohë që epsi hyn tinëz nga një derë tjetër. Ngrohtësia është zëvendësuar atëherë me dëshirën e mishit dhe pasionin e pakontrolluar. Është pranuar doktrina që djalli mezi pret ta themelojë, se marrëdhëniet e palejueshme seksuale janë të justifikueshme” (*Teachings of Spencer W. Kimball*, red. Edward L. Kimball [1982], f. 279).
4. Tomas S. Monson, “Be Thou an Example”, *Liahona*, maj 2005, f. 113; Konferenca e Përgjithshme, prill 2005, “Bëhu Shembull”, f. 135 (nr. artikulli 00074 101).

“Çfarë do të thotë të nderosh priftërinë e Perëndisë?”

Priftëria është fuqia nëpërmjet së cilës Ati Qiellor dhe Jezu Krishti kryejnë punën e Tyre. Ajo është fuqia më e madhe në tokë. Me anë të priftërisë kryhen ordinanca, jepen bekime, përmbushet puna në tempull, predikohet ungjilli dhe bëhen mrekulli.

Mbajtësit e priftërisë përfaqësojnë Shpëtimtarin, kështu që ata e nderojnë priftërinë duke bërë atë që Shpëtimtari do të bënte nëse Ai do të ishte këtu. Ata e nderojnë priftërinë duke jetuar denjësisht për të. Ata e nderojnë priftërinë me veshjet, veprimet, fjalët, shërbimin dhe madje me mendimet e tyre.

Të rejat mundën gjithashtu ta nderojnë priftërinë duke mbajtur besëlidhjet e tyre të pagëzimit dhe duke marrë pjesë me nderim në ordinancat e priftërisë të tilla si sakramenti apo puna në tempull. Ato mund t'i mbështesin baballarët, vëllezërit e tyre dhe mbajtësit e tjerë të priftërisë në mbajtjen e urdhërimeve dhe në të jetuarit denjësisht për të kryer detyrat e tyre të priftërisë.

Ne të gjithë mund ta nderojmë priftërinë duke shërbyer besnikërisht në thirrjet tona, duke i respektuar ata që mbajnë priftërinë, duke respektuar punën që ajo përmbush, dhe duke respektuar ordinancat dhe besëlidhjet që ajo na ndihmon të marrim.

Veproni si Përfaqësues i Perëndisë



Nëse ne mund të fillojmë ta kuptojmë sa e mrekullueshme është që Perëndia na e dha këtë dhuratë, atëherë nderimi i priftërisë bëhet i thjeshtë: veproni me mirënjohje dhe respekt ndaj fuqisë që ju është besuar. Pyeteni veten: “Nëse secili rreth meje do ta dinte që unë e mbaja fuqinë e Perëndisë, a do të mendonin ata më shumë apo më pak për Atë?” Ky është nderimi i priftërisë – është të kuptoni se jeni përfaqësues i Perëndisë dhe të bëni më

të mirën tuaj për të vepruar në një mënyrë që tregon respekt për besimin që Ai ka vendosur te ju.

Mejzën R., 19 vjeç, Kolorado, SHBA

Jini i Virtytshëm



Si e re mund të them se nuk është e nevojshme që ta nderoj priftërinë. Por të gjitha të rejat duhet vërtet ta bëjnë këtë. Ne e nderojmë priftërinë duke qenë të virtytshme. Ne e nderojmë priftërinë duke i ndihmuar të rinjtë të kenë mendime të pastra. Ne vishemi thjesht dhe flasim me një gjuhë të dëlirë. Duke e bërë këtë, ne i ndihmojmë të rinjtë që ta nderojnë priftërinë, kështu edhe ne e nderojmë priftërinë.

Mariza B., 14 vjeçe, Arizona, SHBA

Bëni Detyrën Tuaj ndaj Perëndisë

Mënyra kryesore për ta nderuar priftërinë është, sipas mendimit tim, të bësh gjërat që Vetë Zoti do të bënte nëse Ai do të ishte këtu në tokë, sepse ne përfaqësojmë Jezu Krishtin. Ajo do të thotë që ne t'i përmbushim të gjitha zotimet, detyrat dhe premtimet që i bëmë Perëndisë kur u shuguruam në priftëri. Duke e nderuar priftërinë e Tij, ne ndjekim urdhrin e Tij që të “ngrih[em] e shkëlqej[im], që drita [jonë] të mund të jetë një flamur për kombet” (DeB 115:5). Ne i ndihmojmë të tjerët që ta dinë se shumë shërbëtorë të autorizuar të Perëndisë janë mbi tokë.

Bismark B., 18 vjeç, Santo-Domingo, Republika Domenikane

Tregoni Respekt për Priftërinë

Unë mendoj se të nderosh priftërinë është të kesh respekt dhe mirëbesim në përdorimin e priftërisë. Kur ju keni anëtarë të Priftërisë Aarone që e respektojnë priftërinë dhe sakramentin siç bëjmë ne në lagjen tonë, atëherë ju mund të keni disa përvoja të mrekullueshme në shpërndarjen dhe përgatitjen e sakramentit. Ne të gjithë veshim këmisha të bardha me kravata. Ne e dimë se kjo ka ndikim të madh në lagje dhe ka pasur një ndikim tek unë. Unë e di se mbajtja e priftërisë është gjëja më e mirë që më ka ndodhur ndonjëherë.

Hensen B., 15 vjeç, Teksas, SHBA

Mos i Vini në Rrezik Standardet Tuaja

Të nderosh priftërinë do të thotë që të mos e vendosni veten në situata ku ju e dini se mund t'i vini në rrezik standardet tuaja. Kur ne studionim Dhiatën e Vjetër në seminar, ne gjetëm te Zanafilla 39 shembullin e Jozefit të Egjiptit që e nderoi priftërinë e tij duke u larguar nga afrimet e bashkëshortes së Potifarit.

Një mënyrë se si të rejat të na ndihmojnë ta nderojmë priftërinë është të ndjekin standardet në broshurën *Për Forcën e Rinisë* dhe të vishen thjesht.

Jozef B., 16 vjeç, Teksas, SHBA

Mbajeni Lart Priftërinë

Të nderosh priftërinë, për mua do të thotë që të rinjtë ta respektojnë dhe ta mbajnë lart dhuratën që Zoti u ka dhënë atyre. Kur unë shoh një të ri që e respekton priftërinë, unë ndihem aq shumë në paqe dhe kam më shumë respekt për atë të ri. Ati Qiellor i ka

besuar atij priftërinë, kështu që unë e ndiej se është detyra e një të riu që jo vetëm ta mbajë priftërinë, por gjithashtu ta ngrejë lart atë.

Melinda B., 16 vjeçe, Uashington, SHBA

Kujtojeni Shpëtimtarin



Priftëria është fuqia e vetme e vërtetë e Perëndisë në tokë dhe na tregon neve rrugën për t'u kthyer tek Ai. Kur ne mendojmë për nderimin e priftërisë, ne mendojmë të ndjekim mësimet nga Presidenti Tomas S. Monson dhe Apostujt e tjerë. Mënyra më e mirë për ta nderuar priftërinë është të bëjmë gjërat që na janë mësuar, të cilat na lejojnë ta kujtojmë Shpëtimtarin. Kur ne e kujtojmë Atë, Shpirti i Tij do të jetë me ne. Të pasurit e Shpirtit na lejon të

qëndrojmë te qëllimi dhe të jemi shembull i standardeve të Ungjillit.

Klasa e Shkollës të së Dieles: Kajli E., Xhejten B., Xhozef E., Aleksandra R., Kejli V., Alisha F. dhe Hejli W. (nuk është në foto); Ajdaho, SHBA



ËSHTË E SHENJTË

"Të rinjtë dhe të rejat . . . duhet ta nderojnë [priftërinë] dhe ta njohin atë si diçka që është e shenjtë, . . .

sepse është meritë e këtij autoriteti që ordinancat e ungjillit kryhen kudo në botë dhe në çdo vend të shenjtë, dhe pa atë ato nuk mund të kryhen. Ata që e mbajnë këtë autoritet duhet ta nderojnë atë brenda vetes. Ata duhet të jetojnë në një mënyrë të tillë që të jenë të denjë për autoritetin që iu është dhënë."

Presidenti Jozef F. Smith (1838–1918),
Teachings of Presidents of the Church: Joseph F. Smith (1998), f. 144.

PYETJA E RADHËS

"Çfarë u them unë jo-anëtarëve që pyesin përse disa anëtarë të Kishës nuk po i jetojnë standardet tona?"

Dërgojeni përgjigjen tuaj brenda datës 15 nëntor në liahona@ldschurch.org ose në:

Liahona, Questions & Answers 11/12
50 E. North Temple St., Rm. 2420
Salt Lake City, UT 84150-0024, USA

Përgjigjet mund të redaktohen lidhur me gjatësinë apo qartësinë.

Informacioni dhe leja e mëposhtme duhet të përfshihen në postimin elektronik apo letrën tuaj: 1) emri i plotë, 2) data e lindjes, 3) lagjja ose dega, 4) kunji ose distrikti, 5) leja juaj me shkrim dhe, nëse jeni nën moshën 18 vjeç, leja me shkrim e prindit tuaj (postimi elektronik pranohet) për botimin e përgjigjes dhe të fotografisë suaj.

JINI I URTË DHE JINI NJË MIK





**Nga Plaku
Robert D. Hejls,**
i Kuorumit të
Dymbëdhjetë Apostujve

*Mësoni dhe fitoni njohuri
e urtësi në rininë tuaj. Dhe
ngrijini e forcojini njerëzit
përreth jush.*

Nëse vërtet doni që të keni mundësi për të pasur një jetë të mirë, ju do të dëshironi të ndiqni këshillën që gjendet në shkriimet e shenjta: “Mëso urtësi në rininë tënde; po, mëso në rininë tënde të zbatosh urdhërimet e Perëndisë” (Alma 37:35). Procesi i të mësuarit mund të përmblihet në mënyrën e mëposhtme:

Ne të gjithë fillojmë me inteligjencë bazë. Ne i shtojmë njohuri asaj nëpërmjet mësimi që marrim në klasë dhe gjatë leximit. Ne i shtojmë përvoja të jetës. Dhe pastaj ne shkojmë te hapi i katërt: urtësia. Atje është vendi ku procesi i të mësuarit të botës ndalet. Por ne kemi diçka që bota nuk e ka. Me pagëzimin dhe konfirmimin, neve na jepet dhurata e Frymës së Shenjtë. Bazuar te besnikëria jonë ndaj ligjeve, ordinancave dhe besëlidhjeve që marrim përsipër në pagëzim, në zotimet e rregullta dhe të vazhdueshme në

mbledhjet e sakramentit dhe në besëlidhjet e priftërisë e të tempullit, ne do të kemi gjithmonë dhuratën e Frymës së Shenjtë që do të na mësojë dhe do të na drejtojë. Shpirti na udhëheq për të vepruar dhe për të bërë. Ne të gjithë kemi dhurata shpirtërore dhe talente (shih DeB 46).

Urtësia plus dhuratat shpirtërore çojnë në një kuptueshmëri në zemër. “Dituria është gjëja më e rëndësishme; prandaj fito diturinë. Edhe sikur të humbasësh ato që ke, fito diturinë” (Fjalët e Urta 4:7). Është e rëndësishme të kultivoni urtësi dhe kuptueshmëri në rininë tuaj.

Një përvojë nga rinia ime më soi diçka rreth urtësisë. Unë isha një djalë qyteti, kështu që babai im më dërgoi të punoja në fermën e burrit të tezes në Jutan perëndimore. Ndërsa ndodhesha atje, unë nuk mundesha kurrë të kuptoja përse bagëtitë, duke pasur me mijëra hektarë nga të cilët mund të zgjidhnin, e futnin kokën nëpër telat me gjemba për të ngrënë bar në anën tjetër të gardhit. A keni menduar ndonjëherë rreth faktit se sa shumë ngajmë ne me ta? Ne gjithmonë do të shtyhemi të shohim

cilët janë caqet e jashtme, sidomos në rininë tonë. Si qenie njerëzore – njerëz të natyrshëm – ne priremi të shtyhemi te telat me gjemba dhe e nxjerrim kokën përmes tyre. Përse e bëjmë atë?

Ne mund të kemi aq shumë gëzim në jetë pa i shtyrë caqet. Kujtoni: “Dituria është gjëja më e rëndësishme” dhe, me atë urtësi, “mos hy[ni] në shtegun e të pabesëve dhe mos ec[ni] në rrugën e njerëzve të këqij; evitoje[ni] atë, mos kalo[ni] nëpër të; largoju[ni] prej saj dhe shko[ni] tutje” (Fjalët e Urta 4:14–15). Mos u afroni. Mos e fusni kokën përmes gardhit me tela e me gjemba.

A Keni Miq të Mirë?

Ju do të vini re se, së bashku me këto mësimet mbi urtësinë, libri i Fjalëve të Urta na mëson edhe rreth zgjedhjes së miqve të mirë: “Mos hyr në shtegun e të pabesëve dhe mos ec në rrugën e njerëzve të këqij” (Fjalët e Urta 4:14). “Biri im, mos shko me ta në po atë rrugë, ndale hapin nga shtegu i tyre, sepse këmbët e tyre turren drejt së keqes” (Fjalët e Urta 1:15–16).

Si e dini nëse keni miq të mirë? Unë do t'ju jap dy prova. Nëse i zbatoni këto prova, ju kurrë nuk do të shkoni në shtigje të huaja dhe të dilni nga "shteg[ui] [i] ngushtë dhe [i] ngushtuar që të çon në jetën e përjetshme" (2 Nefi 31:18).

1. **Miqtë e mirë e bëjnë të lehtë që t'i jetoni urdhërimet kur jeni me ta.** Një mik i vërtetë ju forcon dhe ju ndihmon t'i jetoni parimet e ungjillit që do t'ju ndihmojnë të duroni deri në fund.
2. **Një mik i vërtetë nuk do t'ju bëjë të zgjidhni midis mënyrave të tij apo të saj dhe mënyrave të Zotit,** duke ju larguar kështu nga shtegu i ngushtë dhe i ngushtuar. Kundërshtari i bie kryq e tërthor kësaj toke dhe dëshiron aq shumë që ta rrëzojë secilin prej nesh. Nëse miqtë tuaj po ju çojnë në shtigjet e ligësisë, largohuni prej tyre tani. Zgjidhni miqtë tuaj me mençuri.

Çfarë Lloj Miku Jeni Ju?

Tani unë po ju bëj një pyetje të vështirë: çfarë lloj miku jeni *ju*?

Ka më shumë në jetë se të shpëtuarit e vetes. Ne jemi porositur t'i ngremë dhe t'i forcojmë të gjithë njerëzit përreth nesh. Zoti na do të gjithëve përsëri tek Ai së bashku.

Ju jeni një far dhe nuk ka asgjë më të rrezikshme sesa një far i prishur. Kujtohuni cilët jeni: ju jeni dritë për botën, për miqtë tuaj, për vëllezërit dhe motrat tuaja. Ju jeni ai tek i cili ata vështrojnë.



Jini dritë për botën dhe udhëhiqini e udhëzojini njerëzit përreth jush në shtigjet e drejtësisë. Ata po mbështeten te ju si një far besnik.

Libri Fjalët e Urta 4 vazhdon:
"Por shtegu i të drejtëve është si drita e agimit, që shkëlqen gjithnjë e më mirë deri sa të bëhet ditë e plotë.
Rruga e të pabesëve është si terri; ata nuk shohin atë që do t'i rrëzojë" (vargjet 18–19).

Ata vërtet nuk dinë përse po pengohen. Ata nuk kanë as dritë, as drejtim.

A e dini se si është të mbështetesh te një far kur ai nuk ka dritë? Errësira vjen dhe ne humbasim.

Kur një pilot humbet energjinë elektrike, ai nuk ka tregues përveç atyre gjërave që punojnë pa

elektricitet. Ai ndihet tërësisht i pashpresë kur është në një aeroplan luftarak njëvendësh 12.200 metra lart në ajër i mbështjellë nga re dhe gjëra të tilla. Ai nuk ka ndonjë drejtim. Unë i mbijetova një përvoje si ajo dhe jam i gëzuar që jam këtu. Është një përvojë që nuk do ta harroj kurrë. Ju gjithashtu mund ta gjeni veten në një pozitë të tillë një ditë. Nuk ka asgjë aq të rrezikshme sa një far i prishur, veçanërisht kur jeni duke u mbështetur te drita.

A është ndokush duke u mbështetur te drita juaj që ta drejtojë? Jini një shembull i mirë. Jini dritë për botën dhe udhëhiqini e udhëzojini njerëzit përreth jush në shtigjet e drejtësisë. Ata po mbështeten te ju si një far besnik. Jini atje kur dikush ka nevojë për ju.

Shpirti është drita udhëzuese që sjell gëzim dhe lumturi. Mos na u mohoftë kurrë prania e Shpirtit për shkak të sjelljes sonë. Oh, sa lutem që ne të mos jemi kurrë vetëm dhe të dëshpëruar në këtë botë "të errët dhe të zymtë" (1 Nefi 8:4).

Qofshin bekimet e Zotit me ju ndërsa përpiqeni të mësoni dhe të fitoni dituri dhe urtësi në rininë tuaj. Fitofshi gjithashtu urtësi dhe kuptueshmëri në zemrën tuaj për të vërtetat e Ungjillit me anë të bindjes dhe gjithashtu me anë të dritës së Shpirtit, Frymës së Shenjtë. Jini një mik i mirë. Ngrijini e forcojini njerëzit përreth jush. Bëjeni botën një vend më të mirë për shkak të pranisë suaj këtu. Ndihmohuni miqtë të qëndrojnë në shtegun e ngushtë dhe të ngushtuar, të durojnë deri në fund dhe të kthehen me nder. ■

VESHJA për një Vallëzim

Nga Kristëll Martin

Unë u tundova të ndiqja turmën, por pastaj kuptova se në vend të kësaj duhej të isha një shembull.

Kur isha adoleshente, ndonjëherë ishte e vështirë ta jetoje ungjillin. Zona ku banoja unë nuk kishte shumë anëtarë të Kishës dhe miqtë e mi, që nuk ishin anëtarë të Kishës, ndonjëherë ma bënë më të vështirë që të qëndroja në rrugën e drejtë.

“Ti duhet të veshësh këtë; do të të nxjerrë në pah ngjyrën e syve”, më tha një nga mikeshat e mia përpara një vallëzimi. Ajo më tregoi një fustan që do të ma jepte borb, por ai ishte pa mëngë. Unë vendosa ta vishja fustanin me një xhakëtë.

Kur shkova në vallëzim, askush tjetër nuk kishte veshur fustan me mëngë dhe unë ndihesha sikur po dilja veç të tjerëve. Kur fillova të kisha tepër vapë, miqtë më thanë se duhej

thjesht ta hiqja xhakëtën dhe që gjithsesi do të dukesh më mirë.

Sapo po përgatitesha ta justifikoja heqjen e xhakëtës, unë kujtova bekimin tim patriarkal. Bekimi më tregoi se do të kem shumë tundime dhe, nëse do të rrëzohesha, shumë individë do të ndiqnin shembullin tim. Aty ishte kur unë kuptova se duhej të qëndroja në rrugën e drejtë – jo vetëm për vete por për të tjerët që shihnin tek unë. Unë vendosa ta mbaj xhakëtën veshur.

Ndonjëherë më tallnin ngaqë nuk bëja gjërat që çdokush tjetër i bënte, por unë qëndrova e fortë dhe u bekova për këtë. Më vonë mësova se shumë njerëz kishin parë tek unë. Disa nga miqtë e mi madje më treguan se ata më respektonin ngaqë ndiqja

standardet e mia. Ata më kërkuan falje që më kishin shkaktuar shqetësime ngaqë nuk bëja gjërat që çdokush tjetër i bënte në shkollën e mesme.

Për shkak se i ndoqa standardet e Kishës dhe u përpoqa të isha një shembull, unë pata mundësi të kisha përvoja misionare dhe t'u mësoja ungjillin të tjerëve. Unë nuk do të isha në gjendje të ndikoja te të tjerët nëse nuk do të kisha qëndruar në rrugën e drejtë. ■



STANDARDET E VESHJES

“Asnjëherë mos i ulni standardet tuaja të veshjes. Mos përdorni një rast të veçantë si justifikim për të qenë jo modest/e. . . . Të rehat duhet të shmangin . . . veshjet që nuk mbulojnë shpatullat.”

Për Forcën e Rinisë (broshurë, 2011), f. 6, 7.

Veshja dhe Pamja e Jashtme

“LËRENI SHPIRTIN E SHENJTË T’JU UDHËZOJË”



Nga Meri N. Kuk,
Këshilltare e Parë në
Presidencën e Përgjith-
shme të Të Rejave

Si përfaqësuese të Krishtit, ne duhet të tregojmë respekt për trupat tanë “në të gjitha kohërat dhe në të gjitha vendet” duke iu përmbajtur disa standardeve.

Kimi ka mbajtur gjithmonë veshje të thjeshta. Ditën tjetër unë e pyeta për mendimin e saj mbi atë se çfarë quan ajo një fund të thjeshtë, një bluzë të thjeshtë dhe një veshje të thjeshtë noti. Në vend që të merremi me masat e sakta për gjatësinë e fundeve dhe të dekolteve, ne diskutuam parimet që lidhen me thjeshtësinë dhe sfidën e gjetjes së veshjes së thjeshtë që duket tërheqëse. Ne patëm një vërshim argëtues mënyrash se si ta zgjasim në mënyrë krijuese një fund. Më në fund Kimi tha: “Nëse unë nuk ndihem rehat kur vesh për herë të parë diçka, zakonisht kjo do të thotë se nuk është veshje e thjeshtë dhe se nuk do të ndihem rehat duke e veshur. Unë kam mësuar që të mos e blej kurrë atë. Unë thjesht e vendos përsëri në varëse.”

Ndërsa Kimi përpiqet të jetojë denjësisht, Fryma e Shenjtë mund ta udhëzojë atë në zgjedhjet e veshjeve të saj. Ajo i jeton lirshëm standardet e thjeshtësisë dhe nuk përpiqet t'i ndryshojë rregullat e veshjes dhe të pamjes së jashtme. Ajo e kupton se trupi i saj është një tempull (shih 1 Korintasve 3:16) dhe se

ajo ka përgjegjësi të kujdeset, ta mbrojë dhe ta veshë atë siç duhet.

Kur ndërtohet një tempull, tregohet kujdes i madh për të garantuar se është i mbrojtur dhe i stolisur bukur, brenda dhe jashtë. Çelësi në planifikimin e tempujve është të kuptuarit se një tempull *përfaqëson* Zotin – ai është shtëpia e Tij. Ne *i respektojmë* tempujt si ndërtesa të shenjta, ku vetëm ata që janë të denjë mund të hyjnë. Ne *i nderojmë* tempujt sepse ordinancat dhe besëlidhjet e shenjta në të cilat marrim pjesë, bëjnë të mundur për ne që të kthehemi tek Ati ynë Qiellor.

Trupi juaj është më i çmuar sesa tempulli më i bukur mbi tokë. Ju jeni biri apo bija e dashur e Perëndisë! Po të njëjtat parime – paraqitja, respekti dhe nderimi – zbatohen edhe më shumë për kujdesin dhe mbrojtjen që ju i bëni trupit tuaj.

Paraqitja

Çdo javë ndërsa marrim sakramentin, ne marrim përsipër emrin e Shpëtimtarit. Ne jemi përfaqësueset e Tij në tokë. Një nga udhëzimet në broshurën *Për Forcën e Rinisë* thotë: “Përmes veshjes dhe pamjes suaj të jashtme ju mund t’i tregoni [Zotit] se e dini se sa i çmuar është trupi juaj. Ju mund të tregoni se jeni një dishepull i Jezu Krishtit dhe se ju e doni Atë.”¹

Kur një e re e lexoi këtë thënie, ajo vendosi që nuk dëshironte madje as t’i afrohej kufirit

të mungesës së thjeshtësisë. Menjëherë, ajo hoqi gjithçka në gardërobën e saj që nuk ishte në përputhje me të qenit një përfaqësuese e Shpëtimtarit. Ajo tha: “Unë do të isha e zgjuar nëse as nuk do të provoja asgjë nëpër dyqane që e di se nuk duhet ta vesh. Përse të tundohesh?” Parimi i përfaqësimit e ndihmoi atë të merrte atë vendim të prerë.

Respekti

Si përfaqësuese të Krishtit, ne tregojmë respekt për trupin tonë “në të gjitha kohërat dhe në të gjitha gjërat dhe në të gjitha vendet” (Mosia 18:9) duke pranuar t’u përmbahemi disa standardeve. Zoti kërkon që vetëm ata që janë të pastër mund të hyjnë në tempull. Zgjedhja juaj për të qenë e virtytshme është tregues i respektit tuaj për Zotin dhe trupin tuaj fizik.

Ne duhet të tregojmë respekt edhe për trupat e të tjerëve dhe t’i ndihmojmë ata të jetojnë jetë të virtytshme. Plaku M. Rasëll Ballard, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, tha: “[Të rejave] u duhet të kuptojnë se, kur mbajnë fustan tepër të ngushtë, tepër të shkurtër apo të çarë tepër thellë, jo vetëm që u japin një mesazh të gabuar të rinjve me të cilët shoqërohen, por ato gjithashtu përjetësojnë në vetë mendjen e tyre falsitetin se, vlera e një gruaje varet vetëm nga joshja sensuale e saj. Kjo kurrë nuk ka qenë dhe as nuk do të jetë ndonjëherë brenda përkufizimit të drejtë të një bije besnike të Perëndisë.”²

Të reja, respektojeni trupin tuaj dhe ndihmohini të tjerët, veçanërisht të rinjtë, të kenë mendime dhe veprime të virtytshme. Respektojeni trupin tuaj, duke ditur se të jetuarit drejtësisht *përditë* ju jep juve vlerë *të përjetshme*.

Nderimi

Plaku Robert D. Hejls, nga Kuorumi i Dymbëdhjetë Apostujve, na mësoi: “Ashtu

si themelet e tempullit portretizojnë shenjtërinë dhe nderimin për atë që ndodh brenda tempullit, veshja jonë portretizon bukurinë dhe pastërtinë e brendisë sonë. Mënyra se si vishemi portretizon nëse e kemi respektin e duhur për . . . ordinancat dhe besëlidhjet e përjetshme dhe nëse po e përgatisim veten për t’i marrë ato.”³

Tregojeni nderimin tuaj për sakrificën shlyese të Shpëtimtarit tonë duke veshur “më të mirat e së dieles” për të marrë pjesë në ordinancën e sakramentit. “Të rinjtë duhet të vishen me dinjitet kur kryejnë detyra në ordinancën e sakramentit.”⁴ Të reja, vishuni thjesht.

Ngrihuni! Jini shembulli i veshjes së thjeshtë në shtëpi, në shkollë, në plazh, në vallëzime apo kur merrni pjesë në sporte. Ndiqni shembullin e Kimit kur zgjidhni veshjen tuaj, duke e lënë Shpirtin e Shenjtë t’ju udhëzojë në vendimet tuaja. “Bëjini vetes pyetjen: ‘A do të ndihesha mirë me pamjen time të jashtme nëse do të isha në praninë e Zotit?’”⁵

Nëse i jetoni këto tre parime – paraqitjen, respektin dhe nderimin – kur zgjidhni veshjet tuaja, ju *do të* “shkëlqeni” (Doktrina e Besëlidhje 115:5) si përfaqësuese të dashura të Shpëtimtarit. ■

SHËNIME

1. *Për Forcën e Rinisë* (broshurë, 2011), f. 6.
2. M. Rasëll Ballard, “Nëna dhe Bija”, *Liahona*, maj 2010, f. 20.
3. Robert D. Hales, “Modesty: Reverence for the Lord”, *Liahona*, gusht 2008, f. 10.
4. *Për Forcën e Rinisë*, f. 8.
5. *Për Forcën e Rinisë*, f. 8.



TË FORCUAR

NGA FJALA

*Adoleshentët dëshmojnë për kohën
kur shkrimet e shenjta u dhanë
atyre mësim, i ngushëlluan
dhe i udhëzuan ata.*




SHKRIMET E SHENJTA NDIHMOJNË NË KOHË NEVOJE

"Shkrimet e shenjta janë si sasitë e vogla të dritës që ndriçojnë mendjet tona dhe na përgatisin për drejtim dhe frymëzim nga lart. . . . Fuqi e madhe mund të vijë nga futja në kujtesë e shkrimeve të shenjta. Futja në kujtesë e shkrimeve të shenjta është si të krijosh miqësi të re. Ajo është si të zbulosh një individ të ri që mund të të ndihmojë në kohë nevojë, të japë frymëzim e ngushëllim dhe të jetë një burim nxitjeje për ndryshimin e nevojshëm."

Plaku Riçard G. Skot i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, "Fuqia e Shkrimeve të Shenjta", *Liahona*, nëntor 2011, f. 6.

Ne u kërkuam të rinjve që të na tregojnë rreth një kohe kur një shkrim i shenjtë që e dinin përmendsh, kishte qenë i dobishëm për ta, siç ishte rasti rreth të cilit foli Plaku Riçard G. Skot, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, në konferencën e përgjithshme të tetorit të 2011-ës (shih kolonën anash). Këtu janë disa nga përgjigjet e tyre.



Paqe Shpirtit Tim

“Biri im, paqe i qoftë shpirtit tënd; fatkeqësia jote dhe mjerimet e tua do të jenë veçse një çast i shkurtër” (DeB 121:7).

Shkrimi i shenjtë që më ka dhënë mua ngushëllimin më të madh ndër vite është Doktrina e Besëlidhje 121:7, kur Profeti Jozef Smith ishte në burgun e Libertisë duke i thirrur Atit Qiellor për ndihmë. Unë e mësova përmendsh këtë varg në seminar dhe e kujtoj kur kam nevojë për ngushëllim. Ai më kujton se Ati im në Qiell më do dhe është në dijeni të sprovave të mia. Unë e kam përdorur këtë varg që të më sjellë paqe në kohë zhgënjimi dhe dobësie.

Ky varg më ndihmoi kur isha në një festë që u shndërrua në një mjedis ku e dija se nuk duhej të ndodhesha. Me mirësjellje u thashë miqve të mi ‘jo’ kur më kërkuan të pija alkool apo duhan. Ky varg më dha forcën që më duhej për t’u dalë zot bindjeve të mia.

Ky varg më ndihmoi edhe për të marrë një vendim të vështirë. Mikesha ime dhe unë patëm qenë të pandara për pesë vite. Ne luanim sporte së bashku, shkonim në

udhëtime së bashku dhe dilnim çdo fundjavë. Por ajo filloi të rrinte me një grup më të vjetër miqsh me të cilët unë nuk doja të kisha lidhje. Në fund ajo më bëri të zgjedh midis miqësisë me të ose qëndrimit të bindjet e mia lidhur me Fjalën e Urtësisë dhe ligjin e dëlirësisë. Unë u dërrmova. Nuk e kisha menduar kurrë se të ngrihesha për atë që besoja mund të ishte aq e rëndë. Por zgjodha të bëj miq të rinj, duke pasur gjithmonë në mendje premtimin e Atit Qiellor drejtuar Jozef Smithit se çdo gjë do të shkojë mirë.

Asgjë nuk ia vlen që të rrezikoj bindjet e mia, dhe unë përjetova një gëzim të vërtetë dhe të përhershëm kur zgjodha të drejtën. Ky shkrim i shenjtë e ka forcuar dëshminë time dhe më ka ndihmuar kur kam pasur nevojë për të.

Loren J.

16 vjeçe, Arkansas, SHBA

Gjërat e Dobëta të Bëhen të Forta

Muaj përpara hyrjes në provim për në shkollën e mesme, unë nuk ndihesha i përgatitur. Isha i sigurt se do të ishte e pamundur të dilja mirë. Kështu që iu drejtova Atit tim Qiellor në lutje. Ndërsa po lutesha, më erdhën në mendje këto fjalë: “Dhe në qoftë se njerëzit vijnë tek unë, unë do t’u tregoj atyre dobësinë e tyre. Unë u jap njerëzve dobësi, që ata të jenë të përlulur dhe hiri im është i mjaftueshëm për të gjithë njerëzit që përlulen para meje; pasi në qoftë se ata përlulen para meje dhe kanë besim tek unë, atëherë unë do të bëj që gjërat e dobëta, të bëhen të forta në ta” (Ethëri 12:27).

Unë e kuptova se kur unë i lutem Atit Qiellor për forcë që të përballoj sfidat dhe provat, Ai më bekon dhe më ndihmon t’i kapërcej dobësitë e mia. Paraqitja e shqetësimit tim te Zoti ishte vendimi më i mirë që mund të merrja. Ai është mësuesi më i mirë dhe unë e di se Ai më ndihmoi.

Irvin O.

16 vjeç, Salvador





Lutuni Kurdoherë

“Lutu gjithmonë që të mund të dalësh fitues; po, që ti të mund të mposhtësh Satanin dhe që ti të mund t’u shpëtosh duarve të shërbëtorëve të Satanit që vërtet përkrahin veprën e tij” (DeB 10:5).

Ky varg më ndihmon të përballoj tundimet. Kur jam gati duke bërë diçka që e di se është e gabuar, ky varg dhe mesazhi i tij vijnë në mendjen time. Çdo herë të vetme kur unë lutem pasi e kam atë nxitje, unë marr ndihmën që më duhet, për të kapërcyer tundimet me të cilat jam përballur.

Xhezi F.

17 vjeç, Juta, SHBA

Unë Jam me Ty

“Ji i duruar në mundime, sepse do të kesh shumë; por duroji ato, pasi, vër re, unë jam me ty, madje deri në mbarim të ditëve të tua” (DeB 24:8).

Mësimi përmendsh i këtij shkrimi të shenjtë ka qenë një bekim, veçanërisht kur jam ndier e trembur ose e vetmuar. Kurdo që e kujtoj atë, unë marr kurajë dhe ndihem më mirë. Si të rinj dhe të reja, ne kemi nevojë për udhëzim dhe mbështetje, veçanërisht kur përballemi me sprova dhe sfida të vështira. Edhe pse ndonjëherë e ardhmja duket e pasigurt ose shkurajuese, unë e di se mund të besoj te Zoti dhe të marr përqaftimin e Tij të ngrohtë.

Kur isha e vogël, më kishin mësuar në shtëpi dhe në Filllore se Zoti do të jetë gjithmonë pranë meje nëse unë do të bëja pjesën time. Në sajë të atyre mësimëve dhe gjithashtu të këtij shkrimi të shenjtë, unë e di se mund të mbështetem gjithmonë tek Ai.

Sofia I.

15 vjeçe, Uruguaj



VENDOSNI NJË SYNIM

Mbani parasysh të vendosni një synim për të futur në kujtesë disa shkrime të shenjta. Ju mund të fusni në kujtesë vargje mjeshtëri të shkrimeve të shenjta në seminar ose si pjesë e broshurës Detyrë ndaj Perëndisë ose Përpërkëmt Personal.

E DREJTË DHE E NGUSHTË ËSHTË UDHA

Ka shumë udhë për të zgjedhur, por vetëm
një të çon në jetë të përhjetshme.

(Shih 2 Nefi 9:41; 31:17-21; Alma 7:9.)



Largimi nga

Kur të jetë koha për të përparuar te Të Rinjtë ose Të Rejat, ka disa nga përvojat të cilat ju duhet t'i prisni!

Ç'DO TË THOTË TË JESH TE TË RINJTË?

Priftëria Aarone – Shërbimi ndaj të Tjerëve për Shpëtimtarin

Shpërndarje e sakramentit
Mbledhje e ofertave të agjërimit
Forcim i familjes suaj

Detyrë ndaj Perëndisë


Të mësuarit dhe të bërit
e gjërave të reja
Ndarja me të tjerët
Zhvillimi i një marrëdhënieje
më të afërt me Atin Qiellor

Për Forcën e Rinisë

Standarde për t'ju bërë të fortë

Përgatitje e Vetes Suaj

Për një mision
Për martesë dhe atësi



Vajtje në Tempull

Të pagëzohesh për ata që kanë
ndërruar jetë
Të përgatitesh për të bërë besëlidhje
Të ndierit e Frymës së Shenjtë

Veprimtaritë

Shërbimi me kuorumin tuaj
Argëtim i ndërsjelltë!

Të dashur të rinj të Fillores,

Kur të mbushni 12 vjeç, ju do të jeni në moshën e duhur për të marrë Priftërinë Aarone. Kjo është shumë e rëndësishme. Kur Perëndia ju jep priftërinë e Tij, Ai do të jetë duke ju treguar se Ai beson te ju. Do të jetë detyra juaj e shenjtë t'u shërbeni të tjerëve siç do të bënte Shpëtimtari.

Tani është koha të filloni të përgatiteni. Vështrojeni dhe dëgjoni mbajtësit e priftërisë përreth jush ndërsa ata e bekojnë dhe e shpërndajnë sakramentin, pagëzojnë, japin bekime, shërbejnë misione dhe udhëheqin familje. Bëni gjithmonë më të mirën tuaj për t'i jetuar standardet e ungjillit. Atëherë ju do të jeni të përgatitur për atë ditë të madhe kur do të merrni Priftërinë Aarone.



Sinqerisht,
Dejvid L. Bek,
President i përgjithshëm i Të Rinjve

Fillorja

Ç'DO TË THOTË TË JESH TE TË REJAT?

Mikesha të Reja

Nxënie dhe argëtim së bashku
Mbështetje e njëra-tjetrës

Rritje e Besimit Tuaj te Jezu Krishti

Qëndrim për të vërtetën dhe drejtësinë
Ndarje e dëshmisë suaj

Për Forcën e Rinisë

Standarde për t'ju bërë të forta

Përparimi Personal

Gjëra të reja për të mësuar
Vendosje synimesh dhe rritje në virtyt

Vajtje në Tempull

Të pagëzohesh për ata që kanë ndërruar jetë
Të ndiesh Frymën e Shenjtë
Të përgatitesh për të bërë besëlidhje

Veprimtaritë

Të shërbyerit së bashku
Argëtim i ndërsjelltë!

Përgatitje e Vetes Suaj si Bijë e Perëndisë

Të jesh udhëheqëse dhe
një shembull i mirë
Për t'u bërë bashkëshorte
besnike dhe nënë



Të dashura të reja të Fillores,

Ne jemi kaq të emocionuara për ditën kur ju do të bashkoheni me Të Rejat! Ju jeni një bijë e çmuar e Atit Qiellor. Te Të Rejat ju do të mësoni të qëndroni si dëshmitare të Tij në të gjitha kohët dhe në të gjitha gjërat dhe në të gjitha vendet. Ju do të merrni një varëse që t'ju kujtojë të qëndroni për të vërtetën dhe drejtësinë dhe ta lini dritën e Shpëtimarit ta ndriçojë tërë botën. Libri juaj i Përparimit Personal do t'ju ndihmojë të studioni shkrimet e shenjtë, të vendosni synime vetjake dhe të përparoni në shtegun drejt tempullit. Të gjitha këto gjëra do t'ju ndihmojnë të përgatiteni për të qenë një bashkëshorte, nënë dhe një udhëheqëse e mrekullueshme në botë.

Sinqerisht,
Elen S. Dalton,
Presidente e përgjithshme e Të Rejave



FOTOGRAFI © BUSATH PHOTOGRAPHY

E dashur Amiga,

Tungjatjeta nga Meksika! Unë u gëzova kur mora letrën tënde dhe mësova për ditëlindjen tënde që po afron. Duket se je paksa e shqetësuar që do të largohesh nga Fillorja. A mund të të tregoj për kohën kur unë shkova te Të Rejat?

Unë, gjithashtu, isha e shqetësuar që do largohesha nga Fillorja. Unë shqetësohesha se mund të mos bëja miq. Unë isha e trembur se do të isha një ndër vajzat më të vogla në vend që të isha ndër më të mëdhatë.

Por të gjitha shkuan thjesht shumë mirë. Peshkopi më intervistoi përpara ditëlindjes sime dhe më tha se ndryshimi do të ishte një gjë e mirë. Të dielën, mua më vinte ende turp dhe qëndrova në klasën e Fillores. Fatmirësisht, një nga udhëheqëset e Të Rejave më gjeti atje. Ajo tha: "E dija që do të të gjeja këtu! Hajde, është koha të shkojmë në klasë."

Motra Diaz më uroi mirëseardhjen në ushtrimet e hapjes dhe ajo më dha tri libra që kam arritur t'i dua: Për Forcën e Rinisë, Përparimi Personal i Të Rejave dhe një ditar. Ndërsa shihja përreth klasës, kuptova se unë i njihja disa nga vajzat atje që prej Fillores. Disa nga vajzat që nuk i njihja, më përshëndetën. Shpejt unë ndieva paqe në vend të frikës.

Gjërat vetëm vazhdonin të përmirësoheshin pas asaj. Veprimtaritë e përbashkëta kanë qenë të veçanta për mua sepse më kanë mësuar si ta jetoj ungjillin dhe si t'i ndihmoj familjen e miqtë e mi. Dhe vajtja në kamp çdo vit është një argëtim aq i madh! Tani që jam Dafinë, unë shpresoj ta përfundoj shpejt Përparimin Personal. Mezi po pres të mbaj medaljonin e Të Rejave në mënyrë që të më kujtojë se sa i jam përqasur Atit tim Qiellor ndër vite.

Kështu mos u tremb, mikja ime. Hapi krahët e tua dhe fluturo te Të Rejat. Unë të premtoj se nuk do të pendohesh.

Me dashuri,
Maribela

Duke i Uruar Mirëseardhjen një Stinë të Re të Jetës

Nga Marisa Uidison

Revistat e Kishës

A jetoni në një zonë ku pemët ndryshojnë ngjyrë për t'u përgatitur për dimrin? Këta katër miq po. Noe B., Dilan L., Patrik M. dhe Ben M. të gjithë jetojnë në ishullin Princ Eduard, afër bregut lindor të Kanadasë. Sikurse pemët, këta djem po përgatiten për një stinë të re të jetës. Ata po bëhen 12 vjeç të gjithë brenda një viti dhe kjo nënkupton t'i thuash "lamtu-mirë" Fillores dhe "tungjatjeta" Të Rinjve. Ja çfarë kishin për të thënë ata mbi rritjen dhe përparimin.

Jini Vetvetja

Kur Noeu erdhi këtu, miqtë e tij të rinj e ndihmuan atë të përshtatej me jetën në ishull. Tani, si më i rrituri në grup, ai po i ndihmon ata të mësohen me jetën si Të Rinj. "Unë isha i shqetësuar mbi të qenit i pranuar dhe njohjen me të tjerët",

tha Noeu mbi fillimin të Të Rinjtë. "Vajtja në aktivitete më ndihmoi vërtet." Kënga e parapëlqyer e Fillores për Noeun është mbi ushtrinë e Helamanit dhe ajo është mënyra se si ai e sheh kuorumin e priftërisë – si të qenit bashkë, të bashkuar.

Këshilla e tij? "Jini Vetvetja."

Respektojeni Priftërinë

Për Patrikun, marrja e priftërisë nuk lidhet me arritjen e një moshe të caktuar. Ajo lidhet me të qenit i denjë dhe i përgatitur. "Ju nuk e merni priftërinë thjesht sepse jeni 12 vjeç", tha Patriku. "Ju duhet të jeni i përgatitur."

Dilani e kupton sa e rëndësishme është përgatitja. Ai përpaket të shkojë në Kishë 15 minuta më herët që të përgatitet shpirtërisht për të shpërndarë sakramentin. "Unë e kam shpërndarë sakramentin tri ose katër herë dhe çdo herë Shpirti ma prek zemrën. Unë nuk mendoj


se do të mësohem ndonjëherë me këtë", tha ai.

Beni tha se shpërndarja e sakramentit i kujton atij Darkën e Fundit: "Jezusi qëndronte atje. Ne po qëndrojmë atje ku ishte Jezusi, dhe Ai na do të jemi atje."

Vështroni drejt Tempullit

Beni po punon për të fituar Çmimin Besim në Perëndi dhe mezi po pret që të bëjë për herë të parë pagëzime për të vdekurit. "Unë nuk kam qenë ende brenda tempullit, por të tjerët gjithmonë më japin dëshmi rreth asaj se sa mirë dhe të dashur ndihen ata pasi shkojnë atje", tha Beni.

Noeu bëri vizitën e tij të parë në tempull së fundi. Ai tha se të rinjtë në kuorumin e tij e trajtuan atë si pjesëtar të familjes. "Ju mund të ndiheni në siklet, por atje do të ketë njerëz që t'ju ndihmojnë", tha ai. "Ju do të ndiheni i mirëpritur." ■



Eja, Zot Jezus

Me thjeshtësi ♩ = 72-84

Nga prodhimi i Kishës i
Shpëtimtari i Botës: Lindja dhe Ringjallja e Tij



1. E - ja Zot Je - zus Ti në grazhd; Mund t'sho-him t'ëm-blën fy - tyr'?

2. E - ja Zot Je - zus tek kush vuan, Ze - mër-vrar' plot për - ul' - si.

3. E - ja Zot Je - zus Shpë - tim - tar, Ti je si drit' më-ngje - si.

Ti Kri - ju - es, k'tu i hu - aj, Fosh-një në k'të vend të thjesht'.

Qengj me da-shu - ri pa - ku - fi, Ler' shpir-trat t'pu-shojn' te Ti.

Bijt' - e Tu do je - mi për - her'; Fshi - na lo - tët, va - jin ndall!

Zhdu-ke te - rrin, sill-na drit'; E - ja Zot E - ma - nu - el.

E - ja n'la - vdi Ti në tok'; E - ja te ne t'mbre-të - rosh.

E - ja n'la - vdi Ti në tok'; E - ja te ne t'mbre-të - rosh.

E - ja Zot Je - zus Ti në grazhd; Zot, Ti e - ja, Zot!

Na për-ga - tit n'gjunj t'a - dhu - rojm'; Zot, Ti e - ja, Zot!

Na për-ga - tit n'gjunj t'a - dhu - rojm'; Zot, Ti e - ja, Zot!

Shpëtimtari i Botës: Lindja dhe Ringjallja e Tij u shkrua dhe u kompozua nën drejtimin e Presidencës së Parë dhe të Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve.

© 2003 IRI. I rezervohen të gjitha të drejtat. Kjo këngë mund të kopjohet për ta përdorur me raste në shtëpi ose në kishë, jo për tregti. Të përfshihet ky shënim në çdo kopje që bëhet.



Plaku Dallin H. Oaks, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, shpreh disa mendime mbi këtë temë.


Përse është E RËNDËSISHME që ta ndjek me besnikëri JEZU KRISHTIN, pavarësisht se ku ndodhem?



Jezu Krishti është
Biri i Vetëmlindur dhe
i Dashur i Perëndisë.



Ai është Krijuesi ynë.
Ai është Drita e Botës.
Ai është Shpëtimtari ynë
nga mëkati dhe vdekja.



Kjo është njohuria më
e rëndësishme mbi tokë
dhe ju mund ta dini këtë
për veten tuaj.



Ne jemi pasues të Jezu
Krishtit. Nuk ka rrugë
të mesme.



Bekimet e Priftërisë Janë në Dispozicion të të Gjithëve

Kur Jozef Smithi po përkthente Librin e Mormonit, atij dhe shkruesit të tij, Oliver Kaudrit, u lindi një pyetje. Ata shkuan në pyll që të luteshin rreth saj. Teksa po luteshin, “një lajmëtar nga qielli zbriti mbi një re drite”.

Ky lajmëtar qe Gjon Pagëzori. Ai i vendosi duart e tij mbi kokën e Jozefit dhe të Oliverit dhe u dha atyre Priftërinë Aarone. Pastaj, Gjon Pagëzori i urdhëroi Jozefin dhe Oliverin që të pagëzonin njëritjetrin. Pak kohë më pas, Apostujt Pjetri, Jakobi dhe Gjoni erdhën në tokë dhe i shuguruan Jozefin dhe Oliverin në Priftërinë Melkizedeke.

Priftëria e Perëndisë ndodhej përsëri në tokë. (Shih Joseph Smith—Historia 1:68–72.)

Nëpërmjet priftërisë, ne mund të marrim bekimet dhe ordinanca të mrekullueshme. Këto bekimet përfshijnë ato që u jepen



foshnjave të porsalindura, të sëmurëve dhe fëmijëve nga etërit e tyre apo mbajtës të tjerë të denjë të priftërisë. Ne, gjithashtu, duhet të marrim disa ordinanca të priftërisë që të kthehemi tek Ati Qellor. Disa prej këtyre ordinancave përfshijnë pagëzimin me anë të zhytjes, marrjen e dhuratës së Frymës së Shenjtë dhe ordinancat e shenjtë të tempullit që mund të vulosin familjet së bashku përgjithmonë. Gjithashtu në tempull mund të kryhen ordinanca për njerëz që kanë ndërruar jetë pa bekimet e ungjillit. Bekimet e priftërisë janë në dispozicion të të gjithëve! ■

Këngë dhe Shkrim i Shenjtë

- Zgjidhni një këngë rreth priftërisë
- Doktrina e Besëlidhje 84:35



VEPRIMTARI ZTD: Priftëria Ndhmon Njerëzit

Priftëria është fuqia e Perëndisë për t'u shërbyer e për t'i bekuar njerëzit përmes ordinancave dhe bekimeve. Vizatoni veten tuaj në vendin [bosh] në këto figura.



Mbajtësit e priftërisë bekojnë dhe shpërndajnë sakramentin. Vizatoni veten te stoli, gati për të marrë sakramentin.



Bekimet e priftërisë mund t'u administrohen të sëmurëve. Vizatoni veten në krevat, duke mos u ndier mirë.

Vetëm Ti

Te Perla me Vlerë të Madhe, shkoni te Joseph Smith—Historia 1:68–73. Përdorini këto vargje si ndihmë që të plotësoni vendet bosh më poshtë. Në një copë tjetër letre, shkruani gjërat e tjera që mësuat nga leximi i këtyre vargjeve.

1. "Priftëri[a] e Aaronit . . . mban çelësat e shërbesës së _____ dhe të ungjillit të _____."
2. _____ u pagëzua i pari.
3. Oliver Kaudri pagëzoi _____.
4. Gjon Pagëzori vepronte nën drejtimin e _____, _____ dhe _____.
5. Më vonë, Pjetri, Jakobi dhe Gjoni u dhanë Priftërinë _____ Jozefit dhe Oliverit.



Familjet mund të vulosen së bashku nëpërmjet ordinancave të tempullit. Vizatoni familjen tuaj para tempullit.



Pagëzimi dhe marrja e dhuratës së Frymës së Shenjtë janë ordinanca të priftërisë. Vizatoni veten duke qëndruar përpara vaskës së pagëzimit.

Përgjigjet: 1. engjëjve, pendimit;
2. Oliver Kaudri; 3. Jozef Smithin;
4. Pjetrit, Jakobit, Gjontit;
5. Melkizedeke.

Dyfish Bekime

Takohuni me Sofi dhe Elodi A. prej Antananarivos të Madagaskarit.

Nga Riçard M. Romni

Revistat e Kishës

Motrat binjake dhjetëvjeçare, Sofia dhe Elodia, jetojnë në Madagaskar.

Ai është një ishull i madh pranë brigjeve të Afrikës. Familja e tyre ka një histori të vërtetë të parapëlqyer. "Babai im e dinte se Kisha ishte e vërtetë, që herën e parë kur u takua me misionarët", thotë Elodia. "Ai që një i kthyer në besim i menjëhershëm." Mamaja e tyre u pagëzua disa muaj më vonë.

Para se të lindnin vajzat, prindërit e tyre agjëruan dhe u lutën që të mund të kishin një vajzë. "Dhe në vend të një vajze, Mami lindi dy", thotë Sofia.


Që atëherë kanë pasur dyfish bekime! ■



Familja e Sofisë dhe Elodisë kurseu para për tre vjet që të udhëtonin për në Tempullin e Johannesburgut të Afrikës së Jugut që të vuloseshin së bashku. Atyre iu desh të udhëtonin mbi 1.300 milje (2.100 km) dhe të kalonin Oqeanin Indian që të arrinin atje.



Mamaja e vajzave ka një klinikë mjekësore pranë shtëpisë së tyre. Ato ndihmojnë duke pastruar dhe duke ndihmuar që të mbahet pastër.



Në flamurin e Madagaskarit, e bardha përfaqëson dëlirësinë, e kuqja paraqet pavarësinë dhe e gjelbra përfaqëson shpresën.



Sofia dhe Elodia kanë dy mace dhe atyre u pëlqen që t'i mbajnë në krahë.



Binjakeve u pëlqejnë mbrëmjet familjare me dy vëllezërit e tyre, mbesën e tyre dhe babanë e mamën e tyre.



Majmunët lemur dhe kameleonët janë dy kafshë që gjenden në Madagaskar.

A nuk Mund të **PAGËZOHEM** edhe Unë?

“Fëmijët . . . do të pagëzohen për heqjen e mëkateve të tyre, kur të bëhen tetë vjeç” (DeB 68:27).

“Nuno dhe Miriam, a do të ndiqni shembullin e Jezu Krishtit dhe të pagëzoheni të shtunën tjetër?” pyeti Motra Silva.

Paulo nuk mund t’u besonte veshëve. Motrat misionare sapo kishin ftuar vëllanë dhe motrën e tij 10-vjeçare që të pagëzoheshin!

“Po! Po!” thanë binjakët me lumturi.

Miriami nuk mund të ndalte së buzëqeshuri. Nuno toku dorën me Motrën Lopez. Gjyshja rrëzëllente buzagaz nga kolltuku i saj i madh e i kuq në cep.

Për disa javë motrat misionare kishin mësuar Paulon dhe vëllain e motrën e tij të shtëpia e Gjyshes, në ishullin e gjelbër e të freskët të San-Migelit, 1.000 milje (1.600 km) larg kontinentit, Portugalisë. Paulos i pëlqente të hapte gjysmën e sipërme të derës së përparme të shtëpisë së Gjyshes dhe të ndiente flladin e detit tek ndiqte me sy Motrën Lopez dhe Motrën Silva të bënin rrugën për ta mësuar atë rreth ungjillit.

Motrat misionare thanë se sot do të ishte një mësim i veçantë. Tani Paulo e mori vesh arsyen. Nuno dhe Miriami do të pagëzoheshin, pikërisht siç dha mësim Jezusi! Edhe Paulo dëshironte

që të ndiqte shembullin e Shpëtimtarit.

“Motra, a mund të pagëzohem edhe unë të shtunën tjetër?” pyeti padurueshëm, duke e shtrënguar Librin e Mormonit me ilustrime më pranë vetes.

Motra Silva buzëqeshi por tundi kokën. “Më vjen keq, Paulo. Zoti na ka treguar se ne të gjithë duhet të pagëzohemi por vetëm pasi të bëhemi tetë vjeç. Ngaqë je vetëm gjashtë vjeç, ti ende nuk je përgjegjës për zgjedhjet e tua.”

“Por motra”, kundërshtoi Paulo, “unë jam lutur dhe kam lexuar Librin e Mormonit me familjen time, ashtu siç më mësuat ju. Unë shkoj në Fillore çdo javë me Gjyshen dhe Xhaxha Márion. Unë e di se Kisha është e vërtetë! A nuk mund të pagëzohem me Nunon dhe Miriamin?”

“Ti ke bërë një gjë kaq të mirë duke jetuar urdhërimet dhe duke mësuar rreth ungjillit”, tha Motra Lopez. “Por ende duhet të presësh dy vjet përpara se të mund të pagëzohesh.”

Fyti i Paulos filloi të digjte dhe lot të nxehtë mbushën sytë e tij. Ai u ngrit hopthi dhe vrapoi te dhoma





e vet në papafingo, ku flinte me vëllanë dhe motrën e tij.

Pasi qau mbi jastëkun e vet për disa minuta, Paulo dëgjoi dikë të ngjiste shkallët e papafingos. Xhaxha Mário u ul në shtratin e Paulos.

“Çfarë ndodhi, Paulo?” pyeti Xhaxha Mário.

“Motra Silva dhe Motra Lopez thanë se unë nuk mund të pagëzohem, por Nuno dhe Miriami mundën”, tha Paulo. “Unë dua të jem anëtar i Kishës! Mua më pëlqen të këndoj himnet në mbledhjen e sakramentit dhe të mësoj rreth shkri-meve të shenjta në Fillore. Nuk dua që të mbetem mbrapa.”

“Paulo, ti ende mund të jesh pjesë e Kishës, megjithëse nuk je mjaftueshëm i madh në moshë që të pagëzohesh”, tha me butësi Xhaxha Mário.

“Si?” rrufiti hundët mbi jastëkun e vet Paulo.

“Mirë, ti e di që Fillorja po përgatit një program të mbledhjes së sakramentit”, tha Xhaxha Mário. “Mësuesja jote e Fillores më tha se po kërkon vullnetarë që të ndajnë dëshmitë e tyre në program. Kjo është një mënyrë se si mund të marrësh pjesë në kishë”, shpjegoi Xhaxha Mário.

“Me të vërtetë?” Paulo u ngrit dhe ktheu fytyrën nga xhaxhai i vet. Ai u mendua një çast. “Ndoshta mund të ndaj dëshminë time edhe në pagëzimin e Nunos dhe Miriamit!”

“Kjo është një ide e mrekullueshme!” tha Xhaxha Mário. “Megjithëse je tepër i vogël që të pagëzohesh, prapë mund të kesh një dëshmi.”

Paulo hovi nga krevati dhe nxitoi teposhtë shkallëve.

“Ku po shkon, Paulo?” thirri Xhaxha Mário.

“Po shkoj të praktikoj dhënien e dëshmisë sime me misionaret!” thirri me gëzim si përgjigje Paulo. “Do ta jap atë teksa pres që të pagëzohem!” ■



“Durim do të thotë pritje dhe qëndrueshmëri aktive. Do të thotë këmbëngulje tek diçka dhe të bësh gjithçka që mundesh – duke punuar, shpresuar dhe ushtruar besim.”

Presidenti Diter F. Uhtdorf, Këshilltar i Dytë në Presidencën e Parë, “Vazhdoni me Durim”, Liahona, maj 2010, f. 57.

Veshja si Dhjak

Nga Hilari M. Hendriks

Bazuar mbi një histori të vërtetë



5.

Unë dua të vesh këmishë të bardhë dhe pantallona të hijshme. Dua të vishem si dhjak.

Mamaja e ndihmoi Elin të vishte pantallonat e tij të hijshme, një këmishë të bardhë dhe një kollare.



6. Në kishë, Eli kryqëzoi krahët teksa shihte dhjakët të shpërndanin sakramentin.



7. Kur një dhjak i solli Elit sakramentin, Eli mori një copë bukë dhe pastaj ia kaloi tabakanë Mamasë.

8. Mamaja i buzëqeshi Elit. Ai qe i lumtur të ndihmonte. Ai u ndie tamam si një dhjak.



FIGURA TË FSHEHURA

Eli dëshiron të vishet si dhjak. Ndhimoheni të gjejë gjërat në dhomën e tij që do ta ndihmojnë të vishet si dhjak.



FAQE PËR NGJYROSJE



Ne i marrim ordinancat e shpëtimit nëpërmjet priftërisë.

“Dhe gjithashtu gjithë ata që e pranojnë këtë priftëri, më pranojnë mua, thotë Zoti” (DeB 84:35).

Rinia Braziliane Lidh Historinë e Familjes dhe Punën në Tempull

Nga Melisa Meril

Lajme dhe Ngjarje të Kishës

Zhozé A. Moskão po vinte re një prirje: të rinjtë që po vinin në Tempullin e Kampinas në Brazil po shpenzonin mjaft kohë në pritje.

Vëllai Moskão, drejtori i qendrës së historisë familjare të ndodhur ngjitur me tempullin, e dinte se, për shkak të rrugës që të rinjtë duhet të bënin për të shkuar në tempull, shumica vinte në grupe dhe qëndronin për disa ditë. Nuk mund të shmangej koha e pritjes mes sesioneve në pagëzimore, vakteve ushqimore dhe pritjes për prindërit e udhëheqësit e tyre që po merrnin pjesë në ordianca të tjera tempulli.

Por ndoshta, mendoi ai, mund t'u ofronte të rinjve një alternativë për të shëtitur në terrenin e tempullit kurdoherë që ata të kishin pak kohë të lirë.

Ashtu bëri.

Një Ftesë

Ai filloi të ftone të rinj në qendër dhe ofroi t'u mësonte se si të bënin indeksim për FamilySearch.

Në fillim, disa qenë të turpshëm ose ngurrues. Por Vëllai Moskão tha se, kur u foli atyre për shpëtimin e njerëzve nga errësira dhe sjelljen e emrave të tyre në dritë, në bindje ndaj fjalëve të një profeti të gjallë, të rinjtë u prekën (shih Dejvid A. Bednar, "Zemrat e Fëmijëve Do të Kthehen", *Liahona* dhe *Ensign*, nëntor 2011, f. 24–27).

Fakti që tempulli dhe qendra e historisë familjare ndodhen brenda të njëjtës ndërtesë, është kuptimplotë; ai nënvizon në një mënyrë fizike se tempulli dhe puna e historisë familjare janë dy pjesë të një përpjekjeje të madhe. Kjo, tha

Xhorxh A. Ouks, president i Tempullit të Kampinas në Brazil, është diçka që po fillojnë të mësojnë të rinjtë në distriktin e tempullit.

"Përpara theksimit për t'i përfshirë ata në historinë familjare dhe indeksimin, udhëtimi i tyre për në tempull ishte kryesisht për qëllimin e pagëzimit për të vdekurit. Tani, përvojat me indeksimin po bëhen pjesë e punës së tyre", tha ai.

Një Paraqitje

Kur të rinjtë vijnë në qendër, Vëllai Moskão dhe misionarët që punojnë vullnetarisht në qendër, trajtojnë parimet vijuese në një orientim të shkurter e të thjeshtë:

- Ata po bëhen çlirimtarë në malin e Sionit (shih Abdia 1:21).
- Ata po ia vënë veshin thirrjes së një profeti (shih "Zemrat e Fëmijëve Do të Kthehen").
- Ata po shpëtojnë njerëz nga errësira – errësira e filmave të harruar prej kohësh dhe e librave të pluhurosur të zyrave të regjistrimit e kishave. Indeksimi i nxjerr në dritë ata emra dhe i bën të gjurmueshëm që familjet e tyre të mund t'i gjejnë.
- Duke u bashkuar me këtë punë, ata do të marrin pjesë në një aspekt tjetër të "më të lavdishme[s] të gjitha çështjeve që i përkasin ungjillit të përjetshëm, domethënë pagëzimin për të vdekurit" (DeB 128:17).
- Ata do ta përdorin kohën e tyre në punën e madhe të shëlbimit të të vdekurve, që bekon familjet.
- Të gjithë ne jemi pjesë e familjes së Perëndisë, kështu që, me indeksimin e emrave të njerëzve



Gjatë udhëtimeve për në tempull, të rinjtë në distriktin e Tempullit të Kampinas në Brazil marrin pjesë në indeksimin për Family Search mes sesioneve në pagëzimore.

që nuk i njohin, ata ende po ndihmojnë familjen e tyre.

- Pasi kuptojnë se si të marrin pjesë në indeksim, ata kanë mundësi t'u mësojnë pjesëtarëve të familjes së tyre dhe të rinjve të tjerë në lagjet e degët e tyre që të marrin pjesë gjithashtu.

Vëllai Moskão dhe misionarët i përdorin pastaj kompjuterat e qendrës që t'u tregojnë adoleshentëve se si të fillojnë të indeksojnë dhe se si të instalojnë e të përdorin programin kompjuterik kur të shkojnë në shtëpi. Pasi e kuptojnë, tha Vëllai Moskão, ata "fillojnë të indeksojnë me një forcë si askush tjetër".

Një Entuziazëm për Punën

Shifrat e pasqyrojnë atë entuziazëm. Gjatë dy muajve të parë të vitit 2012, vizitorët indeksuan 6.370 emra; 3.305 prej tyre u indeksuan nga të rinj të moshave 12 deri 18 vjeç. Në fakt, për t'iu përshtatur interesit në rritje për indeksimin, qendra e historisë familjare në Kampinas shpesh i zgjat oraret e rregullta të punës nga ora 08:00 deri në 18:00 dhe qëndron e hapur vonë deri në orën 22:00.

Por të rinjtë nuk e lënë pas indeksimin kur largohen nga tempulli. Kur shkojnë në shtëpi,

ata e vazhdojnë rolin e tyre në atë që Vëllai Moskão e quan "ushtria e më shumë se 170.000 indeksuesve aktivë që ka Kisha sot". Shumë po realizojnë qëllime të Detyrës ndaj Perëndisë dhe Përparimit Personal me punën e tyre të indeksimit.

Një Ndikim për Mirë

Nga fillimi i këtij viti, Izabela A. 16 vjeçe nga Vila-Velha, Espírito-Santo, Brazil, shkoi në tempull me nënën dhe motrën; dita e fundit e udhëtimit ishte përvjetori i parë i vdekjes së gjyshes së saj. Izabela u pagëzua për gjyshen dhe nëna e saj kreu ordinancat e tjera të tempullit për të.

"E ndieva gjatë këtij udhëtimi se duhej të bëja diçka të mirë", shpjegoi Izabela. "Dëshiroja të mësoja të indeksoja dhe Vëllai Zhozé Moskão më ndihmoi.

Pastaj, kur po pagëzohesha për gjyshen time, Shpirti më preku thellë. Kuptova se kishte shumë njerëz përtej velit që po presin pafundësisht dhe se atyre u nevojitej ndihma ime. Kuptova se mund të jepja pak nga koha ime për të shërbyer dhe se mund të bëja shumë për këta njerëz. Indeksimi është një punë dashurie." ■

Për më shumë informacion mbi këtë histori, vizitoni news.lds.org.

Organizohet Kunji i Parë në Indi

**Nga Plaku E. Xhek dhe
Motra Pamela Keltershtas**

Misioni i Indisë, Bangalore

K ishte një ndjesi të prekshme emocioni dhe mirënjohjeje ndërkohë që më shumë se 1.500 anëtarë dhe miq u mbledhën në Qendrën e Kuvendeve në Novotel në Hajderabad të Indisë, për krijimin

e Kunjit të Hajderabadit në Indi, kunji i parë në vend, më 27 maj 2012. Kryesoi Plaku Dallin H. Ouks, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, dhe u shoqërua nga Plaku Donald L. Hallstrom, i Presidencës së Të Shtatëdhjetëve, dhe Plaku Entoni D. Perkins, i Të Shtatëdhjetëve, që shërben si President i Zonës së Azisë. Në konferencë, morën pjesë gjithashtu bashkëshortet e të gjithë këtyre udhëheqësve.

Xhon Guti u mbështet si president i kunjit me Suresh Nataraxhan si këshilltar të parë

dhe Raxharatnam Bushi si këshilltar të dytë. Patriarku i parë i Indisë është ish-presidenti i distriktit, Prashad Rao Gudei.

Duke iu drejtuar mbledhjes më të madhe absolute të shenjtoreve

Presidenca e kunjit të sapoformuar në Hajderabad në Indi (nga e majta në të djathtë): Suresh Nataraxhan, këshilltar i parë; Xhon Guti, president; Raxharatnam Bushi, këshilltar i dytë.



FOTOGRAF I NGJA JAMES DAIRYMPLE

në Indi, Rendi D. Fank, president i Misionit të Indisë, Bangalore, tha: “Kjo është një pamje e lavdishme në këtë ditë historike, një ditë që do ta kujtojmë gjithmonë. Do ta kujtojmë gjithmonë se një Apostull i Zotit qe këtu.”

Plaku Perkins u shprehu dashurinë nga Presidenca e Zonës së Azisë anëtarëve në Indi dhe tha: “Ne po shohim fillimet e një pune të mrekullueshme në këtë tokë. Rritja e Kishës dhe formimi i kunjit po bëhen në përputhje me parimet e ungjillit të përjetshëm dhe modeleve të krijuara të priftërisë.”

Duke treguar se ai ishte një dëshmitar i dytë në thirrjen e presidencës së re të kunjit, Plaku Hallstrom shpjegoi procesin zbulues të përzgjedhjes së udhëheqjes së re të kunjit. Si anëtar i Të Shtatëdhjetëve, atij i jepet detyra dhe vjen pa anësi ose paragjykim, tha ai. Ai erdhi sipas mënyrës së Zotit, i varur nga Shpirti i Tij për të marrë zbulesë. “Vullneti i Zotit është që Presidenti Guti të jetë presidenti i kunjit”, tha Plaku Hallstrom.

Kristen Ouks, që shoqëroi bashkëshortin, foli për t’u mësuar fëmijëve që ata të besojnë “që nënat [e tyre] e dinin atë” (shih Alma 56:48).

Si folësi i fundit në mbledhje, Plaku Ouks i shprehu mirënjohje kombit të Indisë, një vend me liri fetare që lejon që anëtarët e Kishës “të mblidhen e të

shprehin parimet e besimit tonë”.

Plaku Ouks dëshmoi se kishte pasur një dëshmi të Shpirtit se Zoti i kishte përgatitur dhe zgjedhur udhëheqësit që u thirrën. Plaku Ouks foli gjithashtu për përgjegjësitë e reja të një kunji.

Në Dhiatën e Vjetër, profeti Isaia e krahasoi Izraelin me

“Një bekim patriarkal deklaroi prejardhjen tuaj familjare në fiset e Izraelit, përmes së cilës merren bekime të mëdha”, tha Plaku Ouks. “Një bekim patriarkal deklaroi gjithashtu bekime dhe premtime që mund t’i pretendojmë nëse jemi besnikë.”

“Ndërsa Kisha në Indi rritet, do të vijë koha kur profeti do

Ndërsa po vizitonin Hajderabadin në Indi, Plaku Ouks dhe udhëheqës të tjerë të Kishës u takuan me qindra anëtarë nga India, Nepali dhe Sri-Lanka.



një çadër që strehoi fëmijët e Izraelit, tha ai. “Kisha sot është çadra. Të gjithë ne e dimë se një çadër duhet të mbështetet me kunja. Tani që Hajderabadi është një kunj i Sionit, do të pritët prej jush që të ecni përpara dhe të siguron mbështetje më të madhe në lidhje me të dhjetat dhe misionarët.”

Si rezultat i formimit të një kunji, anëtarët në Hajderabad do të jenë në gjendje të marrin bekime patriarkale. Plaku Ouks shpjegoi se çfarë përmbahet në një bekim patriarkal, duke iu referuar bekimeve si “shkrime të shenjta private”.

të frymëzohet për të ndërtuar një tempull në Indi”, vazhdoi ai. “Çdo kunj i krijuar përmirëson mundësinë që do të ekzistojë një tempull. Ndërsa njerëzit tregojnë denjësi dhe angazhim, një tempull vijon.”

Në mbyllje, Plaku Ouks kërkoi një bekim: “Në këtë kunj të parë në vendin e madh të Indisë, unë ju bekoj të kujtoni mësimet e këtij momenti. Unë ju bekoj të kujtoni besëlidhjet që keni bërë kur jeni pagëzuar. Unë ju bekoj me një kujtesë dhe vendosmëri për të mbajtur urdhërimet e Perëndisë, që ju të mund të gëzoni bekimet e Tij.” ■

Apostulli Përkushton QTM-në e Re në Filipine

Qendra e Trajnimit të Misionarëve në Filipine, të cilën Plaku Rasëll M. Nelson, i Kuorunit të Dymbëdhjetë Apostujve, e përkushtoi më 20 maj 2012, mund të strehojë deri në 144 misionarë nga Filipinet, Kamboxhia, Hong-Kongu, India, Indonezia, Mongolia, Pakistani, Sri-Lanka, Tajvani dhe Tajlanda. Këta misionarë trajnohen në gjuhët e vendeve të tyre amtare.

Dy ndërtesat e qendrës së re përbëjnë një sallë leksionesh, kabina përkthimi, një laborator kompjuterash, një zonë lavandërie, dhoma për mësimdhënie me pajisje audiovizive të montuara, fjetore për misionarët, klasa mësimi dhe zyra.

Kur dha lutjen për të përkushtuar godinën e re, Plaku Nelson shprehu mirënjohje për Shlyerjen e Jezu Krishtit dhe për misionarët besnikë e anëtarët e Kishës në mbarë botën që e duan dhe i shërbejnë Zotit. Ai kërkoi një bekim për Republikën e Filipineve që “të mbajë dyer të hapura të mikpritjes” ndaj të gjithë shërbëtorëve të Zotit dhe u lut që njerëzit e kombit të bekohen me “liri dhe përgjegjshmëri për t’u rritur në drejtësi, si fizikisht ashtu edhe shpirtërisht”.

Në Qendrën e re të Trajnimit të Misionarëve në Filipine, trajnohen në gjuhën e vendeve të tyre amtare deri në 144 misionarë nga Filipinet, Kamboxhia, Hong-Kongu, India, Indonezia, Mongolia, Pakistani, Sri-Lanka, Tajvani dhe Tajlanda.



FOTOGRAFI NGA NOEL MAGLAQUE

Tempulli i Manausit në Brazil Është Tempulli i 138-të i Kishës në Mbarë Botën dhe i Gjashti në Brazil

Presidenti Diter F. Uhtdorf, Këshilltar i Dytë në Presidencën e Parë, përkushtoi Tempullin e Manausit në Brazil – tempulli i 138-të i Kishës në mbarë botën dhe i gjashti në Brazil – më 10 qershor 2012.

Besimi dhe angazhimi i shenjtoreve të ditëve të mëvonshme që jetojnë në Brazil, ku ka më shumë se një milion anëtarë, mund të përngjasohen me lumin e Amazonës, tha Presidenti Uhtdorf – që të dy palët rrjedhin të thellë e të fortë.

Për thujtje 20 vite, anëtarët e Kishës nga Manausi, një qytet i veçantë nga lumenjtë dhe pyje tropikalë të mëdhenj, kanë udhëtuar me grupe për të marrë pjesë në tempullin e San-Paolos në Brazil – një udhëtim 15-ditor vajtje-ardhje, me barkë dhe autobus – dhe më vonë në tempullin e Karakasit, në Venezuelë – një udhëtim 8-ditor me autobus.

Plaku Klaudio R. M. Kosta, i Të Shtatëdhjetëve, shërbeu si president i Misionit të Brazilit, Manaus, kur ai u hap në vitin 1990.

“Kam besim se Tempulli i Manausit do të jetë shumë i zënë me punë, për cilëndo

ditë, sepse këta njerëz e duan tempullin”, tha Plaku Kosta. “Ata i mësojnë fëmijët e tyre që ta duan tempullin. Tempulli është shumë i çmuar për ta.”

Anëtarë të Kishës nga Samoa Festojnë 50-Vjetorin e Pavarësisë dhe të Kunjit të Parë

Të premten, më 1 qershor 2012, rreth 350 shenjtore të ditëve të mëvonshme në Samoa u bashkuan me samoas të tjerë për të marshuar në një paradë të festimit të pavarësisë nëpër rrugët e Apias. Pesëdhjetë vite më parë, në 1962-shin, vendi fitoi pavarësinë e tij nga Zelanda e Re.

Morën pjesë organizata, shkolla, kisha vendore dhe organizata ndërkombëtare. Studentë shenjtore të ditëve të mëvonshme zbavitën dhjetëra mijëra shikues me bandën e tyre marshuese.

Por fundjava përfshiu një tjetër pikë festimi për shenjtoret samoas të ditëve të mëvonshme; 50 vite më parë u organizua gjithashtu kunji i parë në vend, në Apia.

Të dielën, më 3 qershor, Plaku Xhejms J. Hamula dhe Plaku Kevin W. Pirson, të Të Shtatëdhjetëve, të dy anëtarë të Presidencës së Zonës së Paqësorisë, u folën shenjtoreve të ditëve të mëvonshme dhe të ftuarve në një mbledhje të veçantë që iu transmetua shtëpive të mbledhjeve SHDM në mbarë vendin.

Duke vështruar përpara, shenjtoret e ditëve të mëvonshme në Samoa synojnë të vazhdojnë të shërbejnë e t’i forcojnë familjet, fshatrat dhe kombin e tyre, tha Plaku Hamula, që shërben si President i Zonës. “Ne po rritemi shkëlqyeshëm si Kishë këtu dhe ne po rritemi në familjet tona dhe jetën personale, ndërsa përpiqemi të ndjekim mësimet dhe shembullin e Jezu Krishtit”, tha ai. ■

Ajo Ndërton Dëshminë Time

E kam lexuar dhe studiuar me zell *Liahonën* që nga viti 1967 dhe ajo më ka ndihmuar të rritem shpirtërisht. Çdo muaj pres revistën që të mund të lartësohem, të ndiej pëshpëritjet e Shpirtit të Zotit dhe të ndërtoj dëshminë time për ungjillin. Më ka pëlqyer veçanërisht “Emulating and Honoring Our Heavenly Parentage” [“Marrja si Shembull dhe Nderimi i Prejardhjes Sonë Qiellore”] (*Liahona*, shkurt 2012, f. 80). Isha në gjendje të njëjtësohesha me atë që tha autori sepse edhe unë jam skicues grafike.

Fabio Fajardo, Kolumbi

Një Mësuese dhe Mike

Më pëlqen *Liahona* – ajo më jep mësim, më mbështet dhe korrigjon jetën time. Kur lexoj gjëra të mira në mëngjes, përpiqem të jem më e mirë gjatë gjithë ditës. Dashuria dhe besimi im janë më të fuqishëm kur lexoj revistën. Gjithashtu ua jap si dhuratë *Liahonën* mikeshave të mia. Faleminderit shumë për një mësuese dhe mike kaq të mirë!

Anastasia Naprashnikova, Ukrainë

Ju lutemi, dërgojini komentet ose sugjerimet tuaja te liahona@ldschurch.org. Përgjigjet mund të redaktohen lidhur me gjatësinë apo qartësinë.



Ky numër përmban artikuj dhe aktivitete që mund të përdoren për mbrëmjen familjare. Në vijim janë disa shembuj.

“Të Jetuarit me Maturi na Përgatit për të Ardhmen”, faqe 12: Lexoni gjashtë fushat e përmendura në artikull në të cilat mund të bëhemi të mbështetur te vetja. Cilat janë disa raste të ngutshme apo probleme që mund të shmangen duke zhvilluar mbështetje te vetja në këto fusha? Ftojini pjesëtarët e familjeve që të marrin parasysh me lutje fushat në të cilat kanë nevojë të përmirësohen dhe të vendosin synime për të rritur mbështetjen e tyre te vetja në ato fusha.

“Dëlirësia në një Botë të Papërkorë”, faqe 42: Diskutojini me pjesëtarët e familjes pyetjet e bëra në artikull. Merrni parasysh ndarjen e parimeve dhe përvojave që kanë forcuar dëshminë tuaj për dëlirësinë. Diskutoni mënyra për të zbatuar këshillën nga artikulli.

“Jini i Urtë dhe Jini një Mik”, faqe 48:

Filloni duke lexuar provën e Plakut Hejls për përcaktimin e miqve të mirë. Merrni parasysh diskutimin e rëndësisë së të qenit një mik i mirë. Ftojini secilin pjesëtar të familjes që të mendojë për tri mënyra se si ai ose ajo mund të jetë një mik më i mirë.

“E dashur Amiga”, faqe 60 dhe

“Duke i Uruar Mirëseardhjen një Stine të Re të Jetës”, faqe 61: Lexoni për këta fëmijë të Fillores dhe mbi mënyrën se si ata po përgatiten që të hyjnë te Të Rejat dhe Të Rinjtë. Si familje, merrni parasysh të diskutoni se çfarë bënë këta fëmijë që të përgatiteshin. Ftojini pjesëtarët e familjes që të lexojnë broshurat *Përparimi Personal* ose *Detyrë ndaj Perëndisë* dhe të gjejnë disa aktivitete për të cilat janë të interesuar t’i përmushin në të ardhmen.

Një Mbrëmje Familjare, Dy Mësime

Një natë, prindërit e mi dhe gjyshërit nga nëna erdhën të na vizitojnë për mbrëmje familjare. Secili prej tre fëmijëve të mi dëshiron shumë të marrë pjesë dhe, këtë mbrëmje, ishte radha e birit tim shtatëvjeçar që ta jepte mësimin. Ne kishim përgatitur një ekspozim të vogël, kishim vendosur figura mbi Krijimin dhe kishim studiuar e këqyrur atë çfarë ai do të jepte mësim. Biri im ishte gati dhe i emocionuar.

Gjatë mësimit, të gjithë dëgjua me vëmendje atë çfarë po shpjegonte biri im. Kur ai mbaroi, Samueli, që ishte rreth tre vjeç, vendosi se edhe ai dëshironte të jepte një mësim. Kështu që ai mori figurat dhe ekspozimin dhe i vendosi sërish mbi tavolinë.

Me zërin e tij të butë dhe me fjalët e tij disa herë të shqiptuara dobët, Samueli na dha një mësim mbrëmjeje familjare. Dhe edhe pse ai nuk e kishte përgatitur, ai kishte dëgjuar. Ai na shpjegoi se si ishte krijuar toka dhe na tregoi për dashurinë që ka Jezu Krishti për secilin prej nesh.

Ne u habitëm ta shihnim se sa lehtë e dha mësimin – duke e bërë atë pikërisht si e kishte bërë i vëllai. Prindërit dhe gjyshërit e mi qenë të habitur e të lumtur. Ne të gjithë mundëm të shihnim dashurinë që kanë këta fëmijë të vegjël për ungjillin – dhe dashurinë që ka Jezu Krishti për ta.

Lizbet Sánchez Fahardo, Meksikë

GJËRA TË MIRA VAZHDOJNË TË VIJNË

Nga Keitlin A. Rash

I shte një mbrëmje të premteje pak a shumë si të tjerat. Mikeshat e mia të ngushta dhe unë ishim ulur në apartamentin tim pasi kishim ndjekur një film, duke biseduar qetësisht dhe pastaj duke qeshur fort herë pas here. Një ndjenjë kënaqësie e çiltër mbushte ajrin, dhe unë nuk mund të mos buzëqeshja teksa historitë dhe mendimet shtilleshin nëpër dhomë. Disa prej personave i kisha takuar vetëm një muaj më parë; disa i kisha njohur për gjatë gjithë 25 viteve të mia.

Në një pikë të caktuar, një prej këtyre mikeshave afatgjata dhe unë arritëm të ndarja e kujtimeve rreth disa prej miqve tanë të kolegjit të pak viteve më parë. Teksa flisnim, mendova se sa më kishte marrë malli për këta miq, se sa shumë ishim argëtuar dhe se sa të afërt kishim qenë. Tashmë ishim diplomuar dhe ishim zhvendosur nëpër vende kudo në botë, duke u gjendur në situata që kurrë nuk mund t'i kishim parashikuar. Psherëtiva nga ndjenjat kalimtare të humbjes, pastaj pashë qark dhomës fytyrat e qeshura që më rrethonin në atë moment, dhe u befasova nga mendimi i papritur: *gjëra të mira vazhdojnë të vijnë*.

Ai mendim i thjeshtë që në fakt shumë i thellë për mua, veçanërisht meqenëse gjithmonë e kam pasur të vështirë të përballesh me ndryshimin dhe jam ngurruese që t'i lë gjërat e mira të shkojnë. Më merr malli për të shkuarën edhe kur është akoma në të tashmen, e dëshpëruar për të shijuar plotësisht çastet në të cilat jetoj në mënyrë të ndërgjegjshme dhe të përcaktuar. E di kur kam një gjë të mirë, dhe dëshiroj të kapem pas saj dhe të



Si një person që ndien keqardhje për të tashmen e cila shndërrohet kaq shpejt në të shkuar, isha mirënjohëse për kujtuesin që thjesht të shijojë çastin dhe të shikojë nga e ardhmja.

mos e lë kurrë; kjo mbrëmje të premteje e plogësht dhe e gëzuar ishte një prej atyre çasteve të mira. Zakonisht, kur e kuptoj se si janë gjërat e mira, menjëherë filloj të mendoj se si çdo gjë po fluturon, dhe që në fund do të humbasë me kohën apo rrethanat.

Por këtë mbrëmje, keqardhja e brendshme nuk erdhi. Ulur qetësisht, e rrethuar nga njerëz që i doja, e dija që, megjithëse disa gjërave të mira natyrisht duhet t'u vijë fundi dhe se pa dyshim do të kishte shumë gjëra të vështira në të ardhmen, gjërat e mira do të vazhdonin të vinin. Dhe gjithmonë do të vinin – për sa kohë i lejoja unë. Ashtu si bëjnë përpara ata që dua, zbrazëtitë do të mbusheshin me njerëz e përvoja të reja dhe mahnitëse që as nuk i kisha përfytyruar ndonjëherë.

Ndonjëherë është e vështirë të bësh përpara, por duhet ta bëjmë. Dhe të bësh përpara nuk do të thotë të harrosh miqësi, [apo] t'i detyrosh kujtimet të fshihen. Do të thotë ta hapim zemrën tonë ndaj një lumturie edhe më të madhe dhe ndaj më shumë përvojave.

Disa javë pas asaj të premteje, u lirua presidenca e degës sime të të rinjve në moshë madhore. Ashtu siç mund ta vërtetojë çdokush nga një degë e vogël, që e vështirë të mendoje për atë që do të ndodhte nëse dega jonë nuk do të që në gjendje të kishte besim tek këta burra dhe gratë e tyre, të cilët kishim arritur t'i donim dhe t'i mirëbesonim. Por mbylla sytë dhe i përsërita vetes fjalët që më kishin befasuar atë të premte: *gjëra të mira vazhdojnë të vijnë*. Isha e qetësuar dhe gati për ndryshimin.

Ndryshimi është rruga e Zotit. Ai dëshiron që ne të jemi të lumtur dhe të rritemi, të jemi të emocionuar për të bërë përpara në jetën tonë. Jeta është një udhëtim dhe, teksa ende gëzojmë të tashmen dhe përgatitemi për sfida të pashmangshme, ne duhet të shkojmë përpara, duke mbetur optimistë, me zemrat tona të hapura para përvojave dhe gjërave të mira që pa dyshim janë rrugës. ■

FIGURA TË SHKRIMEVE TË SHENJTA NGA LIBRI I MORMONIT

Këtë vit, shumë botime të *Liahonës* do të përmbajnë një komplet figurash të shkrimeve të shenjta nga Libri i Mormonit. Në mënyrë që t'i bëni ato të forta dhe të lehta për t'u përdorur, pritini dhe ngjitini me zamkë ose shirit ngjitës në një letër të trashë, në qese të vogla letre ose në shkopinj artizanalë. Ruajeni çdo komplet në një zarf ose qese, së bashku me kuadratin që tregon se ku gjendet historia e shkrimit të shenjtë që përputhet me figurat.



Gurë



Jezu Krishti



Vëllai i Jaredit



Lundra

Jareditët Udhëhiqen për në Tokën e Premtuar

Ethëri 1–3, 6



Presidenca e Parë dhe Kuorumi i Dymbëdhjetë Apostujve kanë dhënë mësim se “martesat dhe familjet e suksesshme ngrihen dhe ruhen me parimet e besimit, lutjes, pendimit, faljes, respektit, dashurisë, dhembshurisë, punës dhe aktiviteteve të shëndosha argëtuese” (“Familja: Një Proklamatë drejtuar Botës”). Për ide mbi zbatimin e këtyre parimeve në jetën dhe familjen tuaj, shihni faqet 4, 16, 20 dhe 22.